



KYBALIONI

nga
Tre Rishitaret

KYBALIONI

Një Studim i Filozofisë Hermetike të Egjiptit të Lashtë dhe Greqisë

nga
TRE RISHTARËT

“Buzët e Urtësisë janë të kycura, përveçse për veshët e Arsyës.”

Shoqëria Botuese YOGI
Tempulli Masonik
Chicago, Illinois
© 1912

Ky vëllim i vogël mësimesh hermetike i kushtohet me nderim
HERMES TRISMEGISTUSIT

I njohur nga Egjiptianët e Lashtë si
“I MADHI I TË MËDHENJVE”
dhe
“MJESHTRI I MJESHTRAVE”

© 2011 - Adrian Kosturi

Të drejtat e përkthimit në gjuhën shqipe janë të rezervuara. Ky publikim nuk mund të kopjohet, ripublikohet, shtypet, shpërndahet apo shitet, në formë elektronike apo mekanike, në tërësi ose pjesërisht pa pëlqimin paraprak të përkthyesit. Nësekenikërkesaosepyetje në lidhje me samësipër, jeni të lutur të kontaktoni përkthyesin në adresën e postës elektronike: adrian.kosturi@gmail.com.

Nëse po lexoni këto fjalë, udha juaj tashmë është kryqëzuar me Kybalion-in dhe ky i fundit është një libër i rëndësishëm, i cili i lexuar dhe i kuptuar në mënyrë të drejtë, mund të bëhet një udhëzues i vyer mbi filozofinë, shkencën e artin Hermetik. Kybalion-i mund të përdoret për të zbërthyer e interpretuar alegoritë dhe simbolizmin që karakterizon Filozofinë e përjetshme dhe universale, parimet themeltare të së cilës pavarësisht nga pikëpamjet e botëkuptimi personal, mbeten të patjetërsueshme dhe universalisht të zbatueshme edhe në ditët e sotme, një shekull pas publikimit të librit e dhjetëra shekuj që nga koha e Hermesit të Madh. Duke kuptuar Kybalion-in do të mund të gjeni përgjigje për pyetjet mbi jetën, mendjen, shpirtin dhe ekzistencën në tërësi. Përtej ndotjes mendore të botës në të cilën sot jetojmë, filozofia gjithëpajtuese Hermetike, përmes arsytimit hedh dritë mbi doktrinën e njësisimit të Krijuesit dhe pavdekshmërisë së shpirtit. Ajo ndihmon në njëmendësimin e së vërtetës hyjnore, e rrjedhimisht të një sistemi të tërë vlerash dhe morali jetësor.

Adrian KOSTURI
Tiranë, Korrik 2011

PËRMBAJTJA

	Parathënie.....	7
I.	Filozofia Hermetike.....	11
II.	Shtatë Parimet Hermetike.....	16
III.	Transmutacioni Mendor.....	25
IV.	GJITHËSIA.....	30
V.	Universi Mendor.....	37
VI.	Paradoksi Hyjnor.....	44
VII.	“GJITHËSIA” në Gjithçka.....	53
VIII.	Rrafshet e Përkimit.....	62
IX.	Lëkundja.....	74
X.	Polariteti.....	80
XI.	Ritmi.....	86
XII.	Shkakësia.....	93
XIII.	Gjinia.....	100
XIV.	Gjinia Mendore.....	106
XV.	Aksioma Hermetike.....	116

PARATHËNIE

Është një kënaqësi e madhe për ne të sjellim në vëmendjen e nxënësve dhe hulumtuesve të Doktrineve Sekrete, këtë vepër të vogël të bazuar në Doktrinën e lashtë Hermetike. Ka pasur kaq pak botime mbi këtë subjekt pavarësisht nga adresimet e panumërta ndaj Doktrinës në mjaft vepra mbi okultizmin, sa shumë nga hulumtuesit e zellshëm të të Vërtetave Arkane me siguri do ta mirëpresin shfaqjen e këtij vëllimi.

Qëllimi i këtij libri nuk është të shpallë ndonjë filozofi apo doktrinë të veçantë, por t'u japë nxënësve një formulim të të Vërtetës, që do të shërbejë në bashkërenditjen e shumë copëzave të dijes okulte që ata mund të kenë fituar, të cilat në pamje të parë duken në kundërvënje me njëra-tjetrën, çka shpesh dekurajon dhe neverit fillestarin në këto studime. Qëllimi ynë nuk është ngritja e një Tempulli të ri të Diturisë, por dorëzimi në duart e nxënësit i një Çelësi Universal me të cilin ai të mundë të hapë dyert e shumta të brendshme në Tempullin e Misterit, ku tashmë ka hyrë përmes portave kryesore.

Nuk ekziston asnjë pjesë e mësimëve okulte të zotëruara nga bota që të jetë ruajtur kaq me fanatizëm sa fragmentet e Doktrinës Hermetike, të mbërritura deri në ditët tona përmes dhjetëra shekujve që kanë shkuar që nga koha kur jetonte themeluesi i madh i tyre, Hermes Trismegistusi, “shkruesi i perëndive”, i cili rronte në Egjiptin e lashtë në ditët kur raca e sotme njerëzore jetonte fëmijërinë e saj. Bashkëkohës me Abrahamin, dhe, nëse legjenda është e vërtetë, udhërrëfyes për këtë njeri të mençur e të nderuar, Hermes ishte dhe është Dielli i Madh Qendror i Okultizmit, rrezet e të cilit kanë shërbyer për të hedhur dritë mbi mësimet e panumërta të përhapura që nga koha e tij. Të gjitha mësimet themelore e rrënjësore të ngulitura në dituritë ezoterike të çdo race mund të gjurmohen pas te Hermesit. Madje edhe mësimet më të lashta të Indisë, pa asnjë dyshim, i gjejnë rrënjët e tyre në Doktrinën origjinale Hermetike.

Nga tokat e lumit Gang, shumë okultistë të avancuar u endën drejt tokave të Egjiptit dhe u ulën në këmbët e Mjeshtrit. Prej tij ata përfituan Çelësin Madhor, i cili qartësoi dhe bashkoi pikëpamjet e tyre të kundërta, duke themeluar kështu qartë Doktrinën e Fshehtë. Nga vise të tjera erdhën të tjerë eruditë, të cilët pa përjashtim e konsideruan Hermesin si Mjeshtrin e Mjeshtrave, e ndikimi i këtij të fundit ishte kaq i madh, sa pavarësisht shmangieve nga udha e dëftuar pas shekujsh të tërë, ende mund të gjendet një ngjashmëri e pajtueshmëri themeltare nën teoritë e ndryshme e shpesh kontradiktore që studiohen sot e kësaj dite nga okultistët e këtyre vendeve të ndryshme. Studentët e Besimeve Fetare të Krahasuara do të jenë të aftë të perceptojnë ndikimin e Doktrinës Hermetike në cilindo besim fetar të denjë për këtë emër e të njohur nga njeriu, qoftë ky besim fetar i vdekur apo ende në fuqi në ditët tona. Ekziston gjithmonë njëfarë Përkimi pavarësisht nga tiparet kontradiktore, dhe Doktrina Hermetike vepron si Pajtuesja e Madhe.

Jeta dhe vepra e Hermesit, duket se ka ecur në drejtimin e mbjelljes së Farës së të Vërtetës, e cila është rritur e ka lulëzuar në mjaft forma të pazakonta, në vend të themelimit të një shkolle filozofie e cila do të dominonte mendimin botëror. Por megjithatë, të vërtetat origjinale të mësuara prej

tij, janë ruajtur të paprekura në dëlirësinë e tyre fillestare nga njerëz të paktë në çdo epokë, te cilët duke refuzuar një numër të madh nxënësish gjysmë të pjekur apo ithtarësh, ndoqën traditën Hermetike dhe e ruajtën të vërtetën për atë pakicë të gatshme ta kuptojë e njohë në themel. E murmuritur vesh më vesh, e vërteta u është dorëzuar këtyre njerëzve të pakët në numër. Kanë ekzistuar gjithmonë në çdo brez disa Rishtarë në vende të ndryshme të botës, të cilët kanë mbajtur gjallë flakën e shenjtë të Doktrinës Hermetike, gjithmonë të gatshëm të përdorin pishtarin e tyre për të rindezur fenerët e dobët të botës së jashtme, kur shkëlqimi i të vërtetës është zbehur, errësuar nga pakujdesia e me fitilat fare pranë shuarjes. Kanë ekzistuar gjithmonë disa njerëz të pakët në numër të cilët janë përkujdesur me besnikëri për altarin e të Vërtetës mbi të cilin është ruajtur i ndezur Fanari i Përjetshëm i Diturisë. Këta njerëz ia kanë përkushtuar jetën e tyre dashurisë siç e ka përshtuar bukur edhe poeti në këto vargje të tij:

“O, mos e lini flakën të vdesë! E mëkuar brez pas brezi në shpellën e saj të errët; në tempullin e saj të shenjtë e mëkuar. Ushqyer nga pas-torë të pastër të dashurisë; mos e lini flakën të vdesë!”

Këta njerëz nuk kanë kërkuar kurrë miratimin e masave, e as ithtarë të shumtë. Ata janë indiferentë ndaj këtyre gjërave, sepse ata e dinë se sa i pakët është në çdo brez numri i atyre të cilët janë gati për të vërtetën, apo që do ta njihnin atë nëse do t’u shfaqej. Ata e ruajnë “mishin e fortë” për burrat, ndërkohë që të tjerët ofrojnë “qumësht për foshnjat”. Ata i ruajnë perlat e tyre të diturisë për të përzgjedhurit e pakët të cilët ua njohin vlerën e stolisin me to kurorat e tyre, në vend t’ua shërbejnë derrave materialistë e vulgarë, të cilët do t’i nëpërkëmbnin në baltë e do t’i përzielin me ushqimin e tyre të pështirë mendor. E megjithatë këta njerëz nuk kanë harruar apo lënë pas dore asnjëherë mësimin e hershëm të Hermesit, në lidhje me përcimin e fjalëve të të vërtetës tek ata të cilët janë gati t’i pranojnë, mësim ky i bërë i qartë edhe në Kybalion: “Kur dëgjohen hapat e Mjeshtrit, veshët e atyre që janë gati për Mësimet e tij bëhen katër.” E përsëri: “Kur veshët e nxënësit janë gati për të dëgjuar, atëherë vijnë buzët që do t’i mbushin me Urtësi.” Qëndrimi i tyre i zakonshëm ka qenë në përputhje të plotë

me aforizmin tjetër Hermetik, gjithashtu pjesë e Kybalion: “Buzët e Urtësisë janë të kyçura, përveçse për veshët e Arsyës.”

Ka nga ata të cilët e kanë kritikuar këtë qëndrim të Hermetistëve, duke pretenduar se me linjën e tyre të veçimit dhe heshtjes, nuk dëshmojnë frymën e duhur. Por një shikim i shpejtë pas në faqet e historisë, do të dëshmojë për urtësinë e Mjeshtrave, të cilët e njihnin marrëzinë e orvatjes së të mësuarit mbarë botës, atë për të cilën i mungonte si pjekuria, ashtu edhe dëshira për ta mirëpritur.

Hermetistët kurrë nuk kanë kërkuar të jenë martirë; përkundrazi, janë ulur qetësisht mënjanë me një buzëqeshje mëshiruese mbi buzët e tyre të kyçura, ndërkohë që “të pafetë shpërthenin në zemëratë të zhurmshme rreth tyre” në dëfrimin e tyre të preferuar të të vuarit e të torturuarit të atyre entuziastëve të ndershëm por të gabuar, të cilët imagjinonin se mund të bindnin një racë barbarësh për të vërtetën, e vërtetë kjo e cila mund të kuptohej vetëm prej të përzgjedhurve që kishin përparuar larg përgjatë Udhës.

Fryma e përndjekjes nuk është shuar ende mbi tokë. Ekzistojnë disa Mësime Hermetike, të cilat, nëse do të shpalleshin publikisht do të tërhiqnin mbi kryet e mësuesve britma të rënda përçmimi e fytyrësh nga turmat, të cilat do të thërrisnin përsëri me të lartë si dikur: “Kryqëzojeni! Kryqëzojeni!”

Në këtë libër të vogël, jemi orvatur t’ju japim një ide të mësimeve themelore të Kybalionit, duke u përpjekur t’ju zbulojmë Parimet e funksionimit e duke e lënë në dorën tuaj zbatimin e tyre, në vend që të përpiqemi të zbërthemë këto mësime në detaje. Nëse ju jeni një nxënës i vërtetë, do të jeni i aftë t’i zbërtheni e zbatoni këto Parime; nëse jo, do t’ju duhet të zhvillonin Vetën në një të tillë, përndryshe Mësimet Hermetike nuk do të jenë veçse “fjalë, fjalë, fjalë” për ju.

TRE RISHTARËT

Kapitulli I

FILOZOFIA HERMETIKE

“Buzët e Urtësisë janë të kyçura, përveçse për veshët e Arsyës” - Kybalioni

Mësimet themelore ezoterike e okulte, të cilat kanë ndikuar kaq fuqimisht filozofitë e të gjitha racave, kombeve e popujve, për mijëra e mijëra vite, e kanë origjinën në Egjiptin e lashtë. Egjipti, shtëpia e Piramidave dhe e Sfinksit, ishte vendlindja e Diturisë së Fshehtë dhe e Doktrinaveve Mistike. Të gjitha kombet huazuan nga Doktrina e tij e Fshehtë. India, Persia, Kaldea, Medea, Kina, Japonia, Siria, Greqia e Roma e lashtë, si edhe qytetërime të tjera të lashta, morën pjesë bujarisht në gostinë e diturisë, të cilën Hierofantët dhe Mjeshtrit e Truallit të Isisit e shtruan lirisht për ata që erdhën të bëhen pjesë e rezervës së madhe të Njohurisë Mistike e Okulte, që kishin mbledhur mendjendriturit e asaj toke të lashtë.

Në Egjiptin e lashtë rronin Dijetarët dhe Mjeshtrit e mëdhenj të cilët kurrkush nuk i ka tejkaluar, e rrallëkush i ka barazuar gjatë shekujve që i ndajnë nga ditët e Hermesit të Madh. Në Egjipt ndodhej e Madhërishmja Lozhë e Lozhave e Mistikës. Në dyert e tempullit të saj hynë Neofitet, të cilët më pas si Hierofantë, Dijetarë dhe Mjeshtra, udhëtuan në të katër cepat e botës, duke mbartur me vete dijen e vyer, të cilën ishin të gatshëm, të ethshëm e plot dëshirë t’ia përçonin atyre që ishin gati për të. Të gjithë nxënësit e Okultizmit e njohin borxhin që i detyrohen Mjeshtrave të përnderuar të asaj toke të lashtë.

Midis këtyre Mjeshtrave të Mëdhenj të Egjiptit të Lashtë, njëherë e një kohë rronte dikush të cilin ata e nderonin si “Mjeshtri i Mjeshtrave.” Ky njeri, nëse “njeri” ishte vërtetë, rronte në Egjipt në ditët e hershme. Ai njihej si Hermes Trismegistus. Ai është babai i Diturisë Okulte; themeluesi i Astrologjisë; zbuluesi i Alkimiisë. Detajet e bëmave të jetës së tij janë të humbura për historinë në rrjedhën e viteve, e megjithatë shumë nga vendet e lashta kanë debatuar me njëra-tjetrën pretendimet se cila prej tyre kishte nderin të ishte vendlindja e tij, kjo mijëra vjet më parë. Data e qëndrimit të tij në Egjipt, që përbën mishërimin e tij të fundit mbi këtë planet nuk dihet, por është vlerësuar në ditët e hershme të dinastive më të vjetra të Egjiptit; shumë kohë përpara ditëve të Moisiut. Autoritetet më të larta e konsiderojnë si bashkëkohës i Abrahamit, dhe disa gojëdhëna hebraike shkojnë edhe më tej, duke pretenduar se Abrahami e ka përfutur një pjesë të diturisë së tij mistike nga vetë Hermesit.

Me kalimin e viteve pasi ai ndërroi jetë (gojëdhëna thotë se ai jetoi treqind vjet), Egjiptianët e hyjnizuan Hermesin, duke e bërë atë një nga perënditë e tyre nën emrin e Thotit. Vite më pas, edhe populli i Greqisë së Lashtë e bëri një nga perënditë e tij të shumta, duke e quajtur “Hermes, Zoti i Diturisë.” Egjiptianët e nderuan kujtimin e tij për shumë shekuj, po, dhjetëra shekuj, duke e quajtur “Shkruesi i Perëndive” e duke i akorduar vetëm atij në veçanti, titullin e tij të vjetër “Trismegistus”, që do të thotë “tri herë i madhi”, “i madhi i të mëdhenjve”, “më i madhi i të mëdhenjve” etj. Në të gjitha tokat e lashtësisë, emri i Hermes Trismegistusit nderohej duke qenë sinonim

me “Burim Diturie”.

Edhe sot e kësaj dite, ne e përdorim termin “hermetik” me kuptimin “sekret”, “i mbyllur në mënyrë të tillë që asgjë nuk mund të dalë”, “i padepërtueshëm” etj., e kjo si pasojë e faktit që pasuesit e Hermetit, gjithmonë mbajtën parasysh parimin e fshehtësisë në mësimdhëniet e tyre. Ata nuk besonin në “hedhjen e perlave derrave”, por i përmbaheshin fjalës së urtë “qumësht për foshnjat; mish për burrat e fortë”, të dyja këto shprehje të njohura për lexuesit e shkrimeve të shenjta të Krishtere, por që të dyja të përdorura nga Egjiptianët për shekuj të tërë përpara erës së Krishterë.

Kjo politikë e propagandimit të kujdesshëm të të vërtetës i ka karakterizuar gjithmonë Hermetistët, madje edhe sot e kësaj dite. Doktrinat Hermetike mund të gjenden në çdo truall, ndër të gjitha fetë, por asnjëherë të identifikuar me një shtet të caktuar apo ndonjë sekt fetar të veçantë. Kjo për shkak të paralajmërimit të mësuesve të lashtë, për të mos e lejuar kristalizimin e Doktrinës së Fshehtë në një fe. Urtësia e kësaj këshille është e dukshme për të gjithë studentët e historisë. Okultizmi i lashtë i Indisë e Persisë degjeneroi dhe humbi gjerësisht si pasojë e faktit që mësuesit u kthyen në priftërinj, duke përzierë teologjinë me filozofinë, e duke sjellë si pasojë humbjen graduale të okultizmit Indian e Persian në lëmshin e masës së kulteve supersticioze fetare, besëtytnive dhe “perëndive”. Kështu ndodhi me Greqinë dhe Romën e Lashtë. Kështu ndodhi me Mësimet Hermetike e Gnostikëve dhe të Krishterëve të Hershëm, të cilat humbën në kohën e Konstandinit, dora e hekurt e të cilit e mbyti filozofinë me shtrojen e teologjisë, duke i shkullur Kishës së Krishterë atë çka ishte thelbi e shpirti i saj, e duke e bërë të endej kuturu për shekuj të tërë përpara se të gjente sërish udhën për te besimi i saj i vjetër; shenja këto të dallueshme lehtësisht nga të gjithë vëzhguesit e vëmendshëm në këtë Shekull të Njëzetë, kur Kisha tashmë po lufton t’u kthehet pas mësimëve të saj të lashta mistike.

Por ka pasur gjithmonë disa shpirtra besnikë të cilët e kanë mbajtur të gjallë Flakën, janë përkujdesur për të e nuk kanë lejuar që drita e

saj të venitet. Dhe është falë këtyre zemrave të patrembura e mendjeve të patundura, që e kemi ende të Vërtetën mes nesh. Por e Vërteta nuk gjendet në libra. Ajo është përçuar nga Mjeshtri te Nxënësi, nga Rishtari te Hierofanti, e pëshpëritur në vesh. E nëse ndonjëherë është shkruar, kuptimi i saj është mbuluar nën vellon e termave të alkimisë e astrologjisë, në mënyrë që vetëm ata të cilët zotërojnë çelësin të mund ta lexojnë drejtë. Kjo u bë e domosdoshme në mënyrë që të shmangeshin përndjekjet e teologëve të mesjetës, të cilët e luftuan Doktrinën e Fshehtë me zjarr e shpatë, turrë drush, trekëmbësh dhe kryq. Edhe sot nuk mund të gjenden veçse fare pak libra të besueshëm mbi Filozofinë Hermetike, paçka se ekzistojnë adresime të panumërta ndaj saj në shumë libra të shkruar në faza të ndryshme të Okultizmit. Prapëseprapë, Filozofia Hermetike është Çelësi i vetëm Universal i cili do të hapë të gjitha dyert e Mësimeve Okulte.

Në ditët e hershme, ekzistonte një përmbledhje e disa Doktrinave Themelore Hermetike, të përçuara nga mësuesi te nxënësi, e njohur me emrin “Kybalion”, një fjalë së cilës domethënia e kuptimi i kanë humbur prej shumë shekujsh. E megjithatë, ato që kjo përmbledhje mëson, njihen nga disa persona të cilëve u është përçuar gojarisht e brez pas brezi. Normat e saj nuk janë shkruar apo shtypur kurrë me aq sa dimë. Kanë qenë thjesht një koleksion parimesh, aksiomash dhe normash, të cilat ishin të pakuptueshme për të huajt, por menjëherë të zbërthyeshme nga nxënësit në momentin që këto parime, aksioma e norma, u shpjegoheshin e ilustrroheshin me shembuj Neofitëve nga Rishtarët Hermetikë. Këto mësimë përbënin në të vërtetë principet bazë të “Artit të Alkimiisë Hermetike”, i cili ndryshe nga sa besohet masivisht, merrej me Mjeshhtërinë e Forcës Mendore dhe jo me Elementët Materialë; shndërrimin e Lëkundjeve Mendore nga një lloj në një tjetër, dhe jo shndërrimin e një lloj metali në një tjetër. Legjenda e “Gurit Filozofik” i cili do të kthente metale bazë ne flori, ishte një alegori që kishte lidhje me Filozofinë Hermetike, lehtësisht e kuptueshme nga të gjithë nxënësit e Hermeticizmit të vërtetë.

Në këtë libërth, kapitulli i parë i të cilit është pikërisht ky, ne i ftojmë nxënësit tanë të hulumtojnë Doktrinën Hermetike, ashtu siç

këshillon Kybalioni dhe vetë ne, nxënës të përlurur të kësaj doktrine, të cilët megjithëse mbajmë titullin “Rishtarë”, mbetemi gjithësesi nxënës në këmbët e Hermesit, Mjeshtrit. Ne pra, ju japim këtu shumë nga parimet, aksiomat e normat e Kybalion-it, të shoqëruara me shpjegime dhe ilustrime të cilat ne gjykojmë se kanë më shumë gjasë t’i bëjnë mësimet lehtësisht të kuptueshme nga nxënësi i sotëm, kryesisht për faktin se teksti origjinal është qëllimisht i mbuluar nën vallon e terminologjisë së errët.

Në vijim të tekstit, parimet, aksiomat dhe normat origjinale të “Kybalionit” janë të shtypura në formë citatesh me pikësimin përkatës, pa iu prekur autorësia. Ndërkohë, puna jonë vetjake është shtypur në mënyrë të rregullt si trup i faqes. Kemi besimin se nxënësit të cilët kanë tashmë në duar këtë punim të vogël, do të përfitojnë po aq shumë prej faqeve të tij sa shumë të tjerë para tyre, duke ndërmarrë të njëjtën Udhë drejt mjeshhtërisë, përmes gjithë shekujve që kanë kaluar që nga koha e HERMES TRISMEGISTUSIT, Mjeshtrit të Mjeshtrave, të Madhit të të Mëdhenjve. Në fjalët e “Kybalionit” gjejmë:

“Kur dëgjohen hapat e Mjeshtrit, veshët e atyre që janë gati për Mësimdhënien e tij hapen katër.” – Kybalioni.

“Kur veshët e nxënësit janë gati për të dëgjuar, atëherë vijnë buzët që do t’i mbushin me Dituri.” – Kybalioni.

Kështu pra, në përputhje me Doktrinën, shfaqja e këtij libri do të tërheqë vetëm vëmendjen e atyre që janë të përgatitur për t’i pritur këto Mësime. Kur nxënësi të jetë gati për të pritur të Vërtetën, atëherë ky libërth do të mbërrijë tek ai ose ajo. I tillë është Ligji. Parimi Hermetik i Shkakut dhe Pasojës, nën këndvështrimin e tij të Ligjit të Tërheqjes, do të sjellë së bashku buzët dhe veshët, nxënësin dhe librin. Kështu u bëftë!

Kapitulli II

SHTATË PARIMET HERMETIKE

“Shtatë janë Parimet e së Vërtetës; ai i cili i njeh dhe i kupton, zotëron Çelësin Magjik që hap në çast të gjitha Dyert e Tempullit ende pa i prekur.” – Kybalioni

Shtatë parimet Hermetike mbi të cilat bazohet e gjithë Filozofia Hermetike janë:

- I. PARIMI I MENTALIZMIT
- II. PARIMI I PËRKIMIT
- III. PARIMI I LËKUNDJES
- IV. PARIMI I POLARITETIT
- V. PARIMI I RITMIT
- VI. PARIMI I SHKAKUT DHE PASOJËS
- VII. PARIMI I GJINISË

Të Shtatë Parimet do të diskutohen dhe shpjegohen përgjatë kohës që përparojmë në këto mësimë. Sidoqoftë, në këtë pikë mund të japim një shpjegim të shkurtër për secilin prej tyre.

I. PARIMI I MENTALIZMIT

“GJITHËSIA është MENDJE; Universi është Mendor.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se “Gjithçka është Mendje”. Ai sqaron se GJITHËSIA (që është Realiteti Substancial nën të gjitha manifestimet dhe shfaqjet të cilat i njohim me termat “Universi Material”, “Fenomeni i Jetës”, “Materie”, “Energji”, shkurtimisht gjithçka që është e dukshme për shqisat tona materiale) është SHPIRT, i cili në vetvete është I PANJOHSHËM dhe I PAPËR-CAKTUESHËM, por që mund të konsiderohet dhe mendohet si një MENDJE E GJALLË, E PAFUNDME DHE UNIVERSALE. Ai gjithashtu shpjegon se e gjithë bota apo universi me dukuritë e tij, është thjesht një Krijim Mendor i GJITHËSISË, i cili u nënshtrohet Ligjeve të Gjërave të Krijuara, dhe se ky Univers në tërësi apo në pjesët apo njësitë e tij, ekziston në Mendjen e GJITHËSISË, brenda së cilës ne “jetojmë, lëvizim, dhe ekzistojmë”. Ky parim, duke treguar Natyrën Mendore të Universit, shpjegon lehtësisht të gjitha fenomenet e ndryshme mendore dhe psikike që zënë një pjesë kaq të madhe të vëmendjes publike, dhe të cilat, pa një shpjegim të tillë, mbeten të pakuptueshme dhe sfidojnë çdo trajtimin shkencor. Kuptimi i drejtë i Parimit të madh hermetik të Mentalizmit, i mundëson individit të rrokë menjëherë ligjet e Universit Mendor, dhe t’i zbatojë ato në funksion të mirëqenies dhe përparimit vetjak. Nxënësi Hermetik është i aftë t’i zbatojë Ligjet e mëdha Mendore në mënyrë inteligjente, në vend që t’i përdorë ato kuturu. Me Çelësin Universal në duart e tij, nxënësi është i aftë të hapë dyert e shumta të tempullit mendor e psikik të diturisë, dhe të hyjë aty lirisht e me zgjuarsi. Ky parim shpjegon natyrën e vërtetë të “Energjisë”, “Forcës” dhe “Materies”; përse dhe në ç’mënyrë janë të varura këto të fundit nga Mjeshtëria e Mendjes. Një nga Mjeshtrit e vjetër Hermetikë shumë kohë më parë shkroi: “Ai i cili shtie në dorë të vërtetën e Natyrës Mendore të Universit, ka përparuar larg në Udhën drejt mjeshtërisë.”

Dhe këto fjalë janë po aq të vërteta sot, sa në kohën kur u shkruan për herë të parë. Pa këtë Çelës Universal, Mjeshtëria është e pamundur dhe nxënësi troket më kot në dyert e shumta të Tempullit.

II. PARIMI I PËRKIMIT

“Si lart, ashtu edhe poshtë; si poshtë ashtu edhe lart.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se ka gjithmonë një Përkim midis ligjeve dhe fenomeneve të rrafshëve të ndryshme të Ekzistencës dhe Jetës. Aksioma e vjetër Hermetike shfaqet me këto fjalë: “Si lart, ashtu edhe poshtë; si poshtë ashtu edhe lart.” Rrokja e këtij parimi, fal mjetet për zgjidhjen e shumë paradokseve të errëta dhe mistereve të fshehta të Natyrës. Ekzistojnë rrafshë përtej perceptimit tonë për të cilat jemi të aftë të mësojmë shumë, vetëm pasi u aplikojmë Parimin e Përkimit. Në të kundërt ato do të mbeteshin të panjohura për ne. Ky Parim, gjen zbatim dhe manifestim universal në rrafshet e ndryshme të universit material, mendor e shpirtëror; ky Parim është një Ligj Universal. Hermetistët e lashtë e konsideronin këtë Parim si një nga instrumentet mendore më të rëndësishme, nëpërmjet të cilit njeriu ishte i aftë të mënjanonte pengesat që fshihnin e mbulonin të Panjohurën. Falë këtij Parimi, u bë e mundur të ngrihej Velloja e Isisit aq sa për të hedhur një shikim të rrufeshëm mbi fytyrën e perëndeshës. Ashtu siç njohja e Principeve të Gjeometrisë i mundëson njeriut të matë diej të largët dhe lëvizjet e tyre teksa rri ulur në observatorin e tij, ashtu edhe Parimi i Përkimit i mundëson Njeriut të arsyetojë me mençuri nga e Njohura tek e Panjohura. Duke studiuar monadën, ai kupton Krye Engjëllin.

III. PARIMI I LËKUNDJES

“Asgjë nuk prehet çdo gjë lëviz; gjithçka lëkundet.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se “gjithçka është në lëvizje”; “gjithçka lëkundet”, “asgjë nuk prehet”; fakte të vërtetuara nga shkencë bashkëkohore të cilat konfirmohen pas çdo zbulimi të ri shkencor. E megjithatë, ky Parim Hermetik është shpallur mijëra vite më parë nga Mjeshtrit e Egjiptit të Lashtë. Ky parim shpjegon

se dallimet midis manifestimeve të ndryshme të Materies, Energjisë, Mendjes e madje edhe Shpirtit, janë tërësisht pasojë e shpeshtësisë së ndryshme të Lëkundjes (Vibrimit). Duke nisur që nga GJITHËSIA që është Shpirt i Pastër, e duke përfunduar te forma më bruto e Materies, gjithçka lëkundet; sa më e lartë lëkundja, aq më i lartë pozicioni në shkallë. Lëkundja e Shpirtit është aq pafundësisht e shpeshtë dhe e shpejtë, saqë është praktikisht në prehje; ashtu siç duket e palëvizshme një rrotë e cila vërtitet me shpejtësi. Ndërkohë në skajin tjetër të shkallës, ekzistojnë forma materie bruto me lëkundje aq të ulëta saqë duken edhe ato në prehje. E midis këtyre dy poleve shtrihen miliona e miliona gradë të ndryshme lëkundjeje. Që nga grimca e elektroni, atomi e molekula, deri te botët e universet, gjithçka lëviz duke u lëkundur. Kjo është njësoj e vërtetë edhe për rrafshet e energjisë dhe forcës (që nuk janë gjë tjetër veçse gradë të ndryshme lëkundjeje), për rrafshet mendore (gjendjet e të cilëve varen nga lëkundjet), e madje edhe për rrafshet shpirtërore. Përqaftimi në mënyrë të drejtë i këtij Parimi së bashku me formulat e duhura, i mundëson nxënësit Hermetik të kontrollojë lëkundjet mendore si vetjake, ashtu edhe ato të të tjerëve. Mjeshtrit gjithashtu e aplikojnë këtë Parim për të mposhtur fenomene të Natyrës në mënyra të ndryshme.

“Ai i cili kupton drejtë Parimin e Lëkundjes, ka shtënë në dorë skeptrin e Pushtetit”, thotë një nga shkruarit e vjetër.

IV. PARIMI I POLARITETIT

“Gjithçka është e dyzuar; gjithçka ka pole; gjithçka ka çiftin e saj të së kundërtave; ngjashmëria dhe dallimi janë e njëjta gjë; të kundërtat janë identike në natyrën e tyre, por të ndryshme në gradë; skajet takohen; të gjitha të vërtetat nuk janë veçse gjysmë të vërteta; të gjithë paradokset mund të pajtohen.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se “gjithçka është e dyzuar”, “gjithçka ka dy pole”, “gjithçka ka çiftin e saj të së kundërtave”; të gjitha këto, aksioma të vjetra Hermetike. Ai shpjegon paradokset e vjetra që kanë mundur njerëz të shumtë e që janë formuluar si vijon: “Teza e antiteza kanë natyrë identike, por ndryshojnë në gradë”; “të kundërtat janë e njëjta gjë, të ndryshme vetëm në gradë”; “një çift

kundërshtish mund të pajtohet”; “skajet takohen”; “gjithçka është dhe s’është në të njëjtën kohë”; “të gjitha të vërtetat nuk janë veçse gjysmë të vërteta”; “çdo e vërtetë është gjysmë e rreme”; “ka dy anë të gjithçkaje” etj., etj. Parimi sqaron se gjejmë dy pole apo aspekte të kundërta në gjithçka, dhe se këto “të kundërta”, në të vërtetë nuk janë veçse dy skaje të së njëjtës gjë, me shumë gradë të ndryshme që qëndrojnë midis. Për ilustrim: Nxehtësia dhe Ftohtësia, megjithëse “të kundërta”, në të vërtetë janë e njëjta gjë; dallimi ndërmjet tyre qëndron thjesht në diferencën e gradëve të së njëjtës gjë. Shikoni termometrin tuaj dhe kërkonte nëse mund të gjeni ku mbaron “nxehtësia” e ku fillon “ftohtësia”. Nuk ekziston diçka e tipit “nxehtësi absolute” apo “ftohtësi absolute”. Dy termat “nxehtësi” e “ftohtësi” thjeshtë tregojnë diferencë gradësh të së njëjtës gjë, dhe kjo “gjë e njëjtë” e cila shfaqet si “nxehtësi” e “ngrohtësi”, nuk është tjetër veçse një formë, lloj dhe frekuencë Lëkundjeje. Kështu “nxehtësia” e “ftohtësia” janë thjeshtë “dy pole” të asaj që ne quajmë “ngrohtësi”, dhe fenomenet që e shoqërojnë janë shfaqje të Parimit të Polaritetit. I njëjti Parim manifestohet në rastin e “Dritës dhe Errësisë”, që janë e njëjta gjë, por me diferencën në gradë që qëndron midis dy poleve të fenomenit. Ku përfundon “errësira” e ku nis “drita”? Ku qëndron dallimi midis “Madhësisë e Vogëlsisë”? Midis “Fortësisë e Butësisë”? Midis “së Bardhës e së Zezës”? Midis “Mprehtësisë e Topitjes”? Midis “Zhurmës e Qetësisë”? Midis “Lartësisë e Ultësisë”? Midis “Pozitives e Negatives”?

Parimi i Polaritetit i sqaron më së miri këto paradokse, e asnjë Parim tjetër nuk mund ta zëvendësojë. I njëjti Parim vepron në Rrafshin Mendor. Le të marrim një shembull radikal dhe të skajshëm si “Dashuria dhe Urrejtja”, dy gjendje mendore në dukje krejtësisht të ndryshme. E megjithatë, ekzistojnë gradë të Dashurisë e gradë të urrejtjes, dhe diku në mes, një pikë në të cilën përdorim shprehje si “pëlqim” apo “mospëlqim”, hijet e të cilave shkrihen aq gradualisht sa ndonjëherë nuk e kuptojmë nëse ndjejmë “pëlqim”, “mospëlqim” apo “asnjërin”. E nëse mendoheni një çast do të vini re se të gjitha nuk janë veçse shkallë apo gradë të së njëjtës gjë. Për më tepër (e konsideruar nga Hermetistët me rëndësi të madhe), është e mundur të ndryshohen lëkundjet e urrejtjes në lëkundje Dashurie, si në

mendjet tona, ashtu edhe në mendjet e të tjerëve. Shumë prej jush që po lexoni këto fjalë, keni pasur përvoja vetjake me kalimin e shpejtë e të pavullnetshëm nga Dashuria në Urrejtje dhe anasjelltas, qoftë personale apo të mësuarra prej të tjerëve. Ju do të bëheni kështu të aftë të kuptoni se si mund të realizohet kjo duke përdorur Vullnetin nëpërmjet shfrytëzimit të formulave Hermetike. “E Mira dhe e Keqja” nuk janë veçse pole të së njëjtës gjë, dhe Hermetistët e kuptojnë artin e shndërrimit të së Keqes në të Mirë, duke shfrytëzuar zbatimin e Parimit të Polaritetit. E thënë shkurt, “Arti i Polarizimit” bëhet një nga fazat e “Alkimiisë Mendore”, e njohur dhe e praktikuar si nga Mjeshtrit e lashtë Hermetikë, ashtu dhe nga ata të sotëm. Njohja e këtij Parimi i mundëson dikujt të ndryshojë Polaritetin e tij dhe atë të të tjerëve, nëse i kushtohet koha dhe studimi i domosdoshëm njohjes me themel të këtij arti.

V. PARIMI I RITMIT

“Gjithçka rrjedh në mënyrë qarkulluese; gjithçka ka baticën e zbaticën e saj; çdo gjë ngrihet e bie; luhatja e lavjerrësit shfaqet në gjithçka; luhatja në të majtë është e barabartë me lëkundjen në të djathtë; ritmi balancon.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se në gjithçka, shfaqet një lëvizje prej dhe drejt saj; një fluks në dalje e në hyrje; një përkundje para e pas; një luhatje si ajo e lavjerrësit; një baticë e një zbaticë ndërmyjet dy poleve në përputhje me Parimin e Polaritetit të përshkruar pak më parë. Ekziston gjithmonë një veprim e një kundërveprim, një përparim e një tërheqje, një lartësim e një fundosje. Kjo vlen për të gjithë elementët e Universit, diej, botë, qenie njerëzore, kafshë, mendje, energji dhe materie. Ky ligj manifestohet në krijimin e shkatërrimin e botëve, në lulëzimin e rënien e kombeve, në ciklin jetësor të të gjitha gjërave, e në fund, edhe në gjendjet mendore të Njeriut (ku sipas Hermetistëve qëndron edhe rëndësia kryesore e të kuptuarit të këtij Parimi). Hermetistët e kanë kuptuar mirë Parimin dhe zbatimin e tij universal, duke zbuluar gjithashtu disa mënyra për t’iu shmangur efektit të tij mbi ta, nëpërmjet përdorimit të formulave e metodave të duhura. Ata zbatojnë Ligjin Mendor të Asnjanësimit. Ata nuk mund

të shfuqizojnë Parimin apo ta ndalin veprimin e tij, por kanë mësuar si t'i shmangen ndikimeve të tij në njëfarë mase, në vartësi të nivelit të njohjes së Parimit. Ata kanë mësuar si ta PËRDORIN atë, në vend që të jenë të PËRDORUR prej tij. Pikërisht në këtë e në metoda të ngjashme konsiston Arti i Hermetistëve. Mjeshtri i Hermetikës polarizon vetveten në pikën ku dëshiron të prehet, e më pas asnjëson luhatjen Ritmike të lavjerrësit i cili do të prirej ta zhvendoste drejt polit tjetër. Të gjithë individët që kanë arritur të fitojnë njëfarë vetëkontrolli, e bëjnë këtë pak a shumë në mënyrë të pavetëdijshme, por Mjeshtri e bën në mënyrë të vetëdijshme duke përdorur Vullnetin e tij, e duke arritur një gradë të tillë Drejtpeshimi e Qëndrueshmërie Mendore, e cila është pothuajse e pabesueshme nga masat, të cilat luhaten para e pas si një lavjerrës. Ky Parim se bashku atë të Polaritetit, janë studiuar nga afër nga Hermetistët dhe metodat e kundërveprimit, asnjësisht dhe PERDORIMIT të tyre, përbejnë një pjesë të rëndësishme të Alkimiisë Mendore Hermetike.

VI. PARIMI I SHKAKUT DHE PASOJËS

“Çdo Shkak ka Pajojë në tij; çdo Pajojë ka Shkakun e saj; gjithçka ndodh në përputhje me Ligjin; Rastësi nuk është veçse emri që i japim një Ligjësie të panjohur; ekzistojnë shumë rrafshë shkakësie, por asgjë nuk i shpëton Ligjit.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se ekziston një Shkak për çdo Pajojë, e një Pajojë për çdo Shkak. Ai sqaron se “gjithçka ndodh në përputhje me Ligjin”; se asgjë nuk ndodh “thjeshtë sepse ndodh”; se nuk ekziston diçka si Rastësia; se megjithëse ka rrafshë të ndryshme Shkakut e Pajoje, ku rrafshet e epërme dominojnë të poshtmet, përsëri asgjë asnjëherë nuk i shpëton plotësisht Ligjit. Hermetistët e kuptojnë artin e metodat e lartësimit mbi rrafshin e rëndomtë të Shkakut e Pajojes deri në një farë mase, e duke u ngritur mendërisht në një rrafsh më të lartë, ata kthehen në Shkaktarë në vend që të pësojnë Pajoja. Masat e gjera merren përpara nga rryma, të bindura ndaj ambientit rrethues, ku vullnetet e dëshirat e atyre më të fortë se ta, trashëgimia, sugjestionit e shkaqe të tjera të jashtme i lëvizin si ushtarë mbi fushën e shahut të Jetës. Por Mjeshtrit duke u ngritur në rrafshin

e sipërm, dominojnë gjendjet e tyre shpirtërore, karakterin, cilësitë e forcat, si edhe ambientin që i rrethon, duke u kthyer në Lojtarë në vend të jenë ushtarë. Ata ndihmojnë TË LUHET LOJA E JETËS, në vend që të jenë thjeshtë pjesë e lojës, të lëvizur nga mjedisi rrethues apo nga vullneti i të tjerëve. Ata e PËRDORIN Parimin në vend që të jenë mjet i tij. Mjeshtrit i binden Shkakësisë së rrafsheve më të larta, por ndihmojnë të Sundohet rrafshi i tyre. Në këtë pohim përmbledhet një thesar njohurie Hermetike. Le ta kuptojë ai që mundet.

VII. PARIMI I GJINISË

“Gjinia ekziston në çdo gjë; gjithçka ka Parimet e saj Mashkullore e Femërore, Gjinia manifestohet në të gjitha rrafshet.” – Kybalioni

Ky Parim trupëzon vërtetësinë që pohon se GJINIA shfaqet në gjithçka; Parimet Mashkullore e Femërore veprojnë në mënyrë të vazhdueshme. Kjo nuk vlen vetëm për Rrafshin Fizik, por edhe për rrafshet Mendore e Shpirtërore. Në Rrafshin Fizik, Parimi manifestohet në formën e SEKSIT, ndërkohë që në rrafshe më të larta merr forma më të larta; në çdo rast gjithmonë i vlefshëm. Pa këtë Parim, krijimi, qoftë fizik, qoftë mendor apo shpirtëror është i pamundur. Përqaftimi i ligjeve të tij, hedh dritë mbi shumë çështje që kanë trazuar mendjet e njerëzve. Parimi i Gjinisë vepron gjithmonë në drejtim të gjenerimit, rigjenerimit dhe krijimit. Gjithçka e çdokush, mbart brenda tij ose saj dy Elementet e Parimit, ose vetë Parimin. Gjithçka Mashkullore ka Elementin Femëror dhe anasjelltas, gjithçka Femërore mbart në vetvete Parimin Mashkullor. Nëse dëshironi të kuptoni filozofinë e Krijimi, Gjenerimit apo Rigjenerimit Mendor e Shpirtëror, duhet të studioni dhe të kuptoni këtë Parim Hermetik. Ai përmban zgjidhjen e shumë mistereve të Jetës. Ju paralajmërojmë se ky Parim nuk ka asnjë lidhje me mësimet, praktikat dhe teoritë e shumta të rëndomta, të dëmshme dhe degraduese e pshore, të cilat përhapen nën tituj të trilluar, e që nuk janë gjë tjetër veçse një prostitucion i Parimit të madh natyral të Gjinisë. Ringjalljet e tilla të rëndomta të formave të lashta famëkeqe të Falicizmit, prirjen të shkatërrojnë mendjen, trupin dhe shpirtin. Filozofia Hermetike i ka rënë gjithmonë kamberës së

alarmit kundër këtyre mësimëve degraduese të cilat priren drejt epshit, shthurjes e zvetënimit të parimeve të Natyrës. Nëse janë mësimë të tilla ato mësimë që kërkoni, duhet të drejtoheni tjetërkund. Hermeticizmi nuk përmban asgjë për ju në këtë drejtim. Për të pastrin, gjithçka është e dëlirë; për të ndyrin, gjithçka është e fëlliqur.

Kapitulli III

TRANSMUTACIONI MENDOR

“Mendja (ashtu si metalet dhe elementet) mund të shndërrohet, nga një gjendje në një tjetër; nga një gradë në një tjetër; nga një konditë në një tjetër; nga poli në pol, nga lëkundja në lëkundje. Shndërrimi i Vërtetë Hermetik, është një Art Mendor.” – Kybalioni

Sic e kemi thënë më lart, Hermetistët ishin alkimistët, astrologët e psikologët e parë dhe Hermes i ishte themeluesi i këtyre shkollave të mendimit. Nga astrologjia u zhvillua astronomia bashkëkohore, nga alkimia hodhi rrënjë kimia e ditëve të sotme dhe nga psikologjia mistike u rrit psikologjia bashkëkohore që studiohet në shkolla. Por nuk duhet hamendësuar se të parët qenë injorantë në ato fusha, për të cilat sot shkolla pretendon se i ka prona të vetat të patjetërsueshme.

Hieroglifët e gdhendur në gurët e Egjiptit të Lashtë, tregojnë se të parët kishin njohuri të plota gjithëpërfshirëse mbi astronominë. Vetë Piramidat janë dëshmitare të lidhjes së ngushtë midis projektimit të tyre dhe studimit të shkencës së astronomisë. Ata nuk ishin injorantë as në Kimi, sepse fragmente të shkrimeve të lashta tregojnë se njihnin më së miri vetitë kimike të sendeve; për më tepër, teoritë e lashta mbi fizikën po vërtetohen ngadalë nga zbulimet e shkencës bashkëkohore, sidomos ato që kanë të bëjnë me përbërjen e materies. Nuk duhet hamendësuar as për injorancën e tyre mbi të ashtuquajturat zbulime bashkëkohore në psikologji, përkundrazi; Egjiptianët ishin veçanërisht të talentuar në shkencën e Psikologjisë, posaçërisht në degë që shkolla bashkëkohore nuk i merr parasysh, të cilat sidoqoftë po dalin në shesh nën emrin e “shkencave psikike”, duke i vënë në pozitë të pakëndshme psikologët e sotëm, e duke bërë që të pranojnë me ngurrim se “ndoshta mund të ketë diçka të vërtetë në to në fund të fundit.”

E vërteta është se nën kiminë, astronominë dhe psikologjinë materiale (nënkuptohet psikologjia në fazën e saj të studimit të mekanikës së trurit), të parët zotëronin një njohuri mbinatyrore të astronomisë të quajtur astrologji, një njohuri mbinatyrore të kimisë të quajtur alkimia dhe një njohuri mbinatyrore të psikologjisë të quajtur psikologji mistike. Ata zotëronin si Njohurinë e Brendshme ashtu edhe Njohurinë e Jashtme, ndërkohë që shkencëtarët bashkëkohorë zotërojnë vetëm të dytën. Midis shumë degëve të fshehta të diturisë së zotëruar nga Hermetistët, është edhe ajo që njihet si Transmutacioni Mendor, çka përbën edhe thelbin e subjektit të këtij kapitulli.

“Transmutacion”, është fjala që përdoret zakonisht për të përshkruar artin e lashtë të shndërrimit të metaleve, sidomos të metaleve bazë, në ar. Fjala “transmutacion” do të thotë “shndërrim i natyrës, formës apo substancës, në diçka tjetër; transformim” (marrë nga Webster). Në përputhje me këtë, “Transmutacion Mendor” nënkupton artin e ndryshimit dhe shndërrimit të gjendjeve mendore, formave dhe konditave, në të tjera. E parë në këtë prizëm, Shndërrimi Mendor është “Arti i Kimisë Mendore” nëse kjo shprehje ju duket e pëlqyeshme; një formë praktike e Psikologjisë Mistike.

Kjo nënkupton shumë më tepër nga sa duket në sipërfaqe. Shndërrimi, Alkimia apo Kimia në Rrafshin Mendor ka një rëndësi aq të madhe ndikuese, sa edhe sikur arti të kufizohej me aq, përsëri do të ishte një nga degët më të rëndësishme të studimit që njeriu ka njohur ndonjëherë. Por ky është vetëm fillimi. Le të shikojmë përse!

I pari nga shtatë Parimet Hermetike, është Parimi i Mentalizmit, aksioma e të cilit thotë: “GJITHËSIA është Mendje; Universi është Mendor.” Kjo do të thotë se Realiteti Themeltar i Universit është Mendje dhe se vetë Universi është Mendor, çka do të thotë se “ekziston në mendjen e GJITHËSISË.” Këtë Parim do ta studiojmë edhe në leksionet vijuese, por le të shohim efektet e tij të menjëhershme nëse e pranojmë si të vërtetë.

Nëse natyra e Universit është mendore, atëherë Shndërrimi Mendor duhet të jetë arti i NDRYSHIMIT TË KONDITAVE TË UNIVER-SIT përgjatë trajtave të Materies, Forcës dhe Mendjes. Siç e shikoni pra, Shndërrimi Mendor është në të vërtetë “Magjia” të cilën shkruesit e lashtë e përmendnin aq shpesh në veprat e tyre mistike, duke dhënë për të aq pak udhëzime praktike. Nëse Gjithçka është Mendore, atëherë arti që mundëson shndërrimin e kushteve mendore, duhet ta kthejë Mjeshtrin në kontrolluesin e kushteve apo konditave si materiale, ashtu edhe të atyre të quajtura rëndom “mendore”.

Në fakt, askush tjetër përveç Alkimistëve Mendorë të avancuar nuk ka qenë i aftë të zotërojë nivelin e nevojshëm të forcës për të kontrolluar fenomene fizike me peshë, si kontrolli i elementëve të Natyrës; prodhimi apo ndalimi i stuhive, prodhimi apo ndalimi i tërmeteve e fenomene të tjera Universale fizike. Por fakti që njerëz të tillë kanë ekzistuar e vazhdojnë të ekzistojnë sot e kësaj dite, pranohet me seriozitet nga të gjithë okultistët e avancuar të të gjitha shkollave. Mësuesit më të aftë, i sigurojnë Nxënësit e tyre se Mjeshtrit ekzistojnë dhe i kanë këto fuqi, duke qenë se ata vetë kanë pasur përvoja që justifikojnë besimin dhe deklaratat e tyre. Këta Mjeshtra nuk japin shfaqje publike të fuqive të tyre, por përpiqen të veçohen nga turmat në mënyrë që të shtrojnë sa më mirë Udhën e tyre drejt Lartësisimit.

Ne e përmendëm ekzistencën e tyre në këtë pikë, thjeshtë për të tërhequr vëmendjen tuaj në faktin që fuqia e tyre është tërësisht mendore, dhe vepron përgjatë trajtave të Shndërrimit të lartë Mendor, nën Parimin Hermetik të Mentalizmit. “Universi është Mendor” – Kybalioni.

Ndërkohë, nxënësit dhe Hermetistët e gradëve më të ulëta se Mjeshtrit, si Rishtarët dhe Mësuesit, janë plotësisht të aftë të veprojnë përgjatë Rrafshit Mendor në Shndërrim Mendor. Në fakt çdo gjë që ne quajmë “fenomen psikik”, “ndikim mendor”, “shkencë e mendjes”, “fenomeni i mendimit të ri” etj., vepron përgjatë të njëjtave trajta të përgjithshme, sepse nuk ka veçse një parim të përfshirë, pavarësisht se çfarë emri i jepet fenomenit.

Nxënësi dhe praktikanti i Shndërrimit Mendor punon në Rrafshin Mendor, duke shndërruar kushtet e gjendjet mendore në përputhje me formula të ndryshme, disa më shumë e disa më pak efikase. “Trajtimet”, “pohimet”, “mohimet” e ndryshme të shkollave të shkencave mendore, nuk janë veçse formula shpesh jo të përkryera dhe antishkencore të Artit Hermetik. Pjesa më e madhe e praktikantëve modernë janë mjaft të paditur krahasuar me mjeshtrit e lashtë, sepse iu mungon njohuria themeltare mbi të cilën ky art bazohet.

Nëpërmjet Metodave Hermetike mund të ndryshohen e shndërrohen jo vetëm gjendjet mendore të vetvetes. Mund të shndërrohen, dhe madje shndërrohen në mënyrë të pareshtur përmes së njëjtës rrugë, kryesisht pa ndërgjegje por shpesh edhe në mënyrë të ndërgjegjshme nga ata të cilët kuptojnë ligjet e parimet, edhe gjendjet mendore të të tjerëve në rastet kur këta të fundit nuk janë të informuar mbi parimet e vetëmbrojtjes. Për më tepër, ashtu siç dihet nga nxënësit dhe praktikantët e shkencës bashkëkohore mendore, çdo konditë materiale që varet nga mendja e tjetërkujt, mund të ndryshohet e shndërrohet në përputhje me dëshirën e fortë, vullnetin dhe “përpunimin” e personit që dëshiron kushte të ndryshuara të jetës. Publiku në ditët e sotme është përgjithësisht i informuar mjaftueshëm mbi këto çështje, kështu që nuk e gjykojmë të nevojshme të zgjatemi më tej. Qëllimi ynë në këtë pikë ishte thjeshtë të tregonim Artin dhe Parimin

Hermetik i cili fshihet nën format e ndryshme të praktikimit, qofshin këto dashamire apo dashakeqe, meqenëse forca mund të përdoret në të dy kahet në përputhje me Parimin Hermetik të Polaritetit.

Në këtë libër të vogël ne do të përshkruajmë parimet elementare të Shndërrimit Mendor, në mënyrë që lexuesit të kenë mundësinë të kuptojnë Parimet Themelore, e të zotërojnë kështu Çelësin Universal i cili do të hapë dyert e shumta të Parimit të Polaritetit.

Në vijim do të shqyrtojmë të parin e Shtatë Parimeve Hermetike, Parimin e Mentalizmit, në të cilin sqarohet vërtetësia që shpreh se “GJITHËSIA është Mendje; Universi është Mendor”, sipas fjalëve të Kybalionit. I kërkojmë nxënësve tanë t’i kushtojnë vëmendje të lartë dhe studim të kujdesshëm të këtij Parimi të madh, pasi ai është realisht Parimi Bazë i të gjithë Filozofisë Hermetike dhe i Artit Hermetik të Shndërrimit Mendor.

Kapitulli IV

GJITHËSIA

“Nën Universin e Kohës, Hapësirës dhe Ndryshimit, fshihet gjithmonë Realiteti Substancial, e Vërteta Themeltare.” – Kybalioni

Substanca nënkupton “atë çka qëndron nën të gjitha manifestimet e jashtme; thelbin, realitetin thelbësor, gjënë në vetvete” etj. “Substancial” nënkupton “atë çka ekziston në të vërtetë, të qenët element thelbësor, të qenët real” etj. “Realitet” do të thotë: “të qenët real, i vërtetë, i qëndrueshëm, i mirëqenë, i palëvizshëm, i përhershëm, i pranishëm” etj.

Nën dhe pas të gjitha shfaqjeve e dukjeve të jashtme, ka gjithmonë një Realitet Substancial. I tillë është Ligji. Njeriu që studion Universin, pjesë e të cilit është edhe ai vetë, nuk sheh gjë tjetër veç ndryshimeve të

vazhdueshme në materie, forcë dhe gjendje mendore. Ai vëren se në të vërtetë, asgjë nuk EKZISTON e pandryshuar, por gjithçka KRIJOHET dhe NDRYSHON. Asgjë nuk qëndron e palëvizur, gjithçka lind, rritet, vdes. Në të njëjtin çast në të cilin diçka arrin kulmin e saj atëherë fillon edhe e tatëpjeta; ligji i ritmit vepron në mënyrë të pareshtur; nuk ka realitet, cilësi të qëndrueshme, paluajtshmëri apo substancialitet në asgjë; nuk ka asgjë të përhershme përveç Ndryshimit. Njeriu vëren se gjithçka evoluon nga të tjera gjëra dhe zbërthehet në të tjera akoma; një veprim e kundërveprim i pareshtur; një rrjedhë që qarkullon brenda e jashtë; ndërtim dhe rrëzim; krijim e shkatërrim; lindje, rritje e vdekje. Nuk ka asgjë të qëndrueshme përveç Ndryshimit. E nëse ky njeri është mendimtar, ai kupton se të gjitha këto gjëra nën ndryshim të pareshtur, nuk janë veçse shfaqje e manifestime të një Force e cila qëndron nën gjithçka; të një Realiteti Substancial.

Të gjithë mendimtarët, në të gjitha trevat e në të gjitha kohërat, kanë pranuar domosdoshmërinë për një postulat mbi ekzistencën e këtij Realiteti Substancial. Çdo filozofi e denjë për t'u quajtur e tillë është bazuar mbi këtë ide. Njerëzit i kanë dhënë Realitetit Substancial shumë emra. Disa e kanë quajtur Hyjni (me emra të shumtë), të tjerë “Energjia e Pafundme dhe e Përvetshme”, të tjerë akoma janë munduar ta quajnë “Materie”, por të gjithë e kanë pranuar ekzistencën e tij. Është i vetëkuptueshëm e nuk ka nevojë për argumentim.

Në këto mësimë ne kemi ecur në hapat e disa prej mendimtarëve më të mëdhenj të botës, Mjeshtra Hermetikë si të lashtë ashtu edhe bashkëkohorë, dhe e kemi quajtur këtë Forcë Themelore, këtë Realitet Substancial, me emrin Hermetik “GJITHËSIA”, fjalë kjo të cilën e gjykojmë si më gjithëpërfshirësen nga të gjithë emrat e shumtë me të cilët Njeriu ka quajtur Atë çka qëndron përtej emrave, fjalëve e përkufizimeve.

Ne pranojmë e mësojmë pikëpamjen e mendimtarëve të mëdhenj Hermetikë të çdo kohe dhe atë të atyre shpirttrave të ndriçuar të cilët kanë mbërritur në rrafshë më të larta ekzistence, të cilët pohojnë

se natyra e brendshme e GJITHËSISË është E PANJOHËSHME. Kështu duhet të jetë, pasi asgjë përveç vetë GJITHËSISË nuk mund të kuptojë natyrën dhe ekzistencën e saj.

Hermetistët besojnë dhe mësojnë se GJITHËSIA “në vetvete” është dhe duhet të jetë gjithmonë E PANJOHËSHME. Ata i konsiderojnë të gjitha teoritë, hamendësimet dhe spekulimet e teologëve dhe metafizikëve mbi natyrën e brendshme të GJITHËSISË, si përpjekje femënore të mendjeve të vdekshme për të rrokur sekretin e Pafundësisë. Përpjekje të tilla kanë dështuar e do të dështojnë gjithmonë, pikërisht për shkak të natyrës së qëllimit që kanë. Dikush që ndjek pyetje të tilla, udhëton vazhdimisht për qark në labirintin e mendimit, derisa humb të gjithë logjikën e shëndoshë, veprimet e sjelljen e arsyeshme, duke u bërë përfundimisht i papërshtatshëm për jetën. Ai i ngjan ketrit i cili vrapon furishëm brenda rrotës së lëvizshme të kafazit të tij, duke udhëtuar pareshtur pa mbërritur askund; në fund sërish i burgosur, duke qëndruar pikërisht aty ku filloi.

Akoma më mendjemëdhenj janë ata të cilët orvaten t’i veshin GJITHËSISË personalitetin, cilësitë, tiparet, karakteristikat dhe vetitë e vetvetes, duke e veshur GJITHËSINË me emocione njerëzore, ndjenja dhe veçori deri tek cilësitë më të ulëta njerëzore si xhelozia, ndjeshmëria ndaj lëvdatave e lajkave, nevoja për blatime e adhurim, të gjitha këto mbeturina nga kohët kur raca njerëzore jetonte fëmijërinë e saj. Ide të tilla nuk janë të denja për burra e gra të rritur dhe po flaken tutje me shpejtësi.

(Në këtë pikë, do të ishte e përshtatshme të saktësohej se ne bëjmë një dallim ndërmjet Besimit dhe Teologjisë; ndërmjet Filozofisë dhe Metafizikës. Besim për ne, do të thotë të kuptuarit në mënyrë intuitive i ekzistencës së GJITHËSISË dhe marrëdhënia e dikujt me të; ndërsa Teologjia nënkupton orvatjet njerëzore për t’i veshur GJITHËSISË personalitet, cilësi e karakteristika; pikëpamje mbi çështjet, vullnetin, dëshirat, planet dhe projektet e saj; dhe pretendimin e zyrës së “ndërmjetësit” midis GJITHËSISË dhe njerëzve. Filozofi për ne, do të thotë të kërkuarit dituri mbi gjëra të njohshme e të mendueshme;

ndërsa Metafizika nënkupton orvatjen për ta mbartur këtë kërkim mbi dhe përtej kufijve, në lëme të panjohshme e të pamendueshme, dhe me të njëjtat prirje si ato të Teologjisë. Rrjedhimisht, ne i gjejmë si rrënjët e Besimit ashtu edhe të Filozofisë, të hedhura në Realitet, ndërkohë që Teologjia e Metafizika i ngjajnë xunkthit të këputur me rrënjë në baltën thithëse të injorancës, të paafta të ofrojnë mbështetje të sigurt as për mendjen e as për shpirtin e Njeriut. Nuk këmbëngulim që nxënësit tanë të pranojnë këto përkufizime. Ne i përmendëm thjeshtë për të qartësuar pikëpamjen tonë. Në çdo rast, në këto mësimë do të dëgjoni fare pak mbi Teologjinë e Metafizikën.)

“AJO çka është e Vërteta Themeltare, Realiteti Substancial, në të vërtetë qëndron përtej emërtimeve, por të Urtët e quajnë GJITHËSIA.” – Kybalioni

“GJITHËSIA është E PANJOHËSHME në Thelbin e saj.” – Kybalioni

“Megjithatë, kumtimi i Arsyes duhet prituri derë çelur dhe duhet trajtuar me nderim.” – Kybalion

Arsyeja njerëzore, zërin e së cilës duhet të pranojmë për sa kohë arrijmë të arsyetojmë, na kumton sa vijon mbi GJITHËSINË, gjithmonë pa u orvatur t'i heqë asaj vallon e TË PANJOHËSHMES:

1. GJITHËSIA duhet të jetë GJITHÇKA që EKZISTON REALISHT. Asgjë nuk mund të ekzistojë jashtë GJITHËSISË, përndryshe GJITHËSIA nuk do të ishte GJITHËSIA.

2. GJITHËSIA duhet të jetë E PAFUNDME, sepse nuk ka asgjë tjetër që mund ta përcaktojë, rrethojë, kufizojë apo mbyllë në caqe. GJITHËSIA është E PAFUNDME në kohë ose E PËRJETËSHME; duhet të ketë ekzistuar vazhdimisht, pasi nuk mund të ketë pasur kurrë diçka tjetër që ta ketë krijuar, sepse asgjë nuk mund të evoluojë nga hiçi, e nëse nuk do të “kishte qenë” qoftë edhe për një çast, nuk do të “ishte” tani. Duhet të ekzistojë vazhdimisht pasi nuk ka asgjë

tjetër që mund ta shkatërrojë, e nuk mundet “të mos jetë” qoftë edhe për një çast të vetëm, pasi diçka nuk mund të kthehet kurrë në hiç. GJITHËSIA duhet të jetë e Pafundme në Hapësirë; duhet të jetë Gjithkund pasi nuk ekziston vend tjetër jashtë GJITHËSISË; nuk mund të jetë përveçse e vazhdueshme në Hapësirë, pa këputje, ndalës, ndarje apo ndërprerje, pasi nuk ka asgjë që ta këputë, ndalojë, ndajë apo ndërpresë vazhdimësinë e saj, e asgjë tjetër për “të mbushur zbrazëtite”. Duhet të jetë e Pafundme në Forcë ose Absolute, pasi nuk ka asgjë që mund ta kufizojë, frenojë, përmbajë, izolojë, shqetësojë apo kushtëzojë; GJITHËSIA nuk i nënshtrohet asnjë Force tjetër pasi nuk ka asnjë Forcë tjetër.

3. GJITHËSIA duhet të jetë E PANDËRRUESHME apo e patjetërsueshme në natyrën e saj të vërtetë, pasi nuk ekziston asgjë që mund ta ndryshojë; asgjë nga e cila mund të jetë shndërruar apo asgjë në të cilën ajo mund të shndërrohet. Asaj nuk mund t’i shtohet, e nga ajo nuk mund të zbritet asgjë; nuk mund rritet apo të pakësohet, e as të bëhet më e madhe a më e vogël në çfarëdo pikëpamje qoftë. Duhet të ketë ekzistuar e duhet të ekzistojë gjithmonë pikërisht siç është tani, GJITHËSI. Nuk ka pasur, nuk ka, e nuk dot të ketë kurrë asgjë tjetër në të cilën ajo do të mund të shndërrohej.

Meqenëse GJITHËSIA është e Pafundme, Absolute, e Përjetshme dhe e Pandryshueshme, rrjedhimisht gjithçka e fundme, e ndryshueshme, kalimtare dhe e kushtëzuar nuk mund të jetë GJITHËSIA. Dhe përderisa nuk ka Asgjë jashtë GJITHËSISË në Realitet, atëherë të gjitha këto gjëra të fundme duhet të jenë Asgjë në Realitet. Ju kërkohet të mos turbulloheni apo trembeni; nuk po përpiqemi t’ju udhëheqim drejt Doktrinës së Krishterë nën maskën e Filozofisë Hermetike. Ekziston një Pajtueshmëri mbi këto çështje të cilat duken në kundërvënie. Bëni durim, do të mbërrimë atje kur të jetë koha.

Përreth nesh shikohet atë që quhet “Materie”, e cila përbën bazën fizike materiale të të gjitha formave. A është GJITHËSIA thjesht Materie? Aspak! Materia nuk mund të manifestojë Jetë apo Mendje, e përderisa si Jeta ashtu edhe Mendja manifestohen në Univers,

Materia nuk mund të manifestojë Jetë apo Mendje, e përderisa si Jeta ashtu edhe Mendja manifestohen në Univers, GJITHËSIA nuk mund të jetë Materie, pasi asgjë nuk mund të ngrihet më lart nga ku buron, asgjë nuk shfaqet brenda pasojës pa qenë edhe pjesë e shkakut, asgjë nuk kthehet në një përfundim pa qenë edhe pjesë e asaj që paraprin.

GJITHËSIA nuk mund të jetë Materie, pasi asgjë nuk mund të ngrihet më lart nga ku buron, asgjë nuk shfaqet brenda pasojës pa qenë edhe pjesë e shkakut, asgjë nuk kthehet në një përfundim pa qenë edhe pjesë e asaj që paraprin. Shkenca Bashkëkohore na mëson se në të vërtetë Materia nuk ekziston; se ajo që quajmë Materie është thjeshtë “energji apo forcë e ndërprerë”, pra energji apo forcë me lëkundje të ngadaltë. Ashtu siç ka thënë edhe një shkrimtar bashkëkohor “Materia u tret në Mister”. Edhe Shkenca Materiale e ka braktisur teorinë e Materies dhe tani mbështetet në bazat e “Energjisë”.

Atëherë a është vallë GJITHËSIA thjesht Energji ose Forcë? Jo Energji e Forcë në kuptimin që i japin materialistët fjalës, pasi energjia e forca e tyre janë gjëra të verbra, mekanike, pa Jetë e Mendje. Jeta e Mendja nuk mund të evoluojnë kurrsesi nga Energjia e Forca e verbër, për arsyen që dhamë një çast më parë: “Asgjë nuk mund të ngrihet më lart nga ku buron; asgjë nuk shtjellohet pa qenë e pleksur; asgjë nuk kthehet në një përfundim pa qenë edhe pjesë e asaj që paraprin”. Kështu GJITHËSIA nuk mund të jetë thjesht Energji apo Forcë, pasi nëse do të ishte, ekzistenca nuk do të njihte gjëra si Jeta dhe Mendja, e ne këtë e kuptojmë më së miri pasi jemi të Gjallë e duke përdorur Mendjen për të shtruar këto pyetje, po aq sa ata të cilët pretendojnë se Energjia apo Forca janë Gjithçka.

Çfarë ekziston pra në Univers e që qëndron më lart se Materia e Energjia? JETA DHE MENDJA! Jeta dhe Energjia në të gjitha gradët e tyre të ndryshme të shpalosjes! “Atëherë kërkoni të na thoni se GJITHËSIA është JETË dhe MENDJE?”, - do të pyesnit ju. Po dhe Jo është përgjigjja jonë. Nëse nënkuptoni Jetë dhe Mendje në mënyrën në të cilën i njohim ne, të vdekshmit e gjorë vocërrakë, përgjigjja është Jo! GJITHËSIA nuk është ajo. “Atëherë për çfarë

Jete e Mendje bëni fjalë?”, - pyesni ju.

Përgjigjja është “MENDJE QË JETON, shumë përtej kuptimit që të vdekshmit i japin këtyre fjalëve, pasi Jeta e Mendja qëndrojnë mbi forcat mekanike apo materien; MENDJE E GJALLË E PAFUNDME nëse do të krahasohej me Jetën e Mendjen e fundme.”

Me këtë duam të themi atë çka nënkuptojnë shpirtrat e përndritur, kur shqiptojnë me nderim fjalën : “SHPIRT!”

“GJITHËSIA” është Mendje e Gjallë e Pafundme; të Përndriturit e quajnë SHPIRT!

Kapitulli V

UNIVERSI MENDOR

“Universi është Mendor, i përfshirë në Mendjen e GJITHË-SISË” – Kybalioni

GJITHËSIA është SHPIRT! Por çfarë është Shpirti? Kësaj pyetjeje nuk mund t’i jepet përgjigje, pasi përkufizimi do të ishte vetë GJITHËSIA, çka nuk mund të shpjegohet e as të përkufizohet. Shpirt është thjesht emri të cilin njerëzit i japin konceptit më të lartë të Mendjes së Gjallë të Pafundme; shpirt do të thotë “Thelb i Vërtetë”; do të thotë Mendje e Gjallë më e lartë se Mendja e Jeta që njohim, ashtu siç qëndrojnë këto të fundit më lart se Energjia mekanike dhe Materia. Shpirti e tejkalon botëkuptimin tonë dhe ne e përdorim këtë fjalë thjeshtë që të kemi mundësi të mendojmë apo flasim për GJITHËSINË. Jemi të justifikuar kur mendojmë për Shpirtin si të ishte një Mendje e Gjallë e Pafundme për arsye studimi e arsyetimi, për sa

kohë pranojmë njëkohësisht se nuk mund ta kuptojmë atë plotësisht. Duhet patjetër t'i përmbahemi këtij pohimi, ose përfundimisht të mos mendojmë më mbi këtë çështje.

Le ta trajtojmë tani natyrën e Universit në GJITHËSINË e tij dhe në pjesët përbërëse. Çfarë është Universi? Kemi parë se nuk mund të ketë asgjë jashtë GJITHËSISË. Atëherë a është Universi GJITHËSIA? Jo, ai nuk mund të jetë, pasi Universi duket se përbëhet nga shumë gjëra dhe është në ndryshim të vazhdueshëm, e përfundimisht nuk përputhet as me idetë e formuluar në kapitullin paraardhës mbi GJITHËSINË, të cilat jemi të shtrënguar ti pranojmë. Nëse Universi nuk është GJITHËSIA, atëherë është “Asgjë”; ky do të ishte përfundimi i menjëhershëm i mendjes pa arsyetuar gjatë. Por as kjo përgjigje nuk mund të jetë e kënaqshme për pyetjen tonë, pasi ne jemi të ndjeshëm ndaj ekzistencës së Universit. Atëherë nëse Universi nuk është as GJITHËSIA e as “Asgjë”, çfarë mund të jetë? Le ta shqyrtojmë pyetjen.

Si në rastin kur Universi ekziston vërtetë, ashtu edhe në rastin kur duket sikur ekziston, ai duhet të burojë në ndonjë farë mënyre nga GJITHËSIA, pra duhet të jetë një krijim i GJITHËSISË. Por meqenëse diçka nuk mund të vijë kurrë nga hiçi, nga çfarë mund ta ketë krijuar GJITHËSIA atë? Disa filozofë i janë përgjigjur kësaj pyetjeje duke thënë se GJITHËSIA e krijoi Universin nga VETEVETJA; domethënë nga qenia dhe nga substanca e vetë GJITHËSISË. Por kjo nuk mund të jetë e vërtetë pasi siç e pamë, GJITHËSIA nuk mund të ndahet dhe as të hiqet diçka prej saj; e nëse do të qe vërtetë kështu, a nuk do të ishte vallë çdo grimcë në Univers e vetëdijshme për faktin se është GJITHËSIA? GJITHËSIA nuk mund të humbë vetëdijen e as të KTHEHET në atom, forcë të verbër apo gjallesë të rëndomtë. Njerëz të ndryshëm pasi rrokën idenë se GJITHËSIA është realisht GJITHÇKA, dhe duke pranuar që ata, njerëzit, ekzistonin, u hodhën në përfundimin se ata dhe GJITHËSIA ishin identikë, e kështu nisën të thërrisnin në kupë të qiellit “UNË JAM ZOTI”, duke defryer turmat e duke pikëlluar të urtët. Pretendimi i një atomi “Unë jam Njeri!” do të ishte më modest krahasuar me deklaratat e tyre.

Por vërtetë, çfarë është Universi nëse nuk është GJITHËSIA, e as krijim i GJITHËSISË duke fragmentuar vetveten në pjesë? Ç'tjetër mund të jetë; prej ç'të jetë krijuar? Kjo është pyetja e madhe. Le ta shqyrtojmë me kujdes. Vërejmë se këtu na vjen në ndihmë "Parimi i Përkimit" (shikoni Kapitullin II). Aksioma e vjetër Hermetike "Si lart, ashtu edhe poshtë" mund të bëhet e dobishme në këtë pikë. Le të përpiqemi të hedhim një shikim në çështjet e rrafsheve të epërme duke shqyrtuar ato në rrafshin tonë. Parimi i Përkimit është i zbatueshëm si në këtë rast, ashtu edhe në të tjerë.

Të shikojmë pak! Si krijon Njeriu në rrafshin e tij ekzistencial? Së pari, ai mund të krijojë duke ndërtuar diçka prej materialeve që e rrethojnë. Por kjo nuk mund të vlejë në rastin tonë, pasi nuk ka materiale jashtë GJITHËSISË me të cilat mund të krijohet diçka. Së dyti, ai shumon apo riprodhon specien e tij nëpërmjet procesit të çiftimit, që është riprodhim i përfutur nëpërmjet transferimit të një pjese të substancës së tij të filizat e rinj. Por edhe ky nuk mund të jetë rasti që kërkojmë pasi GJITHËSIA as nuk mund të transferojë apo të heqë një pjesë nga vetvetja, e as mund të riprodhojë apo shumëfishojë veten; në rastin e parë diçka do të zbritej apo hiqej prej saj, e në rastin e dytë GJITHËSIA do të shtohet apo shumëfishohet; që të dy rastet pra përbëjnë absurditet. A ka vallë një mënyrë të tretë nëpërmjet të cilës Njeriu mund të krijojë? Patjetër që ka; njeriu KRIJON MENDËRISHT. E duke vepruar në këtë mënyrë, ai nuk përdor materiale të jashtme dhe as shumëfishohet, e megjithatë Shpirti i tij përmbush Krijimin Mendor.

Duke zbatuar Parimin e Përkimit, mbërrijmë në arsyetimin e justifikuar, se GJITHËSIA e krijon Universin MENDËRISHT, në një mënyrë të ngjashme me procesin nëpërmjet të cilit Njeriu krijon Imazhet Mendore. Është pikërisht këtu që zëri i Arsyes përputhet saktësisht me zërin e të Përndriturve, siç dëshmohet edhe nga mësimet e shkrimet e këtyre të fundit. Të tilla janë mësimet e të Urtëve. Të tilla ishin mësimet e Hermesit.

GJITHËSIA nuk mund të krijojë në mënyrë tjetër përveçse

mendërisht, pa përdorur material (sepse nuk ka të tillë për t'u përdorur), e pa u riprodhuar (çka është gjithashtu e pamundur). Nuk ka arrati prej këtij konkluzioni të Arsyës, i cili siç e thamë më lart, është në ujdi me mësimet më të rëndësishme të të Përndriturve. Ashtu siç ju, një nxënës, mund të krijoni në mendjen tuaj një Univers tuajin, ashtu edhe GJITHËSIA krijon Universe në Mendjen e saj. Por Universi juaj është krijim mendor i një Mendjeje të Fundme, ndërkohë që ai i GJITHËSISË është krijim i një Mendjeje të Pafundme. Të dy janë të ngjashëm në natyrën e tyre, por pafundësisht të ndryshëm në gradë. Do ta trajtojmë më nga afër procesin e krijimit dhe manifestimit teksa përparojmë më tej. Por ajo çka duhet të ngulitni në mendje në këtë pikë është: UNIVERSI DHE GJITHÇKA AI PËRMBAN, ËSHTË NJË KRIJIM MENDOR I GJITHËSISË. Pa asnjë pikë dyshimi GJITHËSIA ËSHTË MENDJE!

“GJITHËSIA krijon në Mendjen e saj të Pafundme Universe të pafundmë, të cilët ekzistojnë në amshim; e megjithatë, për GJITHËSINË, krijimi, zhvillimi, rënia dhe vdekja e një milion universeve zgjat sa një pulitje qepallash.” – Kybalioni

“Mendja e Pafundme e GJITHËSISË është gjiri i Universeve.” – Kybalioni

Parimi i Gjinisë (shikoni Kapitullin II dhe të tjerët që vijojnë) manifestohet në të gjitha rrafshet e jetës, materiale, mendore apo shpirtërore qofshin. Por siç e kemi përmendur edhe më lart, “Gjini” nuk do të thotë “Seks”; seksi është thjesht një manifestim material i gjinisë. “Gjinia” është “ajo çka ka lidhje me gjenerimin apo krijimin”. Kurdo që diçka gjenerohet apo krijohet, në cilindo rrafsh, manifestohet domos Parimi i Gjinisë. Dhe kjo vlen edhe për krijimin e Universeve.

Mos u hidhni në përfundimin e nxituar se po ju mësojmë që ka një Zot ose Krijues mashkull apo femër. Kjo ide nuk është tjetër veçse një shtrembërim i mësimëve të lashta mbi këtë çështje. Doktrina e vërtetë thotë se GJITHËSIA në vetvete, qëndron mbi Gjininë, ashtu siç qëndron mbi çdo Ligj tjetër, përfshirë ata të Hapësirës e Kohës.

GJITHËSIA është LIGJI nga i cili burojnë Ligjet e nuk u nënshtrohet këtyre të fundit. Por kur GJITHËSIA manifestohet në rrafshin e gjenerimit apo Krijimit, atëherë vepron në përputhje me Ligjin dhe Parimet, për vetë faktin se po zhvendoset në një rrafsh më të ulët të Ekzistencës. Si pasojë, GJITHËSIA manifeston Parimin e Gjinisë në aspektin Mashkullor e Femëror, natyrisht në rrafshin mendor.

Kjo ide mund të tingëllojë befasuese për disa nga ju që e dëgjojnë për herë të parë, por në të vërtetë, të gjithë ju e keni pranuar në mënyrë pasive në botëkuptimin e përditshëm. Ju flisni për Atësinë e Zotit dhe Amësinë e Natyrës, për Zotin, Atin e Shenjtë, e për Natyrën, Mëmën Universale, duke pranuar instinktivisht Parimin e Gjinisë në Univers? A nuk është kështu vallë?

Nga ana tjetër, mësimet Hermetike nuk nënkuptojnë një dyzim të vërtetë. GJITHËSIA është NJË; Dy Aspektet nuk janë veçse aspekte të thjeshta të manifestimit. Sipas mësimëve, Parimi Mashkullor i shfaqur nga GJITHËSIA qëndron në një farë mënyre i ndarë nga krijimi mendor ekzistues i Universit. Ai ushtron Vullnetin e tij mbi Parimin Femëror (i cili mund të quhet “Natyre”) e kështu ky i fundit nis punën e vërtetë të evolucionit të Universit, që nga “qendrat e thjeshta të aktivitetit” deri tek njeriu, dhe më tutje e më lart akoma, gjithçka në përputhje me Ligjet e ngahershme e të prera të Natyrës. Nëse preferoni mënyrën e vjetër figurative të të menduarit, mund ta mendoni Parimin Mashkullor si ZOTI, Ati, dhe Parimin Femëror si NATYRA, Mëma Universale nga gjiri i së cilës ka lindur gjithçka. Kjo është shumë më tepër se një figurë poetike; është një ide e procesit real të krijimit të Universit. Por mos harroni kurrë se GJITHËSIA është gjithmonë NJË dhe është pikërisht brenda mendjes së saj që Universi gjenerohet, krijohet dhe ekziston.

Zbatimi i Ligjit të Përkimit mbi veten dhe mendjen tuaj, mund t’ju ndihmojë të kuptoni më saktë këtë ide. Ju e dini që pjesa juaj të cilën e quani “Unë”, në një farë mënyre qëndron veçmas dhe vështron krijimin e Imazheve Mendore në mendjen tuaj. Pjesa në mendjen tuaj në të cilën kryhet gjenerimi mendor mund të quhet “Mua”, e dallueshme

nga “Unë” që qëndron veçmas si dëshmitar pasiv dhe këqyr mendimet, idetë dhe imazhet e gjeneruara nga “Mua”. Mos harroni “Si lart, ashtu edhe poshtë” dhe fenomenet e njerit rrafsh të jetës mund të shfrytëzohen për të zbardhur misteret në rrafsh të tjera, më të larta apo më të ulëta.

Nuk ju duket vallë e çuditshme që Ju, bijtë, ndjeni një nderim instinktiv për GJITHËSINË, ndjenja të cilat i quajmë “fé”, respekt e përulësi për MENDJEN ATËRORE? Nuk ju duket vallë e çuditshme që kur këqyrni veprat dhe mrekullitë e Natyrës, përfshiheni nga një ndjenjë e fuqishme e cila i ka rrënjët thellë brenda qenies suaj? Kjo ndodh sepse ngjisheni butë pas MENDJES AMËNORE ashtu siç bën një foshnjë pas gjirit.

Mos bëni gabimin të mendoni se kjo botë e vogël që shikoni përreth jush, Toka, e cila nuk është veçse një grimcë pluhuri në Univers, është vetë Universi. Ekzistojnë miliona e miliona botë të tilla, e më të mëdha akoma. Dha ka miliona e miliona Universe që ekzistojnë brenda Mendjes së Pafundme të GJITHËSISË. Madje edhe në sistemin tonë të vogël diellor ka zona e rrafshje jetësore shumë më të larta se tonat, e qenie krahasuar me të cilat, ne, të vdekshmit tokësorë, ngajmë sikundër format baltake jetësore që rrojnë në shtratin e oqeanit kur krahasohen me Njeriun. Ekzistojnë qenie me fuqi dhe attribute më të larta se ato që Njeriu mund të imagjinojë se vetëm Perënditë i zotërojnë. E megjithatë, këto qenie dikur kanë qenë si ju, madje edhe më poshtë, e ju një ditë do të jeni si ato, madje edhe më lart me kalimin e kohës, sepse i tillë është shkruar Fati i Njeriut në kumtimet e të Përndriturve.

Vdekja nuk është reale as në kuptimin relativ të fjalës; ajo nuk është veçse Lindja në një jetë të re; Ju do të ngjiteni e ngjiteni, lart e më lart në rrafshje jetësore, në përjetësinë e kohës. Universi është shtëpia juaj dhe ju do të eksploroni edhe skutën më të largët të tij përpara fundit të Kohërave. Ju jetoni në Mendjen e Pafundme të GJITHËSISË dhe keni mundësi e shanse të pafundme si në Kohë ashtu edhe në Hapësirë. Dhe në fund të Ciklit të Madh të Kohërave, kur GJITHËSIA do

të tërheqë pas brenda vetvetes të gjitha krijimet e saj, ju do të shkoni buzagaz sepse atëherë do të jeni të aftë të njihni të Gjithë të Vërtetën e të qenit Një me GJITHËSINË. Ky është kumtimi i të Përndriturve; ata të cilët kanë ecur larg përgjatë Udhës.

Ndërkohë jetoni të qetë e në paqe; ndodheni të sigurt e të mbrojtur nga Fuqia e Pafundme e MENDJES ATËRORE-AMËNORE.

“Brenda Mendjes Atërore-Amënore, bijtë e vdekshëm ndodhen në shtëpinë e tyre.” – Kybalioni

“Në Univers askush nuk është pa Atë apo pa Mëmë.” – Kybalioni

Kapitulli VI

PARADOKSI HYJNOR

“Gjysmë të mençurit, duke e njohur mosvërtetësinë relative të Universit, imagjinojnë se mund të mposhtin Ligjet e tij; këta të marrë nuk janë veç mendjemëdhenj e fodullë të cilët thyhen pas shkëmbinjve e copëtohen prej elementëve, pikërisht për shkak të marrëzisë së tyre. I mençuri i vërtetë, përmes njohjes së natyrës së Universit, përdor Ligjin kundër ligjit; të lartin kundër të ulëtis; përmes Artit të Alkimitisë ai shndërron atë çka është e padëshirueshme në diçka me vlerë, duke dalë kështu ngadhënjimtar. Mjeshtëria nuk qëndron në ëndërrime anormale, vegime apo ide imagjinare, por në përdorimin e forcave të larta kundër atyre të ulëta, qëndron në

largimin prej vuajtjeve të rrafshëve të ulëta duke u lëkundur në ato të lartat. Transmutacioni, e jo mohimi arrogant, është arma e vërtetë e Mjeshtrit.” – Kybalioni

Ky është Paradoksi i Universit që buron nga Parimi i Polaritetit i cili shfaqet kur GJITHËSIA nis të krijojë. Vëri veshin sepse ai bën dallimin midis diturisë gjysmake e diturisë së plotë. Ndërkohë që për GJITHËSINË E PAFUNDME, Universi, Ligjet e tij, Forcat e tij, Jeta dhe Fenomenet e tij janë gjëra të cilat shihen në një gjendje Meditimi apo në Ëndërr, për gjithçka tjetër të Fundme, Universi është Real dhe duhet trajtuar si i tillë; në përputhje me këtë duhet të bazohet mënyra e të jetuarit, mënyra e të menduarit e të vepruarit, pavarësisht nga zotërimi i të Vërtetës së Lartë. Gjithsekush në përputhje me Rrafshin dhe Ligjet e tij. Nëse me të vërtetë GJITHËSIA do ta imagjinonte Universin si Realitet, atëherë mjerë Universi sepse nuk do të kishte shpëtim dhe largim nga rrafshet e ulëta për në ato të larta; Universi do të ishte i palëvizshëm dhe nuk do të qe më i mundur përparimi. E nëse Njeriu për shkak të diturisë gjysmake, vepron, jeton dhe mendon duke e konsideruar Universin thjeshtë një ëndërr (të ngjashme me ëndrrat e tij të fundme) atëherë vërtetë ashtu bëhet Universi për të; si një somnambul ai pengohet vazhdimisht duke ardhur për qark në rrathë, pa shkuar askund, e në fund detyrohet të zgjohet nga rrëzimi i nxirë dhe i gjakosur, pikërisht mbi Ligjet e Natyrës të cilat ka shpërfillur.

Mbajeni mendjen gjithmonë tek Ylli por shikimin mbi hapat që hidhni, përndryshe mund të rrëzoheni në baltë teksa i mbani sytë nga qielli. Mos harroni Paradoksin Hyjnor sipas së cilit megjithëse Universi NUK EKZISTON, prapëseprapë AI EKZISTON. Mbani mend përherë Dy Polet e së Vërtetës, Absolutin dhe Relativin. Ruhuni nga gjysmë të Vërtetat.

Ai që Hermetistët njohin me emrin “Ligji i Paradoksit”, në të vërtetë është thjeshtë një aspekt i Parimit të Polaritetit. Shkrimet Hermetike janë të mbushura me adresime ndaj daljes në pah të këtij Paradoksi gjatë trajtimit të problemeve të Jetës dhe Ekzistencës. Mësuesit i paralajmërojnë në mënyrë të vazhdueshme nxënësit e tyre për gabimin

që bëhet duke lënë jashtë “pjesën tjetër” të çdo pyetjeje. Paralamërimet e tyre janë të drejtuara veçanërisht në çështjet mbi Absoluten e Relativen të cilat pështjellojnë të gjithë studentët e filozofisë, e që bëjnë shumë njerëz të mendojnë e veprojnë në kundërshtim me çka njihet gjerësisht si “botëkuptimi i përgjithshëm”. Ne i porositim të gjithë nxënësit të sigurohen mirë që të kenë kuptuar në mënyrë të drejtë Paradoksin Hyjnor të Absolutes dhe Relatives, përndryshe do të ngecen në baltakun e Gjysmë të Vërtetës. Veçanërisht me këtë synim është shkruar edhe ky kapitull. Lexojeni me vëmendje!

Mendimi i parë që i vjen ndërmend njeriut kur njëmendëson të vërtetën se Universi nuk është veçse një Krijim Mendor i GJITHËSISË, është që Universi dhe gjithçka ai përmban është thjeshtë një iluzion, diçka jo reale, ide kjo ndaj së cilës instinktët e tij revoltohen. Por kjo, ashtu si të gjitha të vërtetat e tjera të mëdha duhet të merret në konsideratë si nga pikëpamja Absolute, ashtu edhe nga pikëpamja Relative. Nga pikëpamja Absolute, natyrisht Universi ka natyrën e një iluzioni, ëndrrë apo fantazmagorie nëse krahasohet me GJITHËSINË në vetvete. Këtë e pranojmë edhe në pikëpamjet tona të përditshme ndërsa i adresohemi botës si një “shfaqje teatrale kalimtare” që shkon e vjen, lind e vdes; realisht, faktori i paqëndrueshmërisë e ndryshimit, fundësisë e mosvërtetësisë, lidhet gjithmonë me idenë e një Universi të krijuar, ndërkohë që kontraston me idenë mbi GJITHËSINË, pavarësisht nga ajo që ne besojmë për natyrën e secilës. Filozofë, metafizikë, shkencëtarë e teologë janë të gjithë në ujdë mbi këtë pikë, e kjo ide gjendet në të gjitha format e mendimit filozofik dhe koncepteve fetare, si edhe në teoritë përkatëse të shkollave të metafizikës e teologjisë.

Kështu pra, megjithëse prezantimi i çështjes mund të duket befashues, Doktrina Hermetike nuk predikon mosvërtetësinë e Universit më shumë se zërat me të cilët jeni familjarizuar tashmë. Gjithçka që ka një fillim e një fund, në një farë mënyre duhet të jetë joreale dhe e pavërtetë, e Universi i nënshtrohet këtij rregulli në të gjitha shkollat e mendimit. Nga pikëpamja Absolute, nuk ka asgjë Reale përveç GJITHËSISË, pavarësisht nga emri që i japim në mendime

apo diskutime të ndryshme këtij subjekti. Qoftë i krijuar nga Materia, qoftë Krijim Mendor i GJITHËSISË, Universi mbetet jo substancial, i paqëndrueshëm, diçka e përbërë nga koha, hapësira dhe ndryshimi. Ju kërkojmë ta shqyrtoni këtë fakt në thellësi përpara se të jepni gjykim mbi konceptin Hermetik të natyrës Mendore të Universit. Bluani në mendje të gjitha konceptet e tjera dhe gjykoni nëse nuk është ky i vërteti.

Pikëpamja Absolute nuk tregon veçse njërën anë të medaljes; mbetet ana tjetër, ajo Relative. E Vërteta Absolute është përkufizuar si “Gjërat ashtu siç i njeh mendja e Perëndisë”, ndërkohë që e Vërteta Relative është përkufizuar si “Gjërat ashtu siç i kupton logjika më e lartë Njerëzore”. Kështu pra, ndërkohë që për GJITHËSINË Universi është joreal, iluzion, thjeshtë një ëndërr apo pasojë meditimi, prapëseprapë për mendjet e fundme që përbëjnë një pjesë të Universit e të cilat e perceptojnë atë nëpërmjet aftësive të vdekshme, Universi është pa dyshim mjaft real dhe si i tillë duhet trajtuar. Me pranimin e pikëpamjes Absolute nuk duhet të bëjmë gabimin e të mos marrit parasysh apo të të mohuarit të fakteve e fenomeneve të Universit, në formën në të cilën u prezantohen shqisave tona të vdekshme; mos harroni, ne nuk jemi GJITHËSIA.

Si ilustrim, mund të sjellim shembullin se të gjithë ne, pranojmë faktin që Materia “ekziston” për shqisat tona; do të ishte gabim i rëndë të mos e prananim. Megjithatë, edhe mendjet tona të fundme arrijnë të kuptojnë shpjegimin shkencor sipas së cilit, nga pikëpamja shkencore nuk ekziston diçka si Materia; se ajo çka quajmë Materie është thjesht një grupim atomesh, të cilët në vetvete janë thjesht grupime njësisish force të quajtura elektrone ose “jone”, që lëkundën në lëvizje rrethore konstante. Nëse qëllojmë një gur me këmbë ndjejmë goditjen; duket mëse i vërtetë pavarësisht se ne e dimë që është thjesht çka sqaruam pak më lart. Por mos harroni se këmba jonë e cila ndjen goditjen falë trurit, është gjithashtu Materie, e përbërë nga të njëjtat grimca atomike, e po kështu edhe truri ynë. E po të mos ishte për arsyen që zotëron Mendja jonë, as nuk do të dinim ç’është këmba apo guri.

Po kështu, mjaft real duket edhe ideali i artistit apo skulptorit, të cilin ai përpiqet ta riprodhojë në kanavacë apo gur. Po njësoj edhe personazhet në mendjen e shkrimtarit apo dramaturgut, te cilët ai kërkon t'i shprehë. E nëse këto duken kaq të vërteta për mendjet tona të fundme, cila është vallë shkalla e Realitetit e Imazheve Mendore të krijuara në Mendjen e të Pafundmes? Oh miq, për të vdekshmit ky Univers Mendor është mjaft real pa asnjë pikë dyshimi; është i vetmi që mund të njohim ndonjëherë, sido që ngrihemi nga rrafshi në rrafsh, gjithmonë e më lart brenda tij. Për ta njohur Universin ndryshe nga përvoja jonë, do të na duhej të ishim vetë GJITHËSIA. Është e vërtetë se sa më lart ngjitemi në shkallë, aq më pranë “mendjes Atërore” qasemi, e aq më e qartë bëhet natyra prej iluzioni e gjërave të fundme, por ky vegim nuk do të tretet plotësisht deri në momentin që GJITHËSIA më në fund të na tërheqë përsëri brenda vetvetes.

Kështu pra, nuk duhet t'i dorëzohemi paraqitjes së gënjeshtërt. Përkundrazi, le të njohim natyrën e vërtetë të Universit, të mundohemi të kuptojmë ligjet e tij mendore, të përpiqemi t'i përdorim në të mirën e përparimit tonë gjatë jetës, teksa udhëtojmë nga një rrafsh ekzistencial në një tjetër. Ligjet e Universit janë “Ligje të Hekurta” për shkak të natyrës së tyre mendore. Atyre u nënshtrohet gjithçka përveç GJITHËSISË. Çka gjendet NË MENDJEN E PAFUNDME TË GJITHËSISË është REALE, e tejkalohet vetëm nga Realiteti që gjendet në thelb të natyrës së GJITHËSISË.

Pra mos u ndjeni të pasigurt e të frikësuar; të gjithë ne RUHEMI NË MËNYRË TË PATUNDUR NË MENDJEN E PAFUNDME TË GJITHËSISË; nuk ka asgjë që mund të na dëmtojë apo nga e cila duhet të kemi frikë. Nuk ka asnjë Forcë tjetër jashtë GJITHËSISË që mund të na prekë. Mund të pushojmë të qetë e të sigurt. Në çastin kur ky nocion përqafohet plotësisht, zbulohet një botë e tërë ngushëllimi e sigurie. E atëherë “të qetë e paqësorë do të flemë, të përkundur në Djepin e Thellësisë”, teksa prehemi të sigurt në gjirin e Oqeanit të Mendjes së Pafundme, i cili është vetë GJITHËSIA. Vendi ku “ne jetojmë, veprojmë dhe ekzistojmë” gjendet brenda GJITHËSISË.

Materia mbetet Materie për ne ndërkohë që rrojmë në rrafshin Material, megjithëse e dimë se ajo nuk është veçse një grupim “elektronesh” ose grimcash Force, të cilat lëkunden me shpejtësi e rrotullohen për qark njëra-tjetrës duke formuar atome; atomet në radhë të tyre lëkunden e rrotullohen duke formuar molekula, e këto të fundit formojnë Materie në masë më të madhe. Materia mbetet Materie edhe kur e shtyjme më tej hulumtimin tonë, duke mësuar nga Doktrina Hermetike se “Forca”, njësi të së cilës janë grimcat atomike, nuk është veçse një manifestim i Mendjes së GJITHËSISË, e si gjithçka tjetër në Univers, është tërësisht Mendore në natyrën e saj. Për sa kohë që jetojmë në Rrafshin Material, na duhet të pranojmë fenomenin e tij; mund ta kontrollojmë Materien (ashtu siç bëjnë të gjithë Mjeshtrit e gradëve të ndryshme), por këtë e kryejmë duke zbatuar forca mbizotëruese. Kryejmë marrëzi nëse orvatemi të mohojmë ekzistencën e Materies në pikëpamjen relative. Mund të mohojmë dominimin e saj mbi ne, dhe me të drejtë kjo, por nuk duhet të shpërfillim aspektin e saj relativ, të paktën jo për aq kohë sa rrojmë në rrafshin e saj.

Ligjet e Natyrës nuk bëhen as më pak efikase apo konstante kur njëmendësojmë se edhe ato janë thjeshtë krijime mendore. Ato mbeten gjithmonë në fuqi në rrafshet shumëllojshme. Mund të mposhtim ligjet e ulëta duke zbatuar ligje mbizotëruese, po kjo është gjithçka mundemi të bëjmë. Nuk mund t’i shmangemi Ligjit apo të ngrihemi krejtësisht mbi të. Asgjë tjetër përpos GJITHËSISË, nuk mund t’i shpëtojë Ligjit, e kjo për arsye se GJITHËSIA është në vetvete LIGJI në të cilin i kanë rrënjët të gjitha ligjet. Mjeshtrit më të përparuar mund të fitojnë fuqi të cilat njerëzit kanë imagjinuar se vetëm perënditë mund t’i zotërojnë, por prapëseprapë në hierarkinë e madhe të jetës ka shkallë të pafundme të ekzistencës, qeniet dhe fuqitë e të cilave i tejkalojnë në masë të papërfytyrueshme nga të vdekshmit, edhe Mjeshtrit më të lartë njerëzorë; gjithsesi, si Mjeshtrit e përparuar ashtu edhe Qeniet e larta, janë të detyruara t’i nënshtrohen Ligjit e të jenë Kurrigjë në sytë e GJITHËSISË. Kështu, kur edhe vetë këto Qenie të larta, fuqitë e të cilave kapërcejnë ato fuqi të cilat njerëzit mendojnë se vetëm perënditë i kanë, i nënshtrohen detyrimisht Ligjit,

atëherë imagjinoni mendjemadhësinë e shfaqur nga raca e klasa jonë, nga njeriu i vdekshëm, kur guxon të konsiderojë Ligjet e Natyrës si të “pavërteta”, imagjinare dhe iluzione, vetëm e vetëm se arrin të konceptojë që Ligjet në natyrën e tyre janë Mendore dhe Krijim Mendor i GJITHËSISË. Nuk ka shmangie apo vënie në diskutim të Ligjeve sunduese të GJITHËSISË. Për sa kohë do të jetë Universi, do të qëndrojnë edhe ato, sepse Universi ekziston pikërisht falë këtyre Ligjeve, të cilat përbëjnë edhe skeletin që e mban në këmbë.

Parimi Hermetik i Mentalizmit, ndërsa sqaron natyrën e vërtetë të Universit kohor bazuar mbi parimin sipas të cilit gjithçka është Mendore, nuk ndryshon konceptet shkencore mbi Universin, Jetën apo Evolucionin. Në fakt shkenca thjeshtë konfirmon Doktrinën Hermetike. Këto të fundit na mësojnë se natyra e Universit është “Mendore”, ndërkohë që shkenca bashkëkohore na ka mësuar se është “Materiale”; apo rishtazi në analizë përfundimtare, “Energji”. Doktrina Hermetike nuk gabon kur pranon parimin themelor të Herbert Spencerit si postulat mbi ekzistencën e një “Energjie të Pafundme e të Përjetshme, prej të cilës buron gjithçka”. Në të vërtetë, Hermetikët gjejnë në filozofinë e Spencerit përshkrimin e “jashtëm” më të mirë që është bërë dhe shpallur mbi funksionimin e Ligjeve Natyrore, si edhe besojnë se Spenceri ka qenë rimishërimi i një filozofi të lashtë që rronte në Egjipt mijëra vjet më parë, i cili më pas u mishërua si Herakliti, filozofi grek i cili jetoi në vitet 500 para erës sonë. Hermetikët i vlerësojnë deklaratat e tij mbi “Energjinë e Pafundme e të Përjetshme” si plotësisht në përputhje me vijën e Doktrinës Hermetike, gjithmonë duke shtuar nga doktrina e tyre se “Energjia” për të cilën ai bën fjalë, është Energjia e Mendjes së GJITHËSISË. Të pajisur me Çelësin Universal të Filozofisë Hermetike, studentët e Spencerit do të jenë të aftë të çelin shumë dyer të koncepteve të thella filozofike të filozofit të madh anglez, puna e të cilit reflekton rezultatet e përgatitjes së mishërimit të tij paraardhës. Mësimet e tij mbi Evolucionin e Ritmin janë pothuajse në harmoni të përsosur me Mësimet Hermetike mbi Parimin e Ritmit.

Kështu pra nxënësit të Hermetikës nuk i nevojitet të lërë mënjane

asnjë nga pikëpamjet shkencore që ushqen në lidhje me Universin. Gjithçka kërkohet prej tij, është të rrokë parimin themelor që thotë se “GJITHËSIA është Mendje; Universi është Mendor, i përfshirë në Mendjen e GJITHËSISË”. Ai do të zbulojë se gjashtë nga Shtatë Parimet do të “pajtohen” me njohurinë e tij shkencore, do t’i shërbejnë të hedhë dritë në qoshe të errëta dhe të zgjidhë pyetje të turbullta. Kjo nuk duhet të na habitë nëse njohim ndikimin e mendimit Hermetik mbi filozofët e hershëm grekë, mbi themelet e mendimeve të të cilëve prehen masivisht teoritë e shkencës bashkëkohore. Pranimi i Parimit të Parë Hermetik (Mentalizmit), është pika e vetme e rëndësishme e ndarjes midis Shkencës Bashkëkohore dhe nxënësve Hermetikë, e Shkenca, në përpjekjet e saj për një rrugëdalje nga Labirinti i errët në të cilin është endur në kërkim të Realitetit, tashmë po lëviz gradualisht drejt pikëpamjes Hermetike.

Qëllimi i këtij mësimi është të ngulitë në mendjet e nxënësve faktin që sidoqoftë, në çdo rast e pa asnjë përjashtim, për Njeriun, Universi, ligjet dhe dukuritë e tij janë po aq Reale sa ç’janë edhe në hipotezat mbi Materializmin apo teoritë mbi Energjinë. Në cilëndo teori, Universi në aspektin e tij sipërfaqësor është vazhdimisht i ndryshueshëm e kalimtar, e rrjedhimisht i zhveshur nga substancialiteti e realiteti. Por (mos harroni polin tjetër të të vërtetës) përsëri nën të njëjtat teori, ne jemi të shtrënguar të VEPROJMË DHE JETOJMË sikur këto gjëra kalimtare të ishin reale dhe substanciale. Ky është edhe dallimi i përhershëm midis teorive të ndryshme; në pikëpamjet e vjetra Fuqia Mendore nuk merret parasysh si Forcë e Natyrës, ndërkohë që në Mentalizëm ajo është Forca Kryesore e Natyrës. Dhe është ky dallim i vetëm i cili ndryshon rrënjësisht Jetën e atyre të cilët e kuptojnë Parimin së bashku me ligjet e praktikat që rrjedhin prej tij.

Kështu pra, të gjithë ju nxënës, përqafoni epërsinë e Mentalizmit dhe mësoni të njihni, përdorni e zbatoni ligjet që rrjedhin prej tij. Por siç citon edhe Kybalioni, mos iu dorëzoni tundimeve që pushtojnë gjysmë të mençurit, e që bëhen shkak që këta të fundit të hipnotizohen nga mosvërtetësia në pamje të parë e gjërave, të rrojnë duke u endur në një botë ëndrrash, të lënë pas dore jetën e punën praktike, e

e përfundimisht “të thyhen përplasur pas shkëmbinjve e të copëtohen nga elementët për shkak të marrëzisë së tyre”. Ndiqni shembullin e të mençurit ashtu siç citohet edhe në Kybalion, “përdorni Ligjin kundër Ligjeve; të lartin kundër të ulëtis; e përmes Artit të Alkimiisë shndërroni atë çka është e padëshirueshme në diçka me vlerë, duke dalë kështu ngadhënjimtarë”. Le të ndjekim këshillat e Kybalionit për të evituar gjysmë mençurinë (që nuk është veçse marrëzi), e cila lë pas dore të vërtetën që thotë se “Mjeshtëria nuk qëndron në ëndërrime anormale, vegime dhe ide imagjinare, por në përdorimin e forcave të larta kundër atyre të ulëta; qëndron në largimin prej vuajtjeve të rrafshëve të ulëta duke u lëkundur në ato të lartat”. Mos harroni kurrë se “Transmutacioni, e jo mohimi arrogant, është arma e vërtetë e Mjeshtërit”. Citatet e mësipërme janë marrë nga Kybalioni dhe janë mëse të denja për t’iu besuar kujtesës së nxënësit.

Ne nuk rrojmë në një botë ëndrrash, por në një Univers i cili ndërkohë që është relativ, mbetet gjithsesi real në raport me jetën e veprimtarinë tonë. Qëllimi ynë në Univers nuk është të mohojmë ekzistencën e tij, por të JETOJMË vazhdimisht duke shfrytëzuar Ligjet për t’u lartësuar, të bëjmë më të mirën e mundshme në rrethanat e përditshme, të jetojmë aq gjatë sa është e mundur për të përqaftuar idetë e idealet tona më të larta. Kuptimi i vërtetë i Jetës nuk njihet nga njeriu në këtë rrafsh, por mjeshtërit më të lartë dhe intuita jonë personale, na mësojnë se nuk bëjmë gabim nëse jetojmë duke bërë më të mirën që kemi në vetvete, për aq gjatë sa kjo është e mundur, duke ndjekur prirjen Universale e duke udhëtuar në të njëjtin drejtim me të, pavarësisht nga dëshmi të dukshme për të kundërtën. Jemi të gjithë në Udhë; një udhë me vendpushime të shpeshta, por që të shpie gjithmonë e më lart.

Lexoni Kuntimin e Kybalionit; ndiqni shembullin e “të mençurve” duke shmangur gabimet e “gjysmë të mençurve” të cilët groposen nën marrëzinë e tyre.

Kapitulli VII

GJITHËSIA NË GJITHÇKA

“Në të njëjtën mënyrë në të cilën Gjithçka përfshihet brenda GJITHËSISË, ashtu edhe GJITHËSIA përfshihet brenda Gjithçkaje. Ai i cili e ka kuptuar këtë të vërtetë në thelb, ka përfituar dituri të vyer.” – Kybalioni

Sa e sa herë e kanë dëgjuar njerëzit të përsëritin shprehje sipas së Cilave Hyji i tyre (i njohur me emra të ndryshëm) ishte “Gjithçka në çdo gjë”, e sa pak kanë dyshuar ata mbi të vërtetën e brendshme okulte të trupëzuar në këto fjalë të shqiptuara në mënyrë të shkujdesur? Kjo shprehje e përdorur rëndom është trashëguar nga Parimi i lashtë Hermetik i cituar më lart. Kybalioni thotë : “Ai i cili ka kuptuar këtë të vërtetë në thelb, ka përfituar dituri të vyer”. Për këtë arsye, le ta shqyrtojmë këtë të vërtetë përqafimi i së cilës mbartka

një domethënie kaq të madhe. Në fjalët e singerta të kësaj Thënieje Hermetike, fshihet një nga të vërtetat më të rëndësishme filozofike, shkencore dhe fetare.

Ne ju përcollëm Mësimin Hermetik mbi Natyrën Mendore të Universit, faktin që “Universi është Mendor, i përfshirë në Mendjen e GJITHËSISË”. Kybalioni në fragmentin e cituar më sipër thotë: “Gjithçka përfshihet brenda GJITHËSISË”. Por mos anashkaloni pjesën tjetër të pohimit e cila thotë: “GJITHËSIA përfshihet brenda Gjithçkaje”. Kjo deklaratë në dukje kontradiktore është e pajtueshme nën Ligjin e Paradoksit. Për më tepër, ajo përbën një shprehje të saktë të marrëdhënieve që ekzistojnë midis GJITHËSISË dhe Universit të saj Mendor. Se në ç’mënyrë “Gjithçka ndodhet brenda GJITHËSISË” e kemi shqyrtuar më parë; tani le të sqarojmë aspektin tjetër të çështjes.

Doktrina Hermetike na mëson se GJITHËSIA është gjithmonë e pranishme, e pandarë, e përbrendshme dhe e qenësishme në Univers, në çdo pjesë, grimcë, njësi apo kombinim brenda Universit. Mësuesit e ilustrojnë shpesh këtë pohim duke iu adresuar Parimit të Përkimit. Mësuesi e udhëzon nxënësin të formojë një Imazh Mendor të diçkaje, goftë person, ide ose diçka që ka formë mendore, ku shembulli i preferuar do të ishte një autor a dramaturg që krijon një ide mbi personazhet e tij, ose një piktor apo skulptor që krijon imazhin e idealit të cilin dëshiron të shprehë nëpërmjet artit të tij. Në secilin nga rastet, nxënësi do të zbulojë se megjithëse imazhi ekziston vetëm brenda mendjes së tij, përsëri ai, nxënësi, autori, dramaturgu, piktori apo skulptori, në një farë mënyre është imanent, i qenësishëm, i pranishëm në mënyrë të pandashme në imazhin mendor. Me fjalë të tjera, i gjithë virtyti, jeta dhe shpirti i realitetit të imazhit mendor, përftohet nga “mendja imanente” e mendimtarit. Ndaluni mbi këtë ide për disa çaste derisa ta keni kuptuar.

Për të marrë një shembull bashkëkohor, le të themi se personazhe si Otello, Jago, Hamleti, Liri apo Rikardi i III-të, ekzistonin vetëm në mendjen e Shekspirit në kohën e ngjizjes apo të krijimit të tyre.

E megjithatë, Shekspiri ekzistonte njëkohësisht brenda secilit prej këtyre personazheve, duke u dhënë atyre gjallëri, shpirt dhe veprim. I kujt është shpirti brenda personazheve të njohur si Mikober, Oliver Tuist apo Uriah Hip? Është vallë i Dikensit, apo secili nga këta personazhe zotëron një shpirt të veçantë të pavarur nga krijuesi i tyre? A kanë shpirt dhe realitet të tyrin Afërdita de' Mediçi, Madona Sistine dhe Apollo i Belvederes, apo janë thjeshtë përfaqësues të forcës shpirtërore e mendore të krijuesve të tyre? Ligji i Paradoksit sqaron se të para në këndvështrimin e duhur, të dyja këto pohime qëndrojnë. Mikoberi është njëkohësisht Mikoberi por dhe Dikensi. Por ndërsa për Mikoberin mund të themi se është Dikensi, prapëseprapë Dikensi nuk është identik me Mikoberin. Njeriu, ashtu si Mikoberi, mund të thërrasë: “Shpirti i Krijuesit tim është i qenësishëm brenda meje, e megjithatë unë nuk jam AI!”. Sa shumë dallojnë nga kjo shprehje, gjysmë të vërtetat e trumbetuara zhurmshëm nga disa gjysmë të mençur, të cilët me britma të çjerra drejtuar qiellit thërrasin: “Unë jam Zoti!”. Imagjiloni Mikoberin e gjorë apo tinëzarin Uriah Hip ndërsa thërret: “Unë jam Dikensi!”, apo qoftë edhe ndonjë nga tarallakët e rëndomtë në ndonjë dramë Shekspiriane që deklaroi bujshëm: “Unë jam Shekspiri!”. GJITHËSIA ndodhet brenda krimbit të tokës, e megjithatë krimbi i tokës është larg nga të qenit GJITHËSIA. Sidoqoftë mrekullia mbetet; krimbi i tokës si një krijesë e rëndomtë, është krijuar dhe ekziston vetëm në Mendjen e GJITHËSISË, e në të njëjtën kohë GJITHËSIA është imanente brenda krimbit, ashtu si edhe në vetë grimcat të cilat përbëjnë këtë krimb toke. “Gjithçka ndodhet brenda GJITHËSISË dhe GJITHËSIA ndodhet brenda Gjithçkaje”; a ka vallë mister më të mrekullueshëm se ky?

Natyrisht që nxënësit e kanë të qartë se shembujt e mësipërm, domos nuk janë të përkryer e plotësisht të përshtatshëm, për arsyen e thjeshtë se ata përfaqësojnë krijimin e imazheve mendore në mendje të fundme, ndërkohë që Universi është krijim i një Mendjeje të Pafundme; dallimi qëndron në diferencën midis dy poleve. Gjithsesi kjo diferencë është thjeshtë në gradë ku mbetet në fuqi i njëjti Parim, ai i Përkimit, i cili manifestohet në secilin nga polet; “Si lart, ashtu edhe poshtë; si poshtë ashtu edhe lart”.

Njeriu lartësohet në shkallën shpirtërore të jetës, në përpjesëtim të drejtë me gradën e botëkuptimit që zotëron mbi ekzistencën e Shpirtit që qëndron në thelb të qenies së tij. Kjo është edhe domethënia e zhvillimit shpirtëror; njohja, përqaftimi dhe shfaqja e Shpirtit brenda nesh. Përpikuni ta mbani mend përkufizimin e mësipërm që i përket zhvillimit shpirtëror. Përmban Esencën e Fesë së Vërtetë.

Ka rrafshe e gradë të shumta Ekzistence në Univers, nën-rraftshe të panumërta të Jetës. Gjithçka varet nga avancimi i qenieve përgjatë shkallës në fundin e së cilës qëndrojnë format më bruto materiale, e kryet e së cilës vetëm një hap i ndan nga Shpirti i GJITHËSISË. Gjithçka lëviz përpara dhe lart përgjatë kësaj shkalle të jetës. Gjithçka ndodhet në një Udhë, në fundin e së cilës ndodhet GJITHËSIA. I gjithë progresi është një Kthim në Shtëpi. Çdo gjë ecën me kah Lart dhe Përpara, pavarësisht nga paraqitjet në dukje kontradiktore. I tillë është Mesazhi i të Përndriturve.

Mësimet Hermetike që kanë të bëjnë me procesin e Krijimit Mendor të Universit, thonë se në fillim të Ciklit Krijues, GJITHËSIA, nga aspekti i saj i “të Qenit” ushtron Vullnetin mbi aspektin e saj të “të Bërit”, e në këtë mënyrë nis procesi i krijimit. Thuhet se procesi konsiston në uljen e Lëkundjes derisa arrihet një nivel shumë i ulët i energjisë lëkundëse, pikë kjo në të cilën manifestohet forma më e thjeshtë e Materies. Ky proces quhet stadi i Involucionit (Përfshirjes), në të cilën GJITHËSIA “përfshihet” apo “plekset” në krijimin e saj. Hermetistët besojnë se ky proces Përkon me procesin mendor të një artisti, shkrimtari apo shpikësi, i cili është aq i pleksur në krijimin e tij mendor, saqë pothuajse harron ekzistencën e vetjake në kohën reale dhe “jeton brenda krijimit të tij”. Ndoshta mund të japim një ide më të mirë të asaj që dëshirojmë të përçojmë, nëse fjalën “pleksur” e zëvendësojmë me fjalën “zhytur”.

Ky stad Involucionar i Krijimit quhet rëndom edhe “Vërsхими” i Energjisë Hyjnore, në të njëjtën mënyrë në të cilën stadi Evolucionar quhet “Tërheqja”. Poli më i skajshëm i procesit Krijues konsiderohet si pika më e largët nga GJITHËSIA, ndërkohë që fillimi i stadit

Evolucionar trajtohet si pikënisja e kthimit pas të lavjerrësit të Rimit; një koncept ky i “rikthimit në shtëpi” i cili gjendet në të gjitha Doktrinat Hermetike.

Mësimet sqarojnë se gjatë “Vërshimit”, lëkundjet bëhen gjithmonë e më të ulëta derisa më në fund shtytja merr fund dhe nis ngadalë kthimi pas. Por ekziston një dallim; ndërkohë që gjatë “Vërshimit” forca krijuese shfaqet kompakte dhe sillet si një e vetme, në fillim të stadi Evolucionar apo “Tërheqës”, shfaqet Ligji i Individualizimit, që është prirja për t’u ndarë në Njësi Force. Kështu në përfundim, ajo çka la GJITHËSINË si një energji pa individualizëm, kthehet te burimi i saj në formën e Njësive të zhvilluara e të panumërta të Jetës, të cilat janë lartësuar në shkallë nëpërmjet Evolucionit Fizik, Mendor dhe Shpirtëror.

Hermetistët e lashtë përdornin fjalën “Meditim” për të përshkruar procesin e krijimit mendor të Universit në Mendjen e GJITHËSISË, duke përdorur jo rrallë në vend të saj edhe fjalën “Përsiatje”. Ideja që nënkuptohet, me sa duket ka të bëjë me Vëmendjen Hyjnore, ku fjala “Vëmendje” (“Attention” në tekstin origjinal) i gjen rrënjët e saj në gjuhën Latine dhe do të thotë “zgjatje/shtrirje”. Kështu, veprimi i të treguarit Vëmendje në këtë rast nënkupton “shtrirje/zgjerim/ përhapje” të energjisë mendore.

Për sa i përket procesit të Evolucionit, Doktrina Hermetike thotë se GJITHËSIA pasi ka medituar mbi procesin e Krijimit, duke hedhur në këtë mënyrë themelet materiale të Universit e duke bërë që ky i fundit të ekzistojë nëpërmjet mendimit, nis të zgjohet gradualisht nga Meditimi duke bërë që të manifestohet procesi i Evolucionit në rrafshin material, mendor e shpirtëror, sipas radhës së njëpasnjëshme. Në këtë mënyrë fillon lëvizja me kah lart, në drejtim të Shpirtit. Materia nis të bëhet më pak bruto, Njësitë lulëzojnë në qenie, nisin të shfaqen ndërthurjet, Jeta manifestohet në forma gjithmonë e më të larta dhe Mendja del gjithmonë e më shumë në pah; lëkundjet sa vijnë e rriten. Shkurtimisht, i gjithë procesi i Evolucionit, në të gjitha fazat e tij, nis dhe zhvillohet në përputhje me Ligjet e procesit të “Tërheqjes”.

E gjitha kjo kërkon epoka të tëra kohe Njerëzore, ku secila epokë përbëhet prej miliona e miliona vitesh të panumërta, por megjithatë, të Përndriturit na mësojnë se i tërë krijimi, përfshirë Involucionin dhe Evolucionin e një Universi, për GJITHËSINË nuk është veçse një pulitje qepallash. Në fund të cikleve të panumërta të epokave kohore, GJITHËSIA e shuan Vëmendjen, Përsiatjen dhe Meditimin e saj mbi Universin, duke qenë se Vepra e Madhe ka përfunduar; Gjithçka tërhiqet brenda GJITHËSISË prej nga edhe lindi. Por Mister mbi Misteret, Fryma e shpirtave nuk asgjësohet por zgjerohet pafundësisht; Krijesa dhe Krijuesi shkrihen në një. I tillë është kumtimi i të Përndriturve.

Shembulli i mësipërm i “meditimit” dhe “zgjimit nga meditimi” që pason, natyrisht nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje e Mësuesve për të ilustruar procesin e Pafund nëpërmjet një shembulli të fundëm. Gjithsesi “Si poshtë, ashtu edhe lart”. Dallimi qëndron vetëm në gradë. Në të njëjtën mënyrë në të cilën GJITHËSIA zgjon vetveten nga meditimi mbi Universin, ashtu edhe Njeriu (përgjatë kohës) ndalet së manifestuari në Rrafshin Material dhe e tërheq veten gjithmonë e më shumë drejt Shpirtit të Përbrendshëm, i cili është pikërisht “Ego Hyjnore”.

Ekziston edhe një çështje e fundit mbi të cilën dëshirojmë të ndalemi në këtë kapitull, e cila pothuajse futet në fushën spekulative të Metafizikës, megjithëse qëllimi ynë është pikërisht të dëshmojmë kotësinë e këtyre spekulimeve. Po aludojmë për pyetjen e cila lind pashmangshmërisht në mendjen e cilitdo mendimtari që ka kuturitur të kërkojë të Vërtetën. Kjo pyetje është: “PËRSE krijon GJITHËSIA Universe?”. Pyetja mund të shtrohet në forma të ndryshme, por formulimi i mësipërm përbën thelbin e vërtetë.

Njerëzit janë rrekur gjatë t’i përgjigjen kësaj pyetje, por ende nuk ekziston ndonjë përgjigje e denjë për t’u quajtur e tillë. Disa kanë hamendësuar se GJITHËSIA synon të përfitojë diçka në këtë mes, por kjo është absurde pasi GJITHËSIA ka gjithçka e nuk ka asgjë që ajo të mund të përfitojë. Të tjerë e kanë kërkuar përgjigjen në idenë

që GJITHËSIA “kërkonte diçka së cilës t’i dhuronte dashuri”, e të tjerë akoma në idetë që ajo krijonte për kënaqësi, për dëfrim, ngaqë “ndihej e vetmuar” apo për të manifestuar forcën e saj; të gjitha këto janë shpjegime dhe koncepte foshnjore të cilat i përkasin periudhës së mendimit të papjekur.

Disa të tjerë janë përpjekur ta shpjegojnë misterin duke propozuar se GJITHËSIA ndihet “e shtrënguar” të krijojë për shkak të vetë “natyrës së brendshme” të saj, apo “instinktit krijues” që zotëron. Kjo ide është më e përparuar se të tjerat, por pika e dobët e saj qëndron në konceptin e GJITHËSISË që ndihet “e shtrënguar” apo “e detyruar” nga çfarëdolloj gjëje, qoftë kjo e brendshme apo e jashtme. Nëse “natyra e brendshme” apo “instinkti krijues” e shtrëngojnë atë të bëjë diçka, atëherë “natyra e brendshme” apo “instinkt krijues” do të ishin Absoluti dhe jo GJITHËSIA, kështu rrjedhimisht kjo pjesë e këtij propozimi bie. Gjithsesi, mbetet fakti që GJITHËSIA krijon dhe manifeston, e në pamje të parë duket sikur gjen njëfarë kënaqësie duke vepruar në këtë mënyrë. Është e vështirë të shmanget konkluzioni se në një farë niveli të pafundmë, GJITHËSIA duhet të ketë diçka që ngjason me “natyrën e brendshme” apo “instinktin krijues” njerëzor, përkatësisht me Dëshirë e Vullnet të pafundmë. Ajo nuk do të vepronte nëse nuk do të kishte Vullnetin për të Vepruar, nuk do të kishte Vullnetin për të Vepruar nëse nuk do të ndjente Dëshirën për të Vepruar, dhe nuk do të ndjente Dëshirën për të Vepruar nëse nuk do përfntonte njëfarë Kënaqësie nga e gjitha kjo. Kështu gjithçka do t’i përkiste një “Natyre të Brendshme” e do të ekzistonte në formë postulatit në përputhje me Ligjin e Përkimit. E megjithatë, ne preferojmë të mendojmë për GJITHËSINË që ajo vepron krejtësisht E LIRË nga çdo ndikim, si i brendshëm ashtu edhe i jashtëm. Ky është problemi që qëndron në rrënjët e vështirësisë, dhe vështirësia që qëndron në rrënjët e problemit.

Për t’u treguar rreptësisht të saktë, nuk mund të thuhet se ekziston ndonjë “Arsye”, e çfarëdo lloji qoftë ajo, e cila shtyn GJITHËSINË të veprojë, pasi “arsyeja” do të nënkuptonte “shkak”, e GJITHËSIA qëndron mbi Shkakun dhe Pasojën, përveç rastit kur ajo ushtron

Vullnetin e saj për t'u kthyer në Shkak, kohë kjo në të cilën vihet në lëvizje Parimi. Pra siç e shihni, çështja është po aq e Pamendueshme, sa ç'është edhe GJITHËSIA e Panjohshme. Nuk kemi rrugë tjetër veçse të themi që "GJITHËSIA VEPRON, SEPSE VEPRON", në të njëjtën mënyrë në të cilën themi që GJITHËSIA thjesht "EKZISTON". Në fund të fundit, GJITHËSIA në vetvete përbën të gjitha Arsyet, të gjitha Ligjet, të gjitha Veprimet, e mund të thuhet me të drejtë se GJITHËSIA është Arsyeja e Vetvetes, Ligji i Vetvetes, Veprimi i Vetvetes; e më tutje akoma, GJITHËSIA, Arsyeja e Saj, Veprimi i Saj dhe Ligji i Saj janë NJË, të gjithë emra për të njëjtën gjë. Opinioni i atyre që po shkruajnë këto mësimë për ju, është se përgjigjja ndodhet e kyçur BRENDA VETË GJITHËSISË, së bashku me të Fshehtën e Ekzistencës së saj. Për mendimin tonë, Ligji i Përkimit mund të arrijë deri në aspektin e GJITHËSISË të cilin e njohim si "Aspekti i të Bërit". Pas këtij Aspekti qëndron "Aspekti i të QENIT", në të cilin të gjithë Ligjet shkrihen në LIGJ, të gjithë Parimet shkrihen në PARIM, dhe GJITHËSIA, PARIMI dhe QENËSIA janë IDENTIKË, TË NJËJTA DHE NJË E VETME. Rrjedhimisht spekulimi Metafizik në këtë pikë është pa dobi. U ndalëm mbi këtë çështje thjesht për të treguar se ne e njohim si pyetjen, ashtu edhe absurditetin e përgjigjeve të rëndomta metafizike e teologjike.

Në përfundim, mendojmë se do të shfaqte interes për nxënësit tanë të mësonin se megjithëse disa Mësues Hermetikë të lashtë apo bashkëkohorë kanë anuar në drejtim të zbatimit të Parimit të Përkimit për pyetjen, duke mbërritur në rezultatin e "Natyres së Brendshme", përsëri legjenda thotë se kur Hermesit, të Madhit, iu drejtua kjo pyetje nga nxënësit e tij të përparuar, ai u përgjigj duke PUTHITUR BUZËT FORT ME NJËRA-TJETRËN e duke mos nxjerrë asnjë fjalë, duke dëshmuar kështu se NUK KISHTE PËRGJIGJE. Ndoshta qëllimi i Hermesit mund të ketë qenë zbatimi i aksiomës së filozofisë së tij: "Buzët e Urtësisë janë të kyçura, përveçse për veshët e Arsyes", për të treguar se as nxënësit e tij më të përparuar nuk zotëronin forcë Arsyetuese të mjaftueshme për të qenë të denjë për këtë Mësim. Sidoqoftë, edhe nëse Hermesit e zotëronte Sekretin ai nuk e bëri të ditur, e për aq sa i përket botës, BUZËT E HERMESIT

JANË TË MBYLLURA mbi këtë çështje. E aty ku Hermes i Madh ngurroi të fliste, cili i vdekshëm do të guxonte të jepte mësim?

Mos harroni se cilado qoftë përgjigja e këtij problemi, nëse vërtetë ekziston një e tillë, mbetet i vërtetë fakti që “Në të njëjtën mënyrë në të cilën Gjithçka përfshihet brenda GJITHËSISË, ashtu edhe GJITHËSIA përfshihet brenda Gjithçkaje”. Doktrina në këtë pikë është e prerë. Tani mund t’i shtojmë edhe fjalët përmbyllëse citatit : “Ai i cili e ka kuptuar këtë të vërtetë në thelb, ka përfituar dituri të vyer”.

Kapitulli VIII

RRAFSHET E PËRKIMIT

*“Si lart, ashtu edhe poshtë; si poshtë ashtu edhe lart.” –
Kybalioni*

Parimi i Dytë i madh Hermetik, trupëzon vërtetësinë e ekzistencës së një marrëdhënieje harmonike dhe përkimin midis rrafshëve të shumta të Manifestimit, Jetës dhe Ekzistencës. Kjo vërtetësi, pranohet si e tillë pasi gjithçka në Univers e ka zanafillën në të njëjtin burim, e të njëjtat ligje, parime dhe karakteristika i aplikohen çdo njësie apo kombinimi njësisish vepruese, ku secila manifeston dukuritë përkatëse në rrafshin e saj.

Për lehtësi konceptimi e studimi, Filozofia Hermetike gjykon se Universi mund të ndahet në tre kategori dukurish, të njohura si Tri Rrafshet e Mëdha, të quajtura përkatësisht:

- I. Rrafshi i Madh Fizik
- II. Rrafshi i Madh Mendor
- III. Rrafshi i Madh Shpirtëror

Këto ndarje janë pak a shumë artificiale dhe arbitrare, pasi në të vërtetë ato nuk janë gjë tjetër veçse gradë lartësimi në shkallën e madhe të Jetës, ku shkallina e parë është Materia e pa diferencuar, dhe shkallina e fundit Shpirti. Për më tepër, Rrafshet e ndryshme shkrihen me njëri-tjetrin aq gradualisht, sa nuk mund të bëhet ndarje e prerë dhe e shpejtë midis dukurive të larta të rrafshit Fizik e atyre të ulëta të Mendorit; apo midis të lartave të Mendorit e të ulëtave të rrafshit Fizik.

Shkurtimisht, Tri Rrafshet e Mëdha mund të trajtohen si tri grupe të mëdha të nivelit të Manifestimit të Jetës. Megjithëse qëllimi i këtij libri të vogël nuk na mundëson të hyjmë në diskutime e sqarime të detajuara mbi çështjen e këtyre rrafshëve të ndryshme, prapëseprapë mendojmë se një përshkrim i përgjithshëm i çështjes do të ishte i dobishëm në këtë pikë.

Fillimisht le të shqyrtojmë pyetjen që u lind shpesh neofitëve, të cilët dëshirojnë të mësojnë kuptimin e fjalës “Rrafsh”, term ky i përdorur mjaft gjerësisht, por i sqaruar në mënyrë tepër të varfër në shumë vepra të kohëve të fundit me subjekt okultizmin. Pyetja është përgjithësisht e formës që vijon: “Është vallë Rrafshi një vend që karakterizohet nga dimensionet, apo bëhet fjalë thjeshtë për konditë ose gjendje?”. Përgjigjja jonë është: “Jo, nuk është një vend e as karakterizohet nga dimensionet e zakonshme të hapësirës; gjithsesi është më tepër se thjeshtë gjendje apo konditë. Mund të trajtohet si një gjendje apo konditë, por prapëseprapë gjendja dhe kondita mbeten “shkallë” dimensionale e rrjedhimisht janë të matshme.”. Paradoksale në një farë mënyre, apo jo? Le ta shqyrtojmë çështjen. Një “dimension”, siç e dini, është “një përmasë në vijë të drejtë e cila mundëson matje” etj. Dimensionet e zakonshme të hapësirës janë gjatësia, gjerësia e lartësia, ose ndoshta gjatësia, gjerësia, lartësia, trashësia dhe perimetri. Por ka edhe një dimension tjetër të “gjërave të krijuara”, apo një tjetër

“përmasë në vijë të drejtë” të njohur si nga okultistët ashtu edhe nga shkencëtarët, megjithëse këta të fundit ende nuk i adresohen me fjalën “dimension”; i shumëpërfolur si “Dimensioni i Katërt”, ky dimension është standardi që përdoret në përcaktimin e gradëve apo “rrafsheve”.

Ky Dimension i Katërt mund të quhet “Dimensioni i Lëkundjes”. Është fakt i mirënjohur si për shkencën bashkëkohore, ashtu edhe për Hermetistët të cilët e kanë trupëzuar të vërtetën në “Parimin e Tretë Hermetik”, se “çdo gjë lëviz, gjithçka lëkundet, asgjë nuk prehet”. Që nga forma më e lartë e manifestimit e deri te më i ulëta, gjithçka e çdo gjë Lëkundet. Jo vetëm lëkundet me frekuenca të ndryshme, por edhe me drejtime e në mënyra të ndryshme. Niveli i shpeshëtisë së lëkundjeve përbën edhe nivelin e matshëm në Shkallën e Lëkundjeve, me fjalë të tjera gradat e Dimensionit të Katërt. Janë këto gradë të cilat formojnë ato çka okultistët quajnë “Rrafshe”. Sa më e lartë frekuenca e lëkundjeve, aq më i lartë rrafshi, e aq më i lartë manifestimi i Jetës që zë atë rrafsh. Kështu, megjithëse rrafshi nuk është as “vend” e as “gjendje apo konditë”, prapëseprapë ai zotëron cilësi të përbashkëta si me njërin ashtu edhe me tjetrën. Do të kemi më shumë për të thënë në lidhje me çështjen e shkallës së Lëkundjeve në kapitullin vijues, në të cilin do të trajtojmë Parimin Hermetik të Lëkundjes.

Në çdo rast, ju kërkohet me mirësjellje të mbani mend se Tri Rrafshet e Mëdha nuk janë ndarje reale të dukurisë së Universit, por thjesht terma arbitrare të përdorur nga Hermetistët për konceptimin dhe studimin e gradëve të ndryshme dhe formave të aktivitetit e jetës universale. Atomi i materies, njësia e forcës, mendja e njeriut dhe ekzistenca e krye-engjëllit, nuk janë veçse gradë të njëjtës shkallë, rrënjësisht identike, ku ndryshimi konsiston vetëm në gradë dhe shpeshësi lëkundjesh; të gjitha janë krijime të GJITHËSISË dhe gëzojnë ekzistencën e tyre vetëm brenda Mendjes së Pafundme të GJITHËSISË.

Hermetistët e nëndajnë secilin nga Rrafshet e Mëdha në Shtatë Rrafshe Vartëse, e këto të fundit përsëri nëndahen në shtatë nënrrafshe,

çdonjëra nga këto ndarje pak a shumë arbitrare, e ndërthurur ngushtë me tjetrën dhe e përshtatur si e tillë thjesht për lehtësi studimi shkencor dhe konceptimi.

Rrafshi i Madh Fizik dhe Shtatë Rrafshet e tij Vartëse, përbëjnë atë klasë të dukurisë së Universit, e cila përfshin gjithçka ka të bëjë fizikën apo gjërat materiale, forcat dhe manifestimet. Përfshihen këtu të gjitha format e asaj çka quajmë Materie, si edhe të gjitha format e asaj çka quajmë Energji apo Forcë. Duhet të mos harroni se Filozofia Hermetike nuk e njeh Materien si një “gjë në vetvete”, e as pranon një ekzistencë specifike të saj qoftë edhe në Mendjen e GJITHËSISË. Doktrina thotë se Materia nuk është gjë tjetër veçse një formë Energjie, më saktë Energji me shpeshësi të ulët lëkundjesh të një lloji të caktuar. Në përputhje me këtë, Hermetistët e klasifikojnë Materien nën kreun e Energjisë, e i japin asaj tri nga Shtatë Rrafshet Vartëse të Rrafshit të Madh Fizik.

Shtate Rrafshet Vartëse janë si vijon:

- I. Rrafshi i Materies (A)
- II. Rrafshi i Materies (B)
- III. Rrafshi i Materies (C)
- IV. Rrafshi i Substancës Eterale
- V. Rrafshi i Energjisë (A)
- VI. Rrafshi i Energjisë (B)
- VII. Rrafshi i Energjisë (C)

Rrafshi i Materies (A) përfshin Materien në format e saj solide, të lëngët dhe të gaztë, siç njihet gjerësisht edhe nga tekstet e fizikës. Rrafshi i Materies (B) përfshin disa forma më të larta e më të sofistikuara të Materies, ekzistenca e të cilave është pranuar nga shkencat vetëm kohët e fundit, si dukuria e Materies Rrezatuese (radioaktive) në fazën e saj të radiumit etj., që i përkasin nëndarjes më të ulët të këtij Rrafshi Vartës. Rrafshi i Materies (C) përfshin format më të sofistikuara e më të rralla të Materies, ekzistenca e të cilave për shkencëtarët e zakonshëm është krejtësisht e panjohur. Rrafshi

i Substancës Eterale përfshin atë çka shkencën quan “Eteri”; një substancë tejet e imët dhe elastike, e cila mbush gjithë Hapësirën Universale dhe vepron si ndërmjetëse në përçimin e valëve të energjisë, si drita, ngrohtësia, elektriciteti etj. Kjo substancë Eterale përbën një hallkë lidhëse ndërmjet Materies (të ashtuquajtur) dhe Energjisë, e gëzon veçori të natyrës së secilës. Doktrina Hermetike pohon se ky rrafsh ka shtatë nënndarje (siç kanë të gjithë Rrafshet Vartëse), e se faktikisht ekzistojnë shtatë etere dhe jo një i vetëm. Menjëherë mbi Rrafshin e Substancës Eterale vjen Rrafshi i Energjisë (A), i cili përfshin format e zakonshme të Energjisë të njohura nga shkencën, me shtatë nënrrafshet e tij të cilat janë përkatësisht: Ngrohtësia, Drita, Magnetizmi, Elektriciteti dhe Tërheqja (ku përfshihet Graviteti, Kohëzioni, Afrimiteti Kimik etj.), si edhe disa forma të tjera të energjisë të dëshmuara nga eksperimentet shkencore, por ende të paemëtuara apo klasifikuara. Rrafshi i Energjisë (B) përfshin shtatë nënrrafshe të formave të energjisë ende të pazbuluara nga shkencën, të cilat janë quajtur “Forcat më Superiore të Natyrës” e të cilat hyjnë në vepër gjatë manifestimit të disa formave dukurish mendore, dukuri të mundësuar pikërisht nga këto forca. Rrafshi i Energjisë (C) përfshin shtatë nënrrafshe energjie të organizuar në mënyrë kaq të lartë, saqë mbart shumë nga karakteristikat e “jetës”, por që nuk njihet nga mendjet e njerëzve në rrafshin e zakonshëm të zhvillimit, duke qenë e përdorshme vetëm nga qenie të Rrafshit Shpirtëror; një energji e tillë është e pakonceptueshme për njeriun e zakonshëm dhe mund të konsiderohet pothuajse si “fuqi hyjnore”. Qeniet që e shfrytëzojnë këtë energji ngjajnë si “perënditë” nëse krahasohen qoftë edhe me njerëzit më të lartë që njohim ne.

Rrafshi i Madh Mendor përfshin ato lloj “gjërash të gjalla” që njohim në jetën e përditshme, si edhe disa forma të tjera të njohura nga pakkush, përjashtuar okultistët. Klasifikimi i Shtatë Rrafsheve Vartëse Mendore është pak a shumë i pranueshëm apo arbitrar (meqenëse nuk është i shoqëruar me sqarime të detajuara, të cilat qëndrojnë jashtë qëllimit të këtij botimi), por megjithatë do t’i përmendim. Këto nënrrafshe janë si vijon:

- I. Rrafshi i Mendjes Minerare
- II. Rrafshi i Mendjes Elementare (A)
- III. Rrafshi i Mendjes Bimore
- IV. Rrafshi i Mendjes Elementare (B)
- V. Rrafshi i Mendjes Shtazore
- VI. Rrafshi i Mendjes Elementare (C)
- VII. Rrafshi i Mendjes Njerëzore

Rrafshi i Mendjes Minerare përfshin “gjendjet apo konditat” e një-sive, entiteteve apo grupeve dhe kombinimeve të tyre, të cilat sjellin në dritë format e njohura nga ne me emrat “minerale, kimikate” etj. Këto entitete nuk duhen të ngatërrohen me molekulat, atomet apo grimcat, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse format ose trupat materiali të këtyre entiteteve, njësoj siç është trupi i njeriut thjeshtë formë materiale dhe jo “vetë njeriu”. Këto entitete mund të quhen edhe “shpirtra” në një farë mënyre, dhe janë qenie të gjalla të një gradë zhvillimi, jete dhe mendjeje të ulët, fare pak më të lartë se njësitë e “energjisë së gjallë” që përfshinin nënndarjet më të larta të Rrafshit Fizik më të lartë. Mendjet e rëndomta, në përgjithësi, botës Minerare nuk i atribuojnë zotërim të mendjes, të shpirtit apo të jetës, ndërkohë që të gjithë okultistët e pranojnë ekzistencën e tyre, e shkencë bashkëkohore po lëviz me shpejtësi drejt pikëpamjes Hermetike mbi këtë çështje. Molekulat, atomet e grimcat kanë “dashuritë dhe urëjtjet e tyre, pëlqimet e mospëlqimet, tërheqjet dhe shtytjet, lidhjet dhe ndarjet e tyre etj.”, e disa nga mendjet më të guximshme shkencore bashkëkohore, kanë shprehur pikëpamjen se dëshirat dhe vullnetet, emocionet dhe ndjenjat e atomeve ndryshojnë vetëm në gradë nga ato të njerëzve. Nuk kemi as kohë e as hapësirë për të rrahur çështjen gjerë e gjatë këtu. Të gjithë okultistët e pranojnë këtë si fakt dhe të tjerë akoma i referohen disa prej vërtetimeve që mbërrijnë nga kërkimet më të freskëta shkencore. Si zakonisht ka shtatë nënndarje për këtë rrafsh.

Rrafshi i Mendjes Elementare (A) përfshin gjendjen ose konditën, dhe gradën e zhvillimit mendor e jetësor të një klase entitetesh të panjohura për njerëzit e zakonshëm, por të pranuar nga okultistët.

Ato janë të paperceptueshme prej shqisave të zakonshme njerëzore, por megjithatë ekzistojnë dhe luajnë rolin e tyre në Dramën e Universit. Grada e tyre e inteligjencës qëndron diku midis asaj të entiteteve minerare e kimike dhe inteligjencës së entiteteve të botës bimore. Edhe ky rrafsh ka shtatë nënndarje.

Rrafshi i Mendjes Bimore, në shtatë nënndarjet e tij, përfshin gjendjet apo kushtet e entiteteve që përfshijnë mbretërinë e Botës Bimore, dukuritë jetësore e mendore të së cilës njihen mirë nga njerëzit me inteligjencë mesatare, falë edhe shumë studimeve shkencore të reja dhe interesante mbi “Inteligjencën dhe Jetën e Bimëve”, të botuara gjatë dekadës së fundit. Bimët zotërojnë jetë, mendje dhe “shpirt”, në të njëjtën mënyrë si kafshët, njeriu dhe mbinjeriu.

Rrafshi i Mendjes Elementare (B), në shtatë nënndarjet e tij përfshin gjendjet dhe kushtet e një forme më të lartë entitetesh “elementare” apo të padallueshme, të cilat luajnë rolin e tyre në çështjen e përgjithshme të Universit, mendja e jeta e të cilave formon një pjesë të shkallinës ndërmjet Rrafshit të Mendjes Bimore dhe Rrafshit të Mendjes Shtazore, ku këto entitete janë pjesë si e natyrës së njëjës ashtu edhe e natyrës së tjetrës.

Rrafshi i Mendjes Shtazore në shtatë nënndarjet e tij, përfshin gjendjet dhe kushtet e entiteteve, qenieve apo shpirtrave që i japin jetë formave jetësore shtazore të njohura nga të gjithë ne. Nuk ka nevojë të hyjmë në detaje të mëtejshme të kësaj bote apo rrafshi jete, pasi bota e kafshëve është po aq e njohur për ne sa edhe bota njerëzore.

Rrafshi i Mendjes Elementare (C), në shtatë nënndarjet e tij përfshin ato entitete apo qenie, të padukshme siç janë të gjitha format elementare, të cilat bëjnë pjesë si në natyrën e jetës shtazore, ashtu edhe në atë njerëzore, në masë e në kombinime të caktuara. Format më të larta janë gjysmë njerëzore në nivel inteligjence.

Rrafshi i Mendjes Njerëzore, në shtatë nënndarjet e tij, përfshin ato manifestime jete dhe mendësie të cilat janë të zakonshme për

Njeriun, në shkallët, gradët dhe klasifikimet e ndryshme të tij. Në lidhje me këtë, ne dëshirojmë të theksojmë faktin se njeriu i zakonshëm i sotëm, nuk zë veçse nënndarjen e katërt të Rrafshit të Mendjes Njerëzore dhe vetëm më inteligjentët kanë kapërcyer vijën ndarëse për në Nënndarjen e Pestë. Racës i janë dashur miliona vite për të arritur në këtë fazë, e do ti nevojiten edhe shumë vite të tjera për të kaluar në nënndarjen e gjashtë, të shtatë e përtej. Mos harroni se ka pasur raca përpara sonës, të cilat kanë kaluar nëpër këto gradë e më pas në rrafshet më të larta. Raca jonë është e pesta (së bashku me disa të prapambetur nga e katërta) e cila ka ndërmarrë Udhën. Ekziston një numër i vogël shpirttrash të përparuar të racës sonë, të cilët kanë lënë pas masat e kanë kaluar në nënndarjen e gjashtë dhe të shtatë, e disa prej tyre akoma më tutje. Njeriu i Nënndarjes së Gjashtë do të ishte “Supernjeriu”, ndërkohë që ai i Nënndarjes së Shtatë do të ishte “Mbinjeriu”.

Në trajtimin tonë të Shtatë Rrafsheve Vartëse Mendore, thjeshtë u jemi referuar Tri Rrafsheve Elementare në mënyrë të përgjithshme. Nuk dëshirojmë të shtyhem në detajet e këtyre çështjeve, pasi ato nuk i përkasin pjesës së mësimave e filozofisë së përgjithshme. Por për t’ju dhënë një ide paksa më të qartë të marrëdhënieve që kanë këto rrafshet me rrafshet e mirënjohura, mund të themi se: Rrafshet Elementare kanë po ato marrëdhënie me Rrafshet Minerare, Bimore, Shtazore, Mendore dhe Jetësore Njerëzore, që kanë edhe tastet e zeza të një pianoje me tastet e bardha. Tastet e bardha janë të mjaftueshme për të prodhuar muzikë, por ka disa shkallë, melodi e harmoni në të cilat tastet e zeza luajnë rolin e tyre, e ku prania e tyre është e nevojshme. Këto rrafshet janë gjithashtu të nevojshme në formën e “hallkave lidhëse” ndërmjet kushteve të shpirtit, gjendjeve të entitetit etj. midis shumë rrafsheve të tjera, duke rezultuar në disa forma të caktuara zhvillimi. Ky fakt i fundit, i jep lexuesit të aftë “të lexojë midis rreshtave” mundësinë për të hedhur dritë mbi procesin e Evolucionit dhe një çelës të ri për derën e fshehtë të “kërcimeve të jetës” nga njëra botë në tjetrën. Botët e Elementarëve pranohen gjerësisht nga të gjithë okultistët dhe shkrimet ezoterike i përmendin ato vazhdimisht. Lexuesit e “Xanonit” të shkruar nga Bulwer apo të

rrëfenjave të ngjashme, do ti njohin menjëherë entitetet që popullojnë këto rrafshje jete.

Çfarë mund të themi teksa kalojmë nga Rrafshi i Madh Mendor te Rrafshi i Madh Shpirtëror? Si mund t'i bëjmë të qarta këto gjendje të larta të Ekzistencës, Jetës dhe Mendjes, te mendjet të cilat janë momentalisht të paaftha të rrokin apo të kuptojnë qoftë edhe nëndarjet e larta të Rrafshit të Mendjes Njerëzore? Kjo sipërmarrje është e pamundur. E vetmja gjë që mund të bëjmë, është të flasim për këtë në mënyrën më të përgjithshme të mundshme. Si mund t'i përshkruhet Drita dikujt që ka lindur i verbër, sheqeri dikujt që nuk ka shijuar kurrë diçka të ëmbël, harmonia dikujt që ka lindur i shurdhër?

Gjithçka mund të themi është se Shtatë Rrafshet Vartëse të Rrafshit të Madh Shpirtëror (ku secili Rrafsh Vartës ka shtatë nëndarjet e tij), përfshijnë Qenie që zotërojnë Jetë, Mendje dhe Formë shumë përtej atyre të Njeriut të sotëm, njësoj siç ky i fundit qëndron më lart se krimbat e tokës, mineralet, apo edhe disa forma të caktuara të Energjisë dhe Materies. Jeta e këtyre Qenieve e tejkalon tonën në atë masë, sa as nuk mund të hamendësojmë mbi detajet e saj; Mendja e tyre e tejkalon tonën në përmasa të tilla, sa në sytë e tyre ne vështirë se dukemi sikur “mendojmë” dhe proceset tona mendore ngjajnë pothuajse si procese materiale; Materia prej të cilës ndërtohen format e tyre është e Rrafshëve më të larta Materiale, madje thuhet se disa prej tyre janë “të veshur në Energji të Pastër”. Çfarë mund të thuhet për Qenie të tilla?

Në Shtatë Rrafshet Vartëse të Rrafshit të Madh Shpirtëror ekzistojnë Qenie të cilat mund të përqasen me Engjëjt, Krye Engjëjt dhe Gjysmë Perënditë. Në Rrafshet e ulëta Vartëse rrojnë ata shpirtra të mëdhenj të cilët ne i quajmë Njohës e Mjeshtra. Mbi ta vijnë Hierarkitë e Larta të Posteve Engjëllore të cilat janë të pamendueshme për njeriun, e mbi këto të fundit vijnë ata të cilët janë Qenie kaq të larta në shkallë, sa pa dashur të shfaqim mungesë nderimi të asnjë lloji, mund t'i quajmë “Perënditë”, ekzistenca, inteligjenca dhe fuqitë e të cilëve janë të ngjashme me virtytet që racat njerëzore i atribuojnë

përftyryrimeve të tyre mbi Hyjin. Këto qenie qëndrojnë më përtej se fluturimet me të larta të imagjinatës njerëzore dhe e vetmja fjalë e cila u shkon për shtat është “Hyjnore”. Shumë nga këto Qenie si edhe mjaft Engjëj, janë thellësisht të interesuar në çështjet e Universit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në problemet e tij. Këto Hyjni të Padukshme e Engjëj Ndhës e shtrijnë ndikimin e tyre lirisht e fuqimisht në procesin e Evolucionit dhe Përparimit Kozmik. Ndërrhyrjet e tyre të rastësishme dhe ndihmesat në problemet njerëzore i kanë çelur udhë mjaft legjendave, dogmave, besimeve dhe traditave të racës sonë, si në të tashmen ashtu edhe në të shkuarën. Ata i kanë mbivendosur botës herë pas here diturinë e fuqinë e tyre, natyrisht, gjithmonë duke iu nënshtruar Ligjit të GJITHËSISË.

E megjithatë, edhe më të lartat e këtyre Qenieve të përparuara, ekzistojnë thjesht si krijesa të Mendjes dhe në Mendjen e GJITHËSISË, si edhe u nënshtrohen Proceseve Kozmike e Ligjeve Universale. Gjithsesi të Vdekshme. Ne mund t’i quajmë “perëndi” nëse dëshirojmë, por këto qenie nuk janë gjë tjetër veçse Vëllezërit e Moçëm të Racës; shpirta të përparuar të cilët kanë lënë pas vëllezërit e tyre e kanë paraprirë në ngazëllimin e Përthithjes prej GJITHËSISË, për të ndihmuar racën në rrugëtimin e saj përgjatë Udhës së përpjetë. Sidoqoftë ata i përkasin Universit e i nënshtrohen kushteve të tij, janë të vdekshëm dhe rrafshi i tyre qëndron nën rrafshin e Shpirtit Absolut.

Vetëm Hermetistët më të përparuar janë të aftë të rrokin Mësimet e Fshehta mbi formën e ekzistencës dhe forcat e manifestuara në Rrafshet Shpirtërore. Dukuria qëndron shumë më lart se ajo e Rrafsheve Mendore, e rrjedhimisht përpjekja për ta përshkruar do të rezultonte doemos në një pështjellim idesh. Vetëm ata, mendja e të cilëve është ushtruar përgjatë trajtave të Filozofisë Hermetike për vite me radhë, ata të cilët e kanë mbartur me vete diturinë e fituar nga mishërime të mëparshme, mund të kuptojnë domethënien e Mësimet që i përket Rrafsheve Shpirtërore. Shumë nga këto Mësime ruhen nga Hermetistët si tepër të shenjta, të rëndësishme e madje edhe të rrezikshme për t’i bërë publike. Nxënësi i zgjuar është i aftë të dallojë çfarë nënkuptojmë me sa mësipër, kur deklarojmë se domethënia e “Shpirtit” siç

përdoret nga Hermetistët, njësohet me “Forcën Jetësore”, “Forcën e Jetëdhënëse”, “Esencën e Brendshme”, “Esencën e Jetës” etj., e kuptimi i kësaj fjale nuk duhet ngatërruar me atë që përdoret rëndom për të shoqëruar terminologji si “feja, kleri, spiritualizmi, shenjtëria” etj. etj. Për okultistin fjala “Shpirt” do të thotë “Parim Jetëdhënës”, i cili mbart me vete idenë e Fuqisë, Energjisë Jetësore, Forcës Mistike etj. Okultistët dinë gjithashtu se ajo çka ata njohin si “Fuqi Shpirtërore” mund të përdoret për qëllime të mira apo të liga (në përputhje me Parimin e Polaritetit), një fakt ky i pranuar nga mbarë besimet fetare në trajtat e Satanait, Djallit, Belzebubit, Shejtanit, Luciferit, Engjëjve të Rrëzuar etj. E kështu, njohuria mbi këto Rrafshe është ruajtur nga të gjitha Vëllazëritë Ezoterike dhe Urdhrat Okultë në të Shenjtën e të Shenjtave, në Dhomën e Fshehtë të Tempullit. Duhet thënë këtu se ata të cilët kanë fituar fuqi të mëdha shpirtërore dhe i kanë keqpërdorur ato, i pret një fat i tmerrshëm. Luhatja e lavjerrësit të Ritmit do t’i flakë pashmangshmërisht pas në skajin më të largët të ekzistencës Materiale, pikë nga e cila do t’u duhet të ndjekin sërish gjurmët e tyre përpjetë në drejtim të Shpirtit, përgjatë cikleve të lodhshme të Udhës, gjithmonë duke mbajtur mbi supë peshën torturuese të një kujtimi të pashlyeshëm të lartësive nga të cilat janë rrëzuar si pasojë e veprimeve të liga. Siç e dinë të gjithë okultistët e përparuar, legjendat e Engjëjve të Rrëzuar janë të bazuara në fakte të vërteta. Përpjekjet egoiste për pushtet në Rrafshet Shpirtërore përfundojnë pashmangshmërisht me humbjen e ekuilibrit shpirtëror dhe rrëzimin e shpirtit egoist po aq poshtë sa edhe lart qëndronte. Megjithatë, edhe një shpirti të tillë i dhurohet mundësia për t’u rikthyer, e kështu ky shpirt rinis rrugëtimin duke shlyer ndëshkimin e tmerrshëm në përputhje me Ligjin e patjetërsueshëm.

Në përfundim, dëshirojmë t’ju rikujtojmë se në përputhje me Parimin e Përkimit i cili trupëzon vërtetësinë e shprehur në formën: “Si Lart ashtu edhe Poshtë; si Poshtë ashtu edhe Lart”, të Shtatë Parimet Hermetike janë gjithmonë në fuqi në të gjitha rrafshet, qofshin Fizike, Mendore apo Shpirtërore. Parimi i Substancës Mendore i aplikohet natyrisht të gjitha rrafsheve, pasi gjithçka ndodhet në Mendjen e GJITHËSISË. Parimi i Përkimit shfaqet gjithkund meqenëse

ekziston një përkim, harmoni dhe ujdi midis rrafshëve të ndryshme. Parimi i Lëkundjes shfaqet në çdo Rrafsh, e ashtu siç e sqaruam vetë dallimi midis “rrafshëve” lind nga Lëkundja. Parimi i Polaritetit shfaqet gjithashtu në çdo Rrafsh, ku skajet e Poleve janë në dukje të kundërt e kontradiktorë. Parimi i Ritmit shfaqet në çdo Rrafsh dhe lëvizja e dukurisë ka baticat e zbaticat e saj, ngritjet e uljet, hyrjet e daljet. Parimi i Shkakut dhe Pasojës shfaqet në çdo Rrafsh, ku çdo Pasojë ka Shkakun e saj, e çdo Shkak pasojën. Parimi i Gjinisë shfaqet në çdo Rrafsh ku manifestohet Energjia Krijuese, e vepron përgjatë trajtave të Aspekteve të tij Mashkullore e Femërore.

“Si Lart ashtu edhe Poshtë; si Poshtë ashtu edhe Lart”. Kjo aksiomë shekullore Hermetike mishëron një nga Parimet më të mëdha të Dukurisë së Universit. Teksa vijojmë në trajtimin e Parimeve që kanë mbetur, do të shqyrtojmë akoma më në thellësi vërtetësinë me natyrë universale të Parimit të madh të Përkimit.

Kapitulli IX

LËKUNDJA

“Asgjë nuk prehet; çdo gjë lëviz; gjithçka lëkundet.” – Kybalioni

Parimi i Tretë i Madh Hermetik, Parimi i Lëkundjes, trupëzon vërtetësinë që pohon se Lëvizja shfaqet në gjithçka përmban Universi, që asgjë nuk qëndron në prehje, që gjithçka lëviz, lëkundet e rrotullohet. Ky parim Hermetik është pranuar prej disa filozofëve të hershëm të Greqisë, të cilët edhe e përshinë atë në sistemet e tyre. Më pas, për shekuj të tërë ai u la në harresë nga mendimtarët jashtë qarqeve Hermetike. Në Shekullin e Nëntëmbëdhjetë, shkenca e fizikës rizbuloi të vërtetën dhe në Shekullin e Njëzetë zbulimet shkencore sollën prova të mëtejshme mbi saktësinë dhe vërtetësinë e kësaj doktrine shekullore Hermetike.

Mësimet Hermetike, na mësojnë jo vetëm se gjithçka është në lëvizje dhe lëkundet në mënyrë të vazhdueshme, por edhe se “dallimet” ndërmjet manifestimeve të ndryshme të forcës universale, rrjedhin tërësisht nga ndryshimet në shpeshësinë dhe në mënyrën e lëkundjeve. Jo vetëm kaq, por edhe vetë GJITHËSIA shfaq një lëkundje të vazhdueshme të një grade aq të pafundme intensiteti e lëvizjeje të shpejtë, sa praktikisht mund të konsiderohet si në prehje. Për ilustrim, mësuesit e drejtojnë vëmendjen e nxënësve të tyre në faktin që edhe në rrafshin fizik, një objekt që lëviz me shpejtësi (si për shembull një rrotë që vërtitet) duket sikur qëndron në prehje. Mësimet mbrojnë idenë se Shpirti qëndron në njërin skaj të Poleve të Lëkundjes, ndërkohë që në polin tjetër qëndrojnë disa forma shumë të thjeshta të Materies. Midis këtyre dy poleve qëndrojnë miliona e miliona nivele të ndryshme frekuence e mënyre lëkundjeje.

Shkenca bashkëkohore ka vërtetuar se ato që ne quajmë Materie dhe Energji, nuk janë gjë tjetër veçse “forma të lëvizjeve në trajtë lëkundjesh”, e disa nga shkencëtarët më të përparuar po i qasen me shpejtësi qëndrimit të okultistëve, të cilët pohojnë se në mënyrë të ngjashme, edhe dukuritë Mendore janë thjeshtë mënyra lëkundjeje apo lëvizjeje. Të shohim se çfarë thotë shkenca mbi çështjen e lëkundjeve në materie dhe energji.

Fillimisht, shkenca na mëson se e gjithë materia manifestohet në një farë grade të caktuar, e lëkundjet janë pasojë e temperaturës apo ngrohtësisë. Qoftë një objekt i ngrohtë apo i ftohtë, të dyja këto gjendje nuk janë gjë tjetër veçse gradë të të njëjtës gjë, e objekti shfaq lëkundje të caktuara në varësi të temperaturës, duke qenë në këtë kuptim në lëvizje dhe lëkundje të vazhdueshme. Kështu, të gjitha thërrmijat përbërëse të Materies janë në lëvizje të vazhdueshme rrotulluese, që nga grimcat elementare e deri te diejt. Planetët rrotullohen përreth diejve e shumë prej tyre rreth boshtit vetjak. Diejt rrotullohen rreth pikash qendrore akoma më të mëdha (qendrat e galaktikave), këto të fundit mendohet se rrotullohen rreth qendrash të tjera e kështu me radhë ad infinitum. Molekulat prej të cilave përbëhen llojet e caktuara të Materies, janë në gjendje lëkundjeje konstante e

lëvizjeje të vazhdueshme, përreth e përkundrejt njëra-tjetrës. Molekulat përbëhen nga Atome, të cilët në mënyrë të ngjashme ndodhen në një gjendje të përhershme lëvizjeje e lëkundjeje. Atomet përbëhen nga grimca të tjera, të njohura si “jone”, “elektrone” etj., të cilat gjithashtu lëvizin e rrotullohen rreth njëra-tjetrës, duke shfaqur një formë dhe gjendje shumë të shpejtë të lëkundjes. Kështu, vëmë re se të gjitha format e Materies shfaqin Lëkundje në përputhje me Parimin Hermetik të Lëkundjes.

E njëjta gjë vlen edhe për format e ndryshme të Energjisë. Shkenca na mëson se Drita, Ngrohtësia, Magnetizmi dhe Elektriciteti nuk janë veçse forma të lëvizjes lëkundëse, të cilat në njëfarë mënyre kanë lidhje dhe burojnë nga Eteri. Shkenca deri më sot nuk është përpjekur të shpjegojë natyrën e dukurisë së njohur me emrin Kohezion (tërheqja reciproke), çka është parimi i Tërheqjes Molekulare, e as natyrën e Afrimitetit Kimik i cili është parimi i Tërheqjes Atomike, e aq më pak natyrën e Gravitetit (misteri më i madh nga të tre), i cili është parimi i tërheqjes sipas së cilit çdo grimcë e Materies që zotëron masë ndërvepron me çdo grimcë apo masë tjetër. Këto tri forma të Energjisë ende janë të pakuptueshme për shkencën, e megjithatë ne priremi drejt mendimit se edhe këto janë manifestime të një forme të caktuar të energjisë lëkundëse, fakt ky të cilin Hermetistët e kanë njohur dhe përçuar gjatë shekujve të shkuar.

Eteri Universal, një postulat ky i shkencës me natyrë ende të paqartë, njihet nga Hermetistët me emrin “Substanca Eterale”, thjeshtë si një manifestim më i lartë i asaj çka emërtohet gabimisht Materie, e që nënkupton Materie në një gradë më të lartë lëkundjeje. Hermetistët na mësojnë se kjo Substancë Eterale është tejet e imët dhe elastike dhe mbush tërë hapësirën universale duke shërbyer si përçuese e valëve të energjisë lëkundëse si ngrohtësia, drita, elektriciteti, magnetizmi etj. Mësimet sqarojnë se Substanca Eterale është një hallkë lidhëse midis formave lëkundëse të energjisë të njohura si “Materie” në njërin anë, dhe “Energjisë” apo “Forcës” në anën tjetër, e cila gjithashtu shfaq një gradë lëkundjeje me formë e shpeshtësi të spikatur.

Shkencëtarët kanë shfrytëzuar shembullin e një rrote, fuge apo cilindri që lëviz me shpejtësi për të ilustruar efektet e rritjes së frekuencës së lëkundjeve. Në ilustrim, rrota, fuga apo cilindri, sende të cilat për lehtësi do t'i quajmë "objekti" këtej e tutje, rrotullohen rreth boshtit përkatës. Le të supozojmë se objekti rrotullohet ngadalë. Mund të dallohet lehtësisht lëvizja, por ende nuk mund të dëgjohet asnjë tingull i prodhuar nga ai. Shpejtësia rritet gradualisht. Pas pak çastesh, lëvizja bëhet aq e shpejtë sa nis të dëgjohet një gumëzhimë ose notë e ulët muzikore. Me rritjen e shpejtësisë edhe tingulli ngrihet një notë në shkallën muzikore. Duke e rritur shpejtësinë akoma më tej, dallohet nota vijuese e lartë. Kështu, njëra pas tjetrës do të shfaqen të gjitha notat e shkallës muzikore, gjithmonë e më të larta teksa shpejtësia rritet. Në fund, kur rrotullimi ka arritur një shpejtësi të caktuar, dëgjohet edhe nota finale e perceptueshme nga veshi njerëzor, e më tutje vikatja e piskama shuhen dhe vendin e tyre e zë qetësia. Nga objekti që rreth rrotullohet nuk dëgjohet më asnjë tingull, pasi shpejtësia e lëvizjes është aq e madhe sa veshi njerëzor nuk është më i aftë të regjistrojë dridhjet. Më tutje vijon perceptimi i gradëve në rritje të Nxehhtësisë. Pas njëfarë kohe syri nis të kapë nga objekti një ngjyrë të kuqërremtë të errët e të turbullt. Teksa shpejtësia rritet, e kuqja sa vjen e bëhet me e ndezur. Me rritjen e mëtejshme të shpejtësisë e kuqja shkrihet në portokalli. Më pas portokallia shndërrohet në të verdhë. Më tutje, me rritjen e mëtejshme të shpejtësisë, vijnë njëra pas tjetrës nuancat e të gjelbrës, blusë, manushaqes dhe në fund të ngjyrës vjollcë. Më pas edhe vjollca tretet e çdo ngjyrë zhduket meqenëse syri i njeriut nuk është më i aftë t'i dallojë. Por mbeten rreze të tjera të padukshme që burojnë nga objekti që vërtitet, si rrezet që përdoren në procese fotografike apo forma të tjera drite. Më tej, ndërsa përbërja e objektit nis të ndryshojë, fillojnë të shfaqen rreze karakteristike të njohura si "Rrezet X" etj. Kur arrihet shpejtësia e duhur e lëkundjeve çlirohet edhe Elektricitet e Magnetizëm.

Në kohën që objekti fiton një shpeshtësi të caktuar të lëkundjes, molekulat e tij shpërbëhen dhe zbërthehen në elementë origjinalë apo atome. Më pas, atomet, duke ndjekur Parimin e Lëkundjes, ndahen në grimcat e panumërta prej të cilave përbëhen. E në fund, edhe

këto grimca zhduken dhe mund të thuhet se objekti është i përbërë nga Substanca Eterale. Shkenca nuk guxon ta ndjekë më tej ilustrimin, por Hermetistët pohojnë se nëse lëkundjet do të rriten në vazhdimësi, objekti do të ngjisë shkallët e radhës së manifestimeve duke shfaqur fazat e ndryshme mendore, më pas duke lëvizur lart në drejtim të Shpirtit, derisa në fund do të rikthehej tek GJITHËSIA që është Shpirt Absolut. Në çdo rast, “objekti” do të kishte ndalur së qeni “objekt” shumë kohë përpara se të hynte në fazën e Substancës Eterale, por përjashtuar kjo pjesë, ilustrimi mbetet korrekt duke qenë se përshkruan saktë pasojat e rritjes konstante të shpeshësisë dhe formës së lëkundjes. Në shembullin e mësipërm, duhet të mbani parasysh se gjatë fazave në të cilat “objekti” çliron lëkundje drite, ngrohtësie etj., ai në realitet nuk zbërthehet në këto forma energjie (të cilat qëndrojnë shumë më lart në shkallë), por thjeshtë arrin atë gradë lëkundjesh në të cilën këto forma energjie çlirohen nga ndikimi kufizues përkatës i molekulave, atomeve apo grimcave të tij. Këto forma energjie, megjithëse shumë më të larta në shkallë se Materia, janë të burgosura e të kufizuara në kombinimet materiale për shkak të vetë manifestimeve të tyre përmes formave materiale, duke mbetur në këtë mënyrë të ngatërruara, të pleksura e të rrethuara në vetë krijimet e tyre me formë materiale, ngjarje kjo e cila deri në një farë mase vlen për të gjitha krijimet, përderisa forca krijuese përfshihet e bëhet pjesë në krijim e saj.

Mësimet Hermetike shkojnë më tej se ato të shkencës bashkëkohore. Ato pohojnë se të gjitha shfaqjet e mendimit, emocionit, arsyes, vullnetit, dëshirës dhe të çdo gjendjeje apo kondite mendore, shoqërohen me lëkundje, një pjesë e të cilave përhapet dhe priret të ndikojë mendjet e personave të tjerë nëpërmjet “induksionit”. Ky është parimi që qëndron pas dukurisë së “telepatisë”, ndikimit mendor dhe formave të tjera të veprimit apo të fuqisë së mendjes mbi mendjen, gjëra këto me të cilat publiku po njihet me shpejtësi, falë edhe përhapjes së gjerë të diturisë okulte nga shkolla, kulte dhe mësues të ndryshëm në këto lëme.

Çdo mendim, emocion e gjendje mendore ka formën dhe shpejtësinë

përkatëse të lëkundjeve. Nëpërmjet një përpjekjeje të vullnetshme të personit apo të personave të tjerë, këto gjendje mendore mund të riprodhohen në të njëjtën mënyrë në të cilën mund të riprodhohet një tingull muzikor, duke e bërë instrumentin të dridhet në një frekuencë të caktuar, apo në të njëjtën mënyrë në të cilën riprodhohen ngjyrat. Nëpërmjet zotërimit të Parimit të Lëkundjes dhe zbatimit të tij mbi Dukuritë Mendore, cilido mund ta polarizojë mendjen e tij në gradën që dëshiron, dukë fituar kështu kontroll të përsosur mbi gjendjet e tij mendore, emocionale etj. Në të njëjtën mënyrë ai mund të ndikojë edhe mendjet e të tjerëve duke imponuar gjendjet e dëshiruara mendore mbi ta. Në fjalë të tjera, ai mund të jetë i aftë të shkaktojë në Rrafshin Mendor, atë çka shkenca shkakton në Rrafshin Material, që do të thotë “Lëkundje sipas Dëshirës”. Kjo fuqi, natyrisht mund të fitohet vetëm nëpërmjet udhëzimeve të përshtatshme, ushtrimit, praktikës etj., duke qenë se ka të bëjë me degën e Artit Hermetik të quajtur Shndërrimi Mendor.

Një reflektim i shkurtër mbi sa thamë, do ti dëshmojë nxënësit se është pikërisht Parimi i Lëkundjes ai që qëndron nën dukuritë e mrekullueshme të fuqive që zotërojnë Mjeshtrit dhe Njohësit, të cilët në pamje të parë duket sikur janë të aftë të mënjanojnë Ligjet e Natyrës, por që në të vërtetë, thjesht shfrytëzojnë një ligj kundër një tjetri, një parim kundër një tjetri, duke përfutur kështu rezultate përmes ndryshimit të lëkundjeve të objekteve materiale, e duke përmbushur ato çka njihen gjerësisht me emrin “mrekulli”.

Ashtu siç ka thënë me të drejtë një nga shkruesit e vjetër Hermetikë: “Ai i cili kupton drejtë Parimin e Lëkundjes, ka shtënë në dorë skeptrin e Pushtetit”.

Kapitulli X

POLARITETI

“Gjithçka është e dyzuar; gjithçka ka pole; gjithçka ka çiftin e saj të kundërtave; ngjashmëria dhe dallimi janë e njëjta gjë; të kundërtat janë identike në natyrën e tyre, por të ndryshme në gradë; skajet takohen; të gjitha të vërtetat nuk janë veçse gjysmë të vërteta; të gjithë paradokset mund të pajtohen.” – Kybalioni

Parimi i katërt i madh Hermetik, Parimi i Polaritetit, trupëzon vërtetësinë që pohon se çdo gjë e manifestuar ka “dy anë”, “dy aspekte”, “dy pole”, “një çift të kundërtash” ku midis dy skajeve qëndrojnë gradë të shumëfishta. Duke e kuptuar në thelb këtë Parim, mund të zgjidhen paradokse të vjetra, të cilat kanë turbulluar ngaherë mendjet njerëzore. Njeriu në vetvete e ka pranuar gjithmonë një koncept të ngjashëm me këtë Parim, të cilin është orvatur ta

formulojë me thënie, fjalë të urta dhe aforizma të tipit: “të gjitha të vërtetat nuk janë veçse gjysmë të vërteta”, “çdo pohim është gjysmë i gënjeshtërt”, “gjithçka ka dy anë”, “ka dy faqe të çdo medaljeje” etj.

Doktrina Hermetike na sqaron se dallimet midis gjërave të cilat në pamje të parë duken diametralisht të kundërta, qëndrojnë thjeshtë në gradë. Doktrina na tregon se “çiftet e të kundërtave mund të bashkohen”, se “teza dhe antiteza kanë natyrë identike, por ndryshojnë në gradë”, dhe se nëpërmjet njohjes së Parimit të Polaritetit mund të kryhet “pajtimi universal i të kundërtave”. Mësuesit pohojnë se shembuj ilustrues për këtë Parim mund të gjenden lirisht gjithkund, si edhe mund të përftohen përmes këqyrjes së natyrës së vërtetë të gjërave. Ata fillimisht na tregojnë se Shpirti dhe Materia nuk janë gjë tjetër veçse pole të të njëjtës gjë, e rrafshet ndërmjetëse janë thjeshtë gradë lëkundjeje. Ata na tregojnë se GJITHËSIA dhe Të Tjerat janë e njëjta gjë dhe se dallimi është thjeshtë çështje gradësh në Manifestimin Mendor. Në të njëjtën mënyrë, LIGJI dhe Ligjet janë dy pole të kundërta të të njëjtës gjë. Po kështu edhe PARIMI dhe Parimet. Mendja e Pafundme e mendjet e fundme.

Duke u hedhur më pas në Rrafshin Fizik, mësuesit e ilustronjë Parimin duke dëshmuar se Nxehtësia dhe Ftohtësia janë identike në natyrë dhe se dallimi midis tyre është thjeshtë çështje gradësh. Termometri tregon shumë gradë të temperaturës ku skaji më i ulët përbën “ftohtësinë” dhe ai më i lartë “nxehtësinë”. Midis këtyre dy skajeve, gjenden shumë gradë të “së ngrohtës” apo të “së ftohtës”, të cilat sido që t’i etiketojmë, mbetemi gjithsesi korrektë. Kur shqyrtojmë dy gradë, grada që qëndron sipër është gjithmonë “më ngrohtë” dhe ajo që qëndron poshtë është gjithmonë “më ftohtë”. Standardi absolut nuk ekziston; gjithçka është çështje gradësh. Nuk ekziston një vend i caktuar në termometër ku ngrohtësia përfundon e ku nis ftohtësia. Gjithçka është një çështje lëkundjesh më të larta apo më të ulëta. Edhe vetë fjalët “i lartë” apo “i ulët” të cilat jemi të shtrënguar t’i përdorim, nuk janë veçse pole të së njëjtës gjë; terminologji relative. I njëjti arsyetim vlen për “Lindjen e Perëndimit”; nëse udhëtoni për qark botës në drejtim të lindjes, do të mbërrini në një pikë e cila

quhet perëndim në vendin prej ku u nisët. Udhëtoni vazhdimisht në drejtim të Veriut, e do ta gjeni veten duke udhëtuar drejt Jugut, ose anasjelltas.

Drita dhe Errësira janë pole të të njëjtës gjë të ndara nga gradë të shumta që qëndrojnë mes tyre. E njëjta gjë edhe me shkallën muzikore, ku duke u nisur nga “C” udhëtoni lart derisa mbërrini te një tjetër “C” e kështu me radhë, me dallime të njëjta e me gradë të shumta midis dy skajeve. Njësoj edhe për shkallën e ngjyrave, ku lëkundjet e larta apo të ulëta janë i vetmi dallim midis ngjyrës vjollcë dhe asaj të kuqe. I Madh apo i Vogël janë koncepte relative. Po kështu janë edhe Zhurma e Qetësia dhe të njëjtit rregull i nënshtrohen edhe Fortësia e Butësia. Njësoj edhe për Mprehtësinë dhe Topitjen. Pozitivja dhe Negativja janë dy pole të të njëjtës gjë, të ndara nga gradë të panumërta të ndërmjetme.

E Mira dhe e Keqja nuk janë absolute; ne e quajmë njërin skaj të shkallës e Mira dhe skajin tjetër e Keqja, apo njërin skaj Mirësia e tjetrin Ligësia, në përputhje me formën e përdorimit. Diçka është “më pak e mirë” se diçka tjetër që qëndron më lart në shkallë, por me radhë, kjo gjë “më pak e mirë” është “më e mirë” se gjëja tjetër pasuese që ndodhet poshtë saj, e kështu në vazhdimësi, në varësi të pozicionit përkatës në shkallë.

Po kështu ndodh edhe në Rrafshin Mendor. “Dashuria e Urrejtja” në përgjithësi shihen si gjëra diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën, krejtësisht të ndryshme e të papajtueshme. Por kur zbatojmë Parimin e Polaritetit, zbulojmë se nuk ekzistojnë gjëra si Dashuria Absolute apo urrejtja Absolute në formë të ndarë nga njëra-tjetra. Që të dyja janë thjeshtë fjalë për të përshkruar dy pole të të njëjtës gjë. Duke u nisur nga një pikë çfarëdo e shkallës matëse, teksa ngjitemi do të gjejmë “më shumë dashuri” apo “më pak urrejtje”, e teksa zbresim “më shumë urrejtje” apo “më pak dashuri”, pavarësisht nga pozicioni i lartë apo i ulët i pikënisjes fillestare. Ekzistojnë gradë të Dashurisë e urrejtjes dhe ekziston një pikë e ndërmjetme në të cilën “Pëlqimi apo Mospëlqimi” zbehet aq shumë, sa bëhet e vështirë për t’u

dalluar. Trimëria dhe Frika i nënshtrohen të njëjtit rregull. Çiftet e të Kundërtave shfaqen gjithkund. Aty ku gjeni njëren gjë, do të gjeni edhe të kundërtën e saj, polin tjetër.

Është pikërisht ky fakt ai që i mundëson Hermetistëve të shndërojnë një gjendje të caktuar mendore në një tjetër përgjatë trajtave të Polarizimit. Nuk mund të shndërrohen gjëra të cilat u përkasin klasave të ndryshme, por është plotësisht e mundur të shndërrohen gjëra të cilat i përkasin të njëjtës klasë duke ndryshuar polaritetin e tyre. Kështu Dashuria nuk mund të kthehet kurrë në Lindje apo në Perëndim, në të Kuqe apo në Vjollcë, por mund dhe shpesh kthehet në Urrejtje, e anasjelltas edhe Urrejtja mund të transformohet në Dashuri nëpërmjet ndryshimit të Polaritetit. Trimëria mund të kthehet në frikë e anasjelltas. Gjërat e Forta mund të Zbuten. Gjërat e Topitura mund të kthehen në të Mprehta. Gjërat e Nxehta mund të Ftohen e kështu me radhë. Shndërrimi mund të kryhet gjithmonë vetëm brenda gjërave të të njëjtës bashkësi, por me gradë të ndryshme. Të marrim rastin e një njeriu Frikacak. Duke i rritur lëkundjet e tij mendore përgjatë linjës Frikë-Trimëri, ai mund të mbushet me Trimërinë e Kurajën më të lartë të mundshme. Në të njëjtën mënyrë, thjesht duke u polarizuar përgjatë linjave të cilësisë së dëshiruar, njeriu i Plogët mund ta shndërrojë veten në një individ Aktiv dhe Energjik.

Nxënësi që është njohur me proceset nëpërmjet të cilave shkolla të ndryshme të Shkencës Mendore etj. shkaktajnë ndryshime në gjendjet mendore të pasuesve të tyre, mund të mos e kuptojë menjëherë parimin që qëndron pas këtyre ndryshimeve. Sidoqoftë, kur Parimi i Polariteti rroket plotësisht dhe vihet re se ndryshimet mendore shoqërohen me një ndryshim polariteti, një lëvizje përgjatë së njëjtës shkallë, çështja bëhet menjëherë më e kuptueshme. Natyra e transformimit nuk është shndërrimi i diçkaje në një diçka tjetër krejtësisht të ndryshme, por thjeshtë ndryshimi i gradëve të të njëjtës gjë, një dallim ky tejet i rëndësishëm. Si shembull mund të huazojmë një analogji nga Rrafshi Material: është e pamundur të shndërrohet Nxehtësia në Mprehtësi, Zhurmë, Lartësi etj., por ajo mund të

shndërrohet lehtësisht në Ftohtësi thjesht duke ulur lëkundjet. Në mënyrë të ngjashme, Dashuria e Urrejtja, Frika e Trimëria mund të shndërrohen në mënyrë të ndërsjellët. Por Frika nuk të transformohet në Dashuri, e as Trimëria nuk mund të bëhet Urrejtje. Gjendjet mendore kategorizohen në klasa të panumërta, ku secila klasë ka polet e saj të kundërta, përgjatë të cilave është i mundur edhe shndërimi.

Nxënësi është i aftë të dallojë menjëherë se si në gjendjet mendore, ashtu edhe në dukuritë e Rrafshit Fizik, dy polet mund të kategorizohen respektivisht si Pozitivi dhe Negativi. Kështu Dashuria është Pozitive ndaj Urrejtjes, Trimëria ndaj Frikës, Aktiviteti ndaj Plogështisë etj. Është po kështu e dallueshme qoftë edhe nga ata të cilët nuk e njohin Parimin e Lëkundjes, se poli Pozitiv është në pamje të parë më i lartë në gradë se poli Negativ dhe është dominues i këtij të fundit. Prirja e Natyrës anon në drejtim të veprimtarisë së polit Pozitiv.

Përveç shkëmbimit të poleve të gjendjeve mendore të një personi nëpërmjet ushtrimit të artit të Polarizimit, dukuria e Ndikimit Mendor në fazat e saj të shumëfishta, na tregon se parimi mund të zgjerohet në mënyrë që të përqafojë edhe dukurinë e ndikimit të një mendjeje mbi një tjetër, gjë për të cilën është shkruar e folur shumë gjatë viteve të fundit. Kur të kuptohet se Induksioni Mendor është i mundshëm dhe se gjendjet mendore mund ndryshohen prej të tjerëve nëpërmjet “induksionit”, atëherë mund të vërehet qartazi se në ç’mënyrë një frekuencë e caktuar lëkundjeje, apo polarizimi i një gjendjeje të caktuar mendore, mund t’i transmetohet një personi tjetër, duke i ndryshuar në këtë mënyrë polaritetin në atë klasë gjendjesh mendore. Nëpërmjet këtij parimi përftohen edhe rezultatet e “trajtimeve të shumta mendore”. Si shembull mund të marrim dikë që ndihet i trishtuar, melankolik dhe i mbushur me frikë. Një shkencëtar i mendjes, e ngre mendjen e tij në nivelin e dëshiruar të lëkundjeve përmes vullnetit të tij të ushtruar, duke arritur kështu polarizimin vetjak të dëshiruar, e më pas riprodhon një gjendje të ngjashme mendore te personi tjetër përmes induksionit. Rezultati

është rritja e lëkundjeve të personi tjetër dhe polarizimi i këtij të fundit drejt skajit Pozitiv të shkallës e jo atij Negativ, duke shndërruar Frikën në Kurajë dhe emocionet e tjera negative në gjendje mendore pozitive. Një hulumtim i shkurtër do t'ju tregojë se këto ndryshime mendore kryhen pothuajse pa përjashtim përmes Polarizimit dhe se dallimi midis tyre qëndron në gradë e jo në lloj.

Njohuria mbi ekzistencën e këtij Parimi të madh Hermetik, do t'i mundësojë nxënësit të kuptojë më mirë si gjendjet mendore vetjake, ashtu edhe ato të tjerëve. Ai do të vërejë se të gjitha këto gjendje janë çështje gradësh, e kështu do të fitojë aftësinë rrisë apo të ulë lëkundjet sipas dëshirës, të këmbejë polet e tij mendore, duke u bërë në këtë mënyrë Padron i gjendjeve të tij mendore në vend që të jetë shërbëtor apo skllav i tyre. Nëpërmjet njohurisë së tij ai do të jetë i aftë të ndihmojë të tjerët me zgjuarsë, e të ndryshojë polaritetin e tyre përmes metodave të përshtatshme kur kjo është e dëshirueshme. Në i këshillojmë të gjithë nxënësit të njihen nga afër me Parimin e Polaritetit, pasi të kuptuarit në mënyrë të drejtë i këtij të fundit, do t'i ndihmojë të hedhin dritë mbi shumë çështje të koklavitura.

Kapitulli XI

RITMI

“Gjithçka rrjedh në mënyrë qarkulluese; gjithçka ka baticën e zbaticën e saj; çdo gjë ngrihet e bie; luhatja e lavjerrësit shfaqet në gjithçka; masa e luhatjes në të majtë është e barabartë me masën e luhatjes në të djathtë; ritmi kompenson.” – Kybalioni

Parimi i Pestë i madh Hermetik, Parimi i Ritmit, trupëzon vërtetësinë që pohon se gjithçka manifeston një lëvizje të matshme, një lëvizje prej saj e drejt saj, një rrjedhë qarkulluese, një lëkundje para e një lëkundje pas, një luhatje si ajo e lavjerrësit, një baticë e një zbaticë, një ngritje e një rënie midis dy poleve që shfaqen në rrafshet fizike, mendore apo shpirtërore. Parimi i Ritmit është i lidhur ngushtë me Parimin e Polaritetit të cilin e shqyrtoam në kapitullin paraardhës. Ritmi shfaqet midis dy poleve të përcaktuara pikërisht nga Parimi i

Polaritetit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se lavjerrësi i Ritmit luhatet detyrimisht deri në skajet fundore të poleve, pasi kjo ndodh rrallëherë; faktikisht, në shumicën e rasteve, është e vështirë të përcaktohen saktësisht skajet e kundërta polare. Sidoqoftë, lavjerrësi luhatet e lëviz një herë “drejt” një poli, e më pas drejt tjetrit.

Ka gjithmonë një veprim e një kundërveprim, një përparim e një tërheqje, një lartësim e një fundosje që manifestohet gjithkund në Univers e në dukuritë e tij. Diejt, botët, njerëzit, kafshët, bimët, mineralet, forcat, energjitë, mendja e materia, madje edhe vetë Shpirti, i nënshtrohen këtij Parimi. Parimi manifestohet në krijimin dhe shkatërrimin e botëve, në ngritjen e rënien e kombeve, në historinë jetësore të të gjitha gjërave, e në fund, edhe në gjendjet mendore të Njeriut.

Duke nisur që nga manifestimi i Shpirtit të GJITHËSISË, vihet re se ka gjithmonë një Vërshim e një Tërheqje, ose siç shprehen Brahmanët, një “Frymëmarrje e Frymënxjerrje të Brahmanit”. Universet krijohen, arrijnë pikën e skajshme më të ulët të materializmit, e më pas nis luhatja me drejtim lart. Diejt lindin, arrijnë kulmin e forcës së tyre e më pas nis procesi i prapakthimit, i cili pas epokash të tëra i kthen në masa të vdekura materieje, në pritje të një impulsi tjetër që do të riaktivizojë energjitë e tyre për të nisur një cikël të ri. Kështu ndodh me të gjitha botët; ato lindin, rriten e vdesin, vetëm për të rilindur sërish. E njëjta gjë ndodh me gjithçka që ka trajtë e formë; ato luhaten nga veprimi te kundërveprimi, nga lindja në vdekje, nga aktiviteti në pasivitet e sërish nga e para. Parimi vlen njësoj për gjërat e gjalla; ato lindin, rriten e vdesin, e sërish rilindin. Vlen njësoj edhe për lëvizjet, filozofitë, besimet, modat, qeveritë, kombet e gjithçka tjetër; lindje, rritje, pjekuri, rënie, vdekje, e më pas sërish rilindje. Luhatja e lavjerrësit është gjithmonë e dukshme.

Netët pasojnë ditët e ditët netët. Lavjerrësi luhatet nga Vera në Dimër dhe anasjelltas. Grimcat, atomet, molekulat e çdo masë materieje luhatet për qark rrethit të natyrës së saj. Nuk ekziston diçka si prehja absolute apo ndalja e lëvizjes; çdo lëvizje bëhet pjesë e Ritmit. Parimi është i zbatueshëm në mënyrë universale. Zbatimi i tij gjen vend në

çdo pyetje apo dukuri të rrafshëve të shumta të jetës. Ai gjen zbatim përgjatë të gjitha fazave të veprimtarisë njerëzore. Ekziston ngahera një luhatje Ritmike nga njëri pol te tjetri. Lavjerrësi Universal është në lëvizje të pandërprerë. Baticat e Zbaticat e Jetës ulen e ngrihen në përputhje me Ligjin.

Parimi i Ritmit njihet mirë nga shkenca bashkëkohore dhe konsiderohet si ligj universal i aplikueshëm ndaj gjithçkaje materiale. Por Hermetistët e shtyjnë akoma më tutje parimin duke e ditur se manifestimet e ndikimi i tij shtrihen deri tek veprimtaritë mendore të Njeriut, dhe se parimi është përgjegjës për këmbimet e papritura të humorit, ndjenjave dhe çrregullime të tjera të bezdisshme dhe të pashpjegueshme që na prekin. Hermetistët, nëpërmjet studimit të mënyrave të veprimit të këtij Parimi, kanë mësuar t'i shmangen disa prej pasojave të tij përmes Shndërrimit (Transmutacionit).

Mjeshtrit Hermetikë, që kur zbuluan se Parimi i Ritmit ishte i pandryshueshëm dhe gjithmonë i pranishëm në dukuritë mendore, zbuluan gjithashtu se në lidhje me këto dukuri, ekzistonin dy rrafshë të manifestimit të tij. Ata zbuluan se ekzistonin dy rrafshë të Ndërgjegjes, i Poshtmi dhe i Sipërmi, fakt ky që u mundësoi të ngriheshin në rrafshin e sipërm, duke i shpëtuar në këtë mënyrë luhatjes së lavjerrësit Ritmik që shfaqej në rrafshin e poshtëm. E thënë ndryshe, luhatja e lavjerrësit ndodhte në rrafshin e Pavetëdijes, ndërkohë që rrafshi i Vetëdijes mbetej i paprekur. Mjeshtrit e quajnë këtë dukuri me emrin “Ligji i Asnjanësimit”. Parimi i tij i punës konsiston në ngritjen e Egos mbi lëkundjet e Rrafshit të Pavetëdijes së aktivitetit mendor, në mënyrë që luhatja negative e lavjerrësit të mos manifestohet në vetëdije, e rrjedhimisht të mos prekë personin. Është njësoj sikur të ngrihesh mbi diçka e ta lësh të kalojë poshtë teje. Mjeshtri Hermetik ose nxënësi i përparuar, e polarizon vetveten në polin e dëshiruar dhe përmes një procesi të ngjashëm me “refuzimin” për të marrë pjesë në luhatjen praptazi, apo nëse preferoni përmes “mohimit” të ndikimit të luhatjes mbi të, ai qëndron i patundur në pozicionin e tij të polarizuar dhe lejon lavjerrësin mendor të luhatet praptazi përgjatë rrafshit të pavetëdijshëm. Të gjithë individët që zotërojnë njëfarë

vetëkontrolli, me ose pa vetëdije, janë të aftë ta bëjnë këtë gjë, e duke mos lejuar që të preken nga luhajat e humorit apo gjendjet negative mendore, ata zbatojnë pikërisht Ligjin e Asnjanësimit. Sidoqoftë, Mjeshtri i vërtetë e shtyn këtë më tutje, në një gradë shumë më të lartë aftësie, e përdor Vullnetin e tij për të arritur një nivel Drejtpeshimi e Patundshmërie Mendore, pothuajse të pamundur për t'u besuar nga ata të cilët i lejojnë vetes të tërhiqen para e pas nga lavjerrësi mendor i gjendjeve shpirtërore dhe ndjenjave.

Rëndësia e kësaj çështjeje do të pranohet dhe vlerësohet menjëherë nga cilido që vë në punë mendjen dhe njëmendëson se ç'krijesa të varura nga humori, ndjenjat e emocionet janë njerëzit, e sa pak vetëkontroll zotërojnë apo shfaqin. Nëse ndaleni një çast për t'u menduar, do të kuptoni menjëherë se deri në ç'masë e kanë ndikuar jetën tuaj këto luhajte të Ritmit, dhe se si një periudhë Entuziazmi është pasuar në mënyrë të pashmangshme nga një ndjenjë e kundërt e gjendje Depresioni. Në të njëjtën mënyrë, periudhat tuaja të Guximit janë pasuar doemos nga periudha Frike. Kështu ka ndodhur gjithmonë me shumicën dërrmuese të njerëzve, të cilët janë përfshirë nga batica e zbatica ndjenjash, pa dyshuar kurrë mbi shkaku apo arsyen e kësaj dukurie mendore. Të kuptosh në thelb mënyrën e funksionimit të këtij Parimi, do të thotë të përfutosh çelësin e Kontrollit mbi këto luhajte ritmike të ndjesive, si edhe të njohësh më mirë vetveten e të mos mbetesh në mëshirën e këtyre baticave e zbaticave. Vullneti e dominon manifestimin e vetëdijshëm të këtij Parimi, pavarësisht se vetë Parimi nuk mund të shkatërrohet kurrë. Ne mund t'u shpëtojmë pasojave të tij, por Parimi sidoqoftë mbetet në veprim. Megjithëse mund t'i shmangemi mbartjes para e pas, lavjerrësi gjithsesi luhatet pa ndërprerje.

Ekzistojnë të tjera veçori të veprimtarisë së Parimit të Ritmit mbi të cilat do të dëshironim të flisnim në këtë pikë. Pjesë e veprimtarisë së këtij parimi është edhe dukuria që njihet më emrin Ligji i Kompensimit. Një nga kuptimet apo përkufizimet e fjalës "Kompensim" është edhe "kundërpeshimi", çka përbën edhe kuptimin e vërtetë në të cilin Hermetistët e përdorin fjalën. Pikërisht Ligjit të

Kompensimit i referohet edhe Kybalioni kur shprehet: “masa e luhatjes në të majtë është e barabartë me masën e luhatjes në të djathtë; ritmi kompenson”.

Ligji i Kompensimit sqaron se luhatja në njërin drejtim, përcakton edhe luhatjen në drejtimin tjetër apo drejt polit të kundërt; njëra luhatje baraspeshon apo kundërpeshon tjetrën. Në Rrafshin Fizik mund të vërejmë shumë shembuj të këtij Ligji. Lavjerrësi i orës luhatet deri në njëfarë distance djathtas, e më pas përshkon një distancë të njëjtë majtas. Stinët baraspeshojnë njëra-tjetrën në të njëjtën mënyrë. Baticat i nënshtrohen të njëjtit Ligj. Dhe po i njëjti Ligj manifestohet në të gjitha dukuritë e Ritmit. Lavjerrësi që luhatet vetëm pak në njërin drejtim, do të luhatet gjithashtu pak edhe në drejtimin tjetër, ndërkohë që një luhatje e gjatë në të djathtë do të thotë doemos edhe një lëkundje e gjatë në të majtë. Një objekt i flakur lart deri në njëfarë lartësie, do të përshkojë po të njëjtën distancë gjatë kthimit. Forca me të cilën një predhë dërgohet një kilometër lart, riprodhohet përgjatë udhës që ajo përshkon drejt kthimit në tokë. Ashtu siç do t’u dëshmojnë edhe adresimet ndaj autoriteteve përkatëse, ky Ligj mbetet i pandryshueshëm në Rrafshin Fizik.

Por, Hermetistët shtyhen edhe më tej. Ata sqarojnë se edhe gjendet mendore të njeriut i nënshtrohen të njëjtit Ligj. Njeriu që gëzon me gjithë shpirt i nënshtrohet gjithashtu edhe vuajtjes së thellë, ndërsa ai që e përjeton të pakët dhembjen, nuk është i aftë të përjetojë veçse po aq pak gëzim. Derri vuan fare pak mendërisht, e po aq pak edhe gëzon; ai kompensohet. Nga ana tjetër ekzistojnë kafshë të cilat shijojnë thellësisht, por organizmi dhe temperament i nervoz që kanë bëhen shkas që ato të përjetojnë nivele dhembjeje të papërshkrueshme. Po e njëjta gjë ndodh edhe me njeriun. Ka temperamente që nuk lejojnë veçse një gradë të ulët lumturie, e në mënyrë të ngjashme, një gradë të ulët vuajtjeje, ndërkohë që temperamente të afta të përjetojnë lumturi sipërore, lejojnë gjithashtu përjetimin e vuajtjeve më therëse. Në përputhje me rregullin, në çdo individ, kapaciteti i ndjeshmërisë ndaj vuajtjes dhe kënaqësisë është i baraspeshuar. Në këtë pikë, Ligji i Kompensimit vepron me fuqi të plotë.

Hermetistët shtyhen akoma edhe më tutje. Ata na mësojnë se, që dikush të jetë i aftë të përjetojë njëfarë kënaqësie të caktuar, duhet që më parë të jetë luhatur proporcionalisht në të njëjtën distancë, në drejtim të polit të kundërt të ndjesisë. Sidoqoftë, ata pohojnë se Negativja është pararendëse ndaj Pozitives në këtë çështje, çka nënkupton se përjetimi i njëfarë kënaqësie të caktuar, nuk duhet “shpague” doemos me të njëjtin nivel vuajtjeje; përkundrazi, vetë kënaqësia është luhatja Ritmike që vepron në përputhje me Ligjin e Kompensimit për një gradë të caktuar vuajtjeje të përjetuar në këtë jetë, apo në një mishërim të mëparshëm. Kjo hedh një dritë të re mbi Problemin e Vuajtjes.

Hermetistët i trajtojnë vargonjtë e cikleve jetësore si të pandara dhe si pjesë përbërëse të një jete të individit, duke e bërë në këtë mënyrë të kuptueshme luhatjen ritmike, e cila do të shfaqej e pakuptimtë nëse e vërteta mbi rimishërimin nuk do të pranohej.

Hermetistët deklarojnë gjithashtu se Mjeshtri apo studenti i përparuar mund të jetë i aftë t’i shmanget deri në njëfarë grade luhatjes drejt Vuajtjes nëpërmjet procesit të sipërpërmendur të Asnjanësimit. Duke u ngritur në një rrafsh më të lartë të Egos, mund të shmangen e mënjahohen shumica e përjetimeve me të cilat përballen ata që qëndrojnë në rrafshin e poshtëm.

Ligji i Kompensimit luan një rol të rëndësishëm në jetët e meshkujve dhe femrave. Në përgjithësi bie në sy fakti se gjithkush “pague një çmim” për zotërimet apo mangësitë që ka. Nëse zotëron diçka, i mungon diçka tjetër dhe kështu baraspesha ruhet. Kurrkush nuk mund “të hajë ëmbëlsirën pa e paguar atë”. Gjithçka ka anën e saj të këndshme e anën e pakëndshme. Gjërat që fitohen gjithmonë shlyhen përmes gjërave që humben. Të pasurit zotërojnë shumë gjëra që të varfrit nuk i kanë, ndërkohë që shpesh të varfrit zotërojnë gjëra të cilat qëndrojnë përtej mundësive të të pasurve e pasurisë së tyre. Një milioner mund të jetë i dhënë pas gostive dhe me kamjen që zotëron, të jetë i aftë të sigurojë çdo gjellë të zgjedhur e salltanet të tavolinës, e prapëseprapë ti mungojë pikërisht oreksi për t’i shijuar gjithë këto

të mira. Ai lakmon oreksin e urinë e punëtorit, i cili megjithëse nuk ka as mirëqenien e as lakminë e milionerit, përsëri merr më shumë kënaqësi nga ushqimi i tij modest nga sa do të mund të merrte ndonjëherë milioneri, edhe po të mos e kishte oreksin të prishur; e gjitha kjo për arsye se nevojat, zakonet dhe prirjet dallojnë. Kështu ndodh edhe gjatë jetës. Ligji i Kompensimit vepron pareshtur duke u përpjekur të baraspeshojë e kundërpeshojë, gjithmonë duke ia dalë në kohë, megjithëse ndonjëherë mund të nevojiten disa jetë të njëpasnjëshme për luhatjen kthyesë të Lavjerrësit të Ritmit.

Kapitulli XII

SHKAKËSIA

“Çdo Shkak ka Pasojnë e tij; çdo Pasojë ka Shkakun e saj; gjithçka ndodh në përputhje me Ligjin; Rastësi nuk është veçse emri që i japim një Ligjësie të panjohur; ekzistojnë shumë rrafshe shkakësie, por asgjë nuk i shpëton Ligjit.”
– *Kybalioni*

Parimi i Gjashtë Hermetik, Parimi i Shkakut dhe Pasojes, trupëzon vërtetësinë që pohon se Ligji është i kudondodhur në Univers dhe se asgjë nuk ndodh Rastësisht; Rastësi është thjeshtë një fjalë që dëshmon se shkakun ekziston, por mbetet i panjohur apo i paperceptueshëm. Kjo dukuri është e vazhdueshme, pa ndërprerje apo përjashtime.

Parimi i Shkakut dhe Pasojes qëndron në themel të mendimit

shkencor bashkëkohor dhe të lashtë, e është shpallur prej Mësuesve Hermetikë që në ditët e hershme. Megjithëse që prej asokohe kanë lindur debate të shumta mes shkollave të ndryshme të mendimit, këto diskutime kanë qenë të përqendruara mbi detajet e mënyrës së veprimit të Parimit, ose akoma më shpesh, mbi kuptimin e disa fjalëve të caktuara. Parimi i Shkakut dhe Pasojës është pranuar si i drejtë praktikisht nga të gjithë mendimtarët e botës të denjë për këtë emër. Të mendosh ndryshe, do të thotë ta heqësh dukurinë e universit nga kontrolli i Ligjit dhe Rregullsisë, e ta dorëzosh në kontrollin e diçkaje imagjinare të cilën njerëzit e kanë quajtur “Rastësi”.

Një shqyrtim i shpejtë do t’i tregonte gjithkujt se në realitet Rastësia e pastër nuk ekziston. Fjalori Webster e përkufizon fjalën “Rastësi” si vijon: “Një faktor i supozuar apo mënyrë veprimtarie që nuk i bindet një force, rregullsie apo qëllimi; veprimtaria a aktiviteti i këtij faktori; pasoja e supozuar e këtij faktori; ndodhi rastësore, shans, diçka e rastit etj.” Por një shqyrtim i shkurtër do t’ju tregonte se nuk mund të ekzistojë një faktor si “Rastësia”, në kuptimin e diçkaje që qëndron jashtë Ligjesisë apo jashtë Shkakut e Pasojës. Si mund të ekzistojë diçka që vepron në dukuritë e universit e pavarur nga ligjet, rregullsia dhe vazhdimësia e këtij të fundit? Kjo diçka do të ishte krejtësisht e pavarur nga prirja drejt rregullsisë që ka universi, e si pasojë do të qëndronte me lart se vetë universi. Ne nuk mund të konceptojmë asgjë jashtë GJITHËSISË dhe kjo sepse GJITHËSIA është LIGJ në vetvete. Nuk ka hapësirë në univers për diçka të pavarur nga Ligji. Vetë ekzistenca e një Diçkaje të tillë do të shfuqizonte gjithë Ligjet e Natyrës e do ta fundoste universin në një rrëmujë kaotike e në çrregullim.

Një studim i kujdesshëm do të tregonte se ajo çka ne quajmë “Rastësi” nuk është gjë tjetër veçse një shprehje që lidhet me mosnjohjen e shkaqeve, shkaqe të cilat ne nuk mund t’i perceptojmë e rrjedhimisht nuk mund t’i kuptojmë. Fjala Rastësi vjen nga fjala “rast”, dhe nënkupton një ndodhi rastësore, të ngjashme me hedhjen e zareve të lojës, rënia e të cilëve thjesht “ndodh” rastësisht dhe nuk ka lidhje

me ndonjë shkak. Ky është kuptimi në të cilin përdoret përgjithësisht kjo fjalë. Por nëse kjo çështje hetohet nga afër, vihet re se nuk ka absolutisht asgjë rastësore në rënien e zareve. Sa herë që një zar hidhet e shfaq një numër të caktuar, ai i bindet një ligji që është po aq i pagabueshëm sa edhe ligji që rregullon rrotullimin e planetëve rreth diellit. Pas rënies së caktuar të zareve, qëndrojnë shkaqe ose vargje shkaqesh që shkojnë përtej aftësisë gjurmuese të mendjes sonë. Pozicioni fillestar i zareve, energjia e gjeneruar nga muskujt gjatë hedhjes, gjendja e tavolinës etj., janë të gjitha shkaqe me pasojë të dukshme. Përtej këtyre shkaqeve të dukshme ekzistojnë vargje shkaqesh paraprirës të padukshme dhe të gjitha këto, kanë ndikimin e tyre mbi numrin që bie faqelart pasi është hedhur zari.

Nëse një zar hidhet shumë herë radhazi, do të vihet re se numrat që dalin priren të jenë të barabartë, pra numri një priret të shfaqet po aq herë sa numri dy e kështu me radhë. Nëse hidhni përpjetë një monedhë, do të bjerë në tokë “kokë” ose “pilë”, por nëse e hidhni shumë herë radhazi numri i kokave dhe pileve pothuajse do të barazohet. Këtu hyn në fuqi ligji i mesatares. Por si ligji i mesatares ashtu edhe një hedhje e vetme, i nënshtrohen Ligjit të Shkakut e Pasojës, e nëse ne do të ishim të aftë të ekzaminonim shkaqet pararendëse do të mund të shihnim qartësisht se do të ishte e pamundur për zarin të binte ndryshe nga sa ra, në të njëjtat rrethana e në të njëjtën kohë. Shkaqet e njëjta sjellin pasoja të njëjta. Ekziston gjithmonë një “shkak” dhe një “sepse” për çdo ngjarje. Asgjë nuk “ndodh” thjeshtë pa një arsye apo pa një varg të tërë arsyesh.

Shpesh në mendjet e atyre që shqyrtojnë këtë Parim shfaqet njëfarë pështjellimi që rrjedh nga fakti se ata janë të paaftë të shpjegojnë se si diçka mund të krijojë diçka tjetër, apo të jetë “krijuesja” e gjësë së dytë. Faktikisht asnjë “gjë” nuk mund të “krijojë” një “gjë” tjetër. Shkaku e Pasoja ka të bëjë drejtpërdrejtë me “ngjarjet”. “Ngjarje” quhet “ajo çka vjen, pason apo ndodh si rezultat apo pasojë e një ngjarjeje paraprirës”. Një ngjarje nuk “krijon” ngjarje të tjera, por përbën një hallkë pararendëse në vargun e madh të ngjarjeve që burojnë nga energjia krijuese e GJITHËSISË.

Ekziston një vazhdimësi midis të gjitha ngjarjeve paraprirës, aktuale dhe pasuese. Ekziston një lidhje midis çdo gjëje që ka kaluar dhe gjithçkaje që do të pasojë. Një gur shkëputet nga faqja e malit dhe rrëzohet mbi çatinë e një shtëpize poshtë në luginë. Në pamje të parë kjo pasojë duket e rastësishme, por nëse e shqyrtojmë çështjen, pas saj do të gjejmë një mori shkaqesh. Fillimisht ishte shiu ai që zbuti tokën që mbante gurin, çka bëri që ky i fundit të binte; kësaj i paraprin ndikimi i diellit dhe i shirave të mëparshme etj., të cilat gradualisht copëtuan e shkëputën gurin nga shkëmbi; këtyre i paraprijnë shkaqet të cilat çuan në krijimin e malit, lartësimin e tij nga konvulsionet natyrore e kështu me radhë në pafundësi. Mund të gjurmonim shkaqet që qëndrojnë pas shiut etj. Më pas mund të trajtonim ekzistencën e çatisë. Shkurtimisht, do të ngatërroheshim keq në një lëmsh shkaqesh e pasojash prej të cilit do të përpiqeshim më kot të shpëtonim.

Ashtu siç ndodh me njeriun i cili ka dy prindër, katër gjyshër, tetë stërgjyshër, gjashtëmbëdhjetë katragjyshër e kështu me radhë derisa pas 40 brezash numri i paraardhësve të tij do të jetë disa milionë, ashtu ndodh edhe me numrin e shkaqeve që qëndrojnë pas një ngjarjeje apo dukurie, qoftë kjo po aq e papërfillshme sa edhe kalimi i një grimce bloze përpara syve tuaj. Nuk është aspak e thjeshtë të gjurmohet ajo grimcë bloze deri në periudhat e hershme të historisë së botës, kur ajo ishte pjese e trungut masiv të një druri, i cili më pas u shndërrua në qymyr, e kështu me radhë, derisa në formën e grimcës së blözës kalon përmes fushëpamjes suaj, në rrugëtimin drejt aventurash të reja. Një varg i stërmadh ngjarjesh, shkaqesh e pasojash e transformuan grimcën në gjendjen në të cilën ndodhet, e kjo grimcë në vetvete nuk është gjë tjetër veçse një nga vargjet e ngjarjeve që do të prodhojnë ngjarje të tjera edhe qindra vjet më pas. Diçka nga seria e ngjarjeve që lindin prej grimcës së vogël të blözës, ishte edhe shkrimi i këtyre rreshtave, çka bëri që radhitësi në shtypshkronjë të kryente një punë të caktuar në lidhje këtë, e po kështu edhe korrektori i bocave; grimca e blözës do të ndikojë në formimin e disa e ideve të caktuara në mendjen tuaj dhe të të tjerëve, të cilat më pas do të ndikojnë të tjera mendje e kështu me radhë pafund, përtej aftësisë së njeriut për

të menduar më tutje, dhe e gjitha kjo nga kalimi i një grimce të vogël bloze, që dëshmon për relativitetin e gjërave dhe lidhjen e ngushtë që ekziston mes tyre, si edhe thekson faktin se “nuk ka të madh apo të vogël brenda mendjes, që është shkaku i gjithçkaje”.

Ndaluni e mendoni për një çast! Nëse në periudhën e vagullt të Epokës së Gurit, një djalë i caktuar nuk do të kishte takuar një vajzë të caktuar, ju që po lexoni sot këto rreshta nuk do të ishit këtu. Ndoshta edhe ne që po shkruajmë këto rreshta nuk do të ishim këtu nëse i njëjti çift nuk do të takohej. Vetë akti i të shkruarit nga ana jonë dhe i të lexuarit nga juaj, do të ndikojë jo vetëm jetët tona përkatëse, por në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, do të ndikojë edhe jetët e shumë njerëzve që jetojnë apo që do të jetojnë në shekujt që do të vijin. Çdo mendim që na kalon nëpër mendje e çdo veprim që kryejmë, ka përfundime të drejtpërdrejta apo të tërthorta në vargun e madh të Shkakut dhe Pasojës.

Për arsye të shumta, nuk dëshirojmë të hyjmë në trajtimin e Vullnetit të Lirë apo Determinizmit në këtë libër. Midis shumë arsyeve qëndron edhe kryesorja, sipas së cilës asnjëra nga palët që polemizojnë nuk ka plotësisht të drejtë. Nga ana tjetër, në përputhje me Mësimet Hermetike, secila palë është pjesërisht e saktë në atë që thotë. Parimi i Polaritetit tregon se të dyja janë Gjysmë të Vërteta; pole të kundërta të të Vërtetës. Doktrina sqaron se një njeri mund të jetë njëkohësisht edhe i Lirë, edhe i robëruar nga Nevoja, kjo në varësi të kuptimit që u jepet këtyre fjalëve dhe të lartësisë së së Vërtetës prej nga shqyrtohet çështja. Shkruesit e lashtë shprehen mbi këtë çështje si më poshtë: “Sa më larg të ndodhet krijimi nga Qendra, aq më i robëruar është; sa më shumë i afrohet Qendrës, aq më pranë Lirisë ndodhet”.

Shumica e njerëzve, disa më pak e disa më shumë, janë skllëvër të trashëgimisë dhe ambientit rrethues, duke gëzuar kështu fare pak Liri. Ata janë të ndikuar nga opinionet, zakonet dhe mendimet e botës së jashtme, si edhe nga emocionet, ndjenjat dhe humori i tyre vetjak. Ata nuk shfaqin Vetëkontroll të denjë për këtë emër. Madje edhe këtë pohim të mësipërm do ta hidhnin poshtë me zemëratë

duke thënë: “Sigurisht që jam i lirë të sillem e të veproj siç më pëlqen mua; unë bëj atë çka dua të bëj”, megjithëse nga ana tjetër nuk janë të aftë të shpjegojnë ku e kanë origjinën fjalët e tyre “dua të” dhe “siç më pëlqen”. Çfarë i shtyn ata që të “duan të” bëjnë njëren gjë në vend të një tjetre; çfarë i bën ata t’u “pëlqejë” njëri veprim e jo një tjetër? A ka vallë një “sepse” për “pëlqimet” dhe “dëshirat” e tyre? Mjeshtri mund t’i shndërrojë këto “pëlqime” dhe “dëshira” në të tjera, të cilat gjenden në skajin e kundërt të polit mendor. Ai është i aftë të “dëshirojë sepse do”, e jo të dëshirojë për shkak se një ndjenje, gjendjeje shpirtërore, emocion apo ndikim i atmosferës rrethuese, i ndez në vetvete dëshirën për të vepruar në mënyrë të tillë.

Pjesa dërrmuese e njerëzve shkojnë kuturu si një gur që rrokulliset, duke iu bindur ambientit rrethues, ndikimeve të jashtme e gjendjeve të brendshme shpirtërore, dëshirave etj., pa përmendur këtu dëshirat dhe vullnetet e atyre më të fortë se ta, trashëgimitë dhe sugjestionimin, gjëra këto të cilat i përfshijnë e marrin përpara pa bërë rezistencë apo pa ushtruar Vullnetin e tyre. Njësoj si ushtarët e drunjtë në fushën e shahut të jetës, ata luajnë pjesën e tyre, e më pas lihen mënjane kur loja ka përfunduar. Ndërkohë Mjeshtrit që i njohin rregullat e lojës, ngrihen mbi rrafshin e jetës materiale dhe e vendosin veten në kontakt me forcat më të larta të natyrës së tyre, duke dominuar humorin, karakterin, cilësitë dhe polaritetin e tyre, si edhe ambientin që i rrethon, duke u bërë kështu Lojtarë të lojës në vend të jenë Ushtarë, Shkaqe në vend që të jenë Pasoja. Mjeshtrit nuk i largohen Shkakësisë së rrafsheve më të larta por u binden ligjeve të tyre, duke sunduar në këtë mënyrë mbi rrethanat e rrafshit më të ulët. Në këtë mënyrë, ata bëhen një pjesë e ndërgjegjshme e Ligjit, në vend që të jenë thjeshtë instrumente të verbra. Ndërkohë që janë Shërbëtorë të Rrafsheve të Larta, ata mbeten Sundimtarë të Rrafshit Material.

Si në rrafshet e larta ashtu edhe në ato të ulëta, Ligji mbetet kurdoherë në fuqi. Diçka si Rastësia nuk ekziston. Perëndeshën e verbër e shfuqizon Arsyeja. Tashmë, me sytë e kthjelluar nga dituria, jemi të aftë të shohim se gjithçka qeveriset nga Ligji Universal, se numri i pafund i ligjeve nuk është veçse manifestim i Ligjit të Vetëm të Madh,

LIGJIT që quhet TERESI. Është pa dyshim e vërtetë që as edhe një trumcak nuk shpëton pa u vënë re nga Mendja e GJITHËSISË; është e vërtetë se edhe fjetet e flokëve në kokën tonë janë të numëruara, siç shprehen edhe shkrimet e shenjta. Nuk ekziston asgjë jashtë Ligjit e asgjë nuk ndodh në kundërshti me të. Gjithsesi, mos bëni gabimin të mendoni që njeriu është thjesht një automat, përkundrazi! Doktrina Hermetike pohon se Njeriu mund të përdorë Ligjin për të mposhtur ligjet, dhe se ligji i lartë do të mbizotërojë mbi më të ulët, derisa më në fund të ketë mbërritur në fazën në të cilën kërkon strehim te vetë LIGJI, ku qesh deri në përbuzje me ligjet që rregullojnë dukuritë. A jeni vallë të aftë të rrokni kuptimin e brendshëm të gjithë kësaj?

Kapitulli XIII

GJINIA

“Gjinia ekziston në çdo gjë; gjithçka ka Parimet e saj Mashkullore e Femërore; Gjinia manifestohet në të gjitha rrafshet.” – Kybalioni

Parimi i Shtatë Hermetik, Parimi i Gjinisë, trupëzon vërtetësinë që pohon se Gjinia shfaqet në gjithçka, se parimet Mashkullore dhe Femërore janë përherë të pranishme dhe aktive në të gjitha fazat e dukurive, në secilin nga rrafshet e veçanta të jetës. Në këtë pikë mendojmë se do të ishte e udhës të tërhiqim vëmendjen tuaj drejt faktit që Gjinia në kuptimin e saj Hermetik, nuk është e njëjta gjë me Seksin në kuptimin e zakonshëm me të cilin përdoret kjo fjalë.

Fjala “Gjini” vjen nga rrënja latine e saj që do të thotë “të bëhesh shkak, të ngjizësh, të gjenerosh, të krijosh, të prodhosh”. Një shqyrtim i shkurtër do t’ju dëshmonte se kjo fjalë ka kuptime më të shumta e më të gjera se fjala “Seks”, e cila i referohet dallimeve fizike midis gjallesave mashkullor e femërore. Seksi është thjeshtë manifestim i Gjinisë në një rrafsh të caktuar të Rrafshit të Madh Fizik, rrafshit të jetës organike. Do të dëshironim të ngulitnim fort në mendjet tuaja këtë dallim, për shkak se disa shkrimtarë të cilët janë njohur sipërfaqësisht me Filozofinë Hermetike, janë orvatur ta njësojnë Parimin e Shtatë Hermetik, me teori e mësimë boshe apo fantazi, shpesh madje edhe të qortueshme mbi Seksin.

Qëllimi i vetëm i Gjinisë është krijimi, prodhimi, gjenerimi etj., dhe manifestimi i Parimit është i dukshëm në secilin nga rrafshet e dukurive. Është e vështirë të ofrohen prova shkencore për këtë, pasi shkenca ende nuk e ka pranuar këtë Parim si të zbatueshëm në mënyrë universale. Megjithatë, ka prova të cilat po dalin në dritë pikërisht nga burime shkencore. Fillimisht mund të vëmë re manifestime të dallueshme të Parimit të Gjinisë ndërmjet grimcave, joneve apo elektroneve, të cilat përbëjnë bazën e Materies ashtu siç shkenca e njih këtë të fundit, e të cilat përmes kombinimesh të caktuara formojnë Atomin, i cili deri pak kohë më parë trajtohej si fundor dhe i pandashëm.

Fjala e fundit e shkencës thotë se atomi përbëhet nga një shumëlojshmëri grimcash, elektronesh ose jonesh (emra të ndryshëm këta të përdorur nga autoritete të ndryshme), të cilat rrotullohen përqark njëra-tjetrës dhe lëkunden me intensitet të lartë. Paralelisht me këtë, pohohet se formimi i një atomi, në të vërtetë, ndodh si pasojë e grumbullimit të grimcave negative përreth një grimce pozitive; në dukje grimcat pozitive ushtrojnë njëfarë ndikimi mbi grimcat negative, duke bërë që këto të fundit të formojnë kombinime të caktuara dhe të “krijojnë” apo “gjenerojnë” në këtë mënyrë atome. Kjo përkon plotësisht me Mësimet më të lashta Hermetike, të cilat e kanë identifikuar gjithmonë parimin Mashkullor të Gjinisë me (të ashtuquajturin) Polin “Pozitiv” dhe parimin Femëror me (të ashtuquajturin)

Polin “Negativ” të Elektricitetit.

Le të themi dy fjalë në këtë pikë në lidhje me këtë identifikim. Publiku i gjerë ka krijuar një përshtypje krejtësisht të gabuar mbi cilësitë e të ashtuquajturit pol “Negativ” të Materies së elektrizuar ose magnetizuar. Shkenca i përdor në mënyrë të gabuar fjalët Pozitive dhe Negative për sa i përket kësaj dukurie. Fjala Pozitive nënkupton diçka reale dhe të fortë krahasuar me Negativen, e cila nënkupton mosvërtetësi dhe dobësi. Asgjë nuk mund të jetë më larg nga e vërteta faktike e dukurisë së elektricitetit. I ashtuquajturi poli Negativ i një baterie, në të vërtetë është poli në të cilin dhe prej të cilit shfaqet gjenerimi apo prodhimin i formave dhe energjive të reja. Nuk ka asgjë “negative” në lidhje me këtë. Autoritetet shkencore tashmë përdorin fjalën “Katodë” në vend të fjalës “Negative”, fjalë kjo që vjen nga greqishtja e që nënkupton “prejardhje; udhë e gjenerimit” etj. Nga poli i Katodës vërshon luzma e elektroneve ose grimcave, e po nga i njëjti pol burojnë edhe “rrezet” e mrekullueshme të cilat kanë revolucionarizuar konceptet shkencore gjatë dekadës së shkuar. Poli i Katodës është Mëma e gjithë dukurive të çuditshme të cilat kanë bërë të padobishme tekstet e vjetra, dhe kanë flakur në përgun e mbeturinave të spekulimeve shkencore, teori të pranuar prej një kohe të gjatë. Katoda ose Poli Negativ është Parimi Mëmë i Dukurisë së Elektricitetit, si edhe i formave më të përsosura të materies që njeh sot për sot shkenca. Kështu pra siç e shikoni, jemi të justifikuar kur refuzojmë përdorimin e fjalës “Negative” gjatë trajtimit të çështjes në fjalë, si edhe kur insistojmë në zëvendësimin e terminologjisë së vjetër me fjalën “Femërore”. Janë vetë faktet të cilat na shtyjnë të veprojmë në këtë mënyrë, pa pasur nevojë t’i referohemi aspak Doktrinës Hermetike. Kështu pra, në vijim do të përdorim fjalën “Femëror” në vend të fjalës “Negativ” kur të flasim për këtë pol të caktuar aktiviteti.

Teoritë e fundit shkencore thonë se grimcat krijuese apo elektronet janë Femërore (shkenca thotë se “përbëhen nga ngarkesë negative elektrike”, ne themi se përbëhen nga energji Femërore). Një grimcë femërore mund të shkëputet ose edhe të largohet nga një grimcë Mashkullore, e të nisë një karrierë të re.

Ajo kërkon në mënyrë aktive bashkimin me një grimcë Mashkullore, duke qenë e shtyrë nga një impuls natyral drejt krijimit të formave të reja të Materies apo Energjisë. Një shkruar madje shkon aq larg, sa përdor shprehje si: "...ajo menjëherë, kërkon me vullnetin e saj të lirë, një bashkim..." etj. Këto ndarje e bashkime formojnë edhe bazën e pjesës dërrmuese të aktiviteteve të botës kimike. Kur grimca Femërore bashkohet me grimcën Mashkullore, nis një proces i caktuar. Grimcat Femërore lëkunden me shpejtësi nën ndikimin e energjisë Mashkullore dhe rrotullohen me shpejtësi për qark kësaj të fundit. Rezultati është lindja e një atomi të ri. Ky atom i ri, vërtetë është krijuar nga bashkimi i ngarkesave apo grimcave Mashkullore e Femërore, por pasi bashkimi është kryer atomi shfaqet si diçka më vete, me veti të caktuara, pa shfaqur më karakteristikën e elektricitetit të lirë. Procesi i shkëputjes apo ndarjes së elektroneve Femërore quhet "jonizim". Këto elektrone apo thërmija, janë punëtorët më aktivë në Natyrë. Si pasojë e bashkimeve dhe e kombinimeve të tyre, shfaqen dukuritë e ndryshme të dritës, nxehtësisë, elektricitetit, magnetizmit, tërheqjes, shtytjes, afrimitetit kimik dhe anasjelltas, si edhe fenomene të tjera të ngjashme. Të gjitha këto, shfaqen nga veprimtaria e Parimit të Gjinisë në rrafshin e Energjisë.

Pjesa e parimit Mashkullor, duket se është ajo që drejton njëfarë energjie të qenësishme kundrejt parimit Femëror, duke nisur në këtë mënyrë veprimtarinë e procesit krijues. Por është parimi Femëror që kryen përherë punën krijuese aktive; kështu ndodh në të gjitha rrafshet. Secili nga parimet me vete, është i paaftë të përftojë energji vepruese pa ndihmën e tjetrit. Në disa forma jete, të dy parimet janë të kombinuara në një organizëm të vetëm. Në botën organike gjithçka shfaq dy gjini; gjendet Mashkullorja në formën Femërore dhe forma Femërore. Mësimet Hermetike përmbajnë të dhëna të zgjeruara mbi veprimtarinë e dy parimeve të Gjinisë, në lidhje me prodhimin dhe manifestimin e formave të ndryshme të energjisë etj., por nuk e shohim si të volitshëm thellimin në këto detaje për momentin, përderisa shkenca nuk ka përparuar mjaftueshëm sa të mundemi t'i mbështesim me fakte shkencore. Por shembulli që ju dhamë mbi dukuritë e elektroneve dhe grimcave, dëshmon se shkenca është në udhën e

duhur, si edhe ju jep një ide të përgjithshme mbi parimet që qëndrojnë në themel.

Disa prej shkencëtarëve hulumtues kryesorë kanë deklaruar se besojnë që gjatë formimit të kristaleve, gjendet diçka që përkon me “aktivitetin seksual”, çka është një tjetër shenjë që dëshmon për drejtimin drejt të cilit po fryjnë erërat e shkencës. Çdo vit që do të vijë do të sjellë më shumë fakte që do të mbështetin saktësinë e Parimit Hermetik të Gjinisë. Do të zbulohet se Gjinia është në manifestim e veprimtari të pandërprerë në fushën e materies inorganike, si edhe në fushën e Energjisë ose Forcës. Tashmë, në përgjithësi elektriciteti trajtohet si “Diçka” në të cilën duket sikur treten apo shkrihen të gjitha format e tjera të energjisë. “Teoria Elektrike e Universit” është doktrina më e fundit shkencore, e cila po rritet me shpejtësi në popullaritet dhe po pranohet gjerësisht. Rrjedhimisht, nëse jemi të aftë të zbulojmë brenda dukurisë së elektricitetit, qoftë edhe thellë në rrënjët dhe burimin e manifestimeve të saj, një provë të pagabueshme të pranisë së Gjinisë dhe veprimtarisë së saj, jemi plotësisht të justifikuar t’ju kërkojmë të besoni se shkenca më në fund ka ofruar prova të ekzistencës së Parimit të madh Hermetik, Parimit të Gjinisë, në të gjitha dukuritë e universit.

Nuk është e nevojshme t’ju marrim kohë me dukurinë e mirënjohur të “tërheqjes dhe shtytjes” së atomeve, afrimitetin kimik, “pëlqimet e mospëlqimet” e grimcave atomike apo tërheqjen ose kohezionin ndërmjet molekulave të materies. Këto fakte janë tejet të mirënjohura e nuk kanë nevojë për koment të zgjeruar nga ana jonë. Por a ju ka shkuar ndonjëherë ndërmend se të gjitha këto janë manifestim i Parimit të Gjinisë? E keni vallë të vështirë të vëreni se kjo dukuri ngjan me atë të grimcave e elektroneve si dy pika uji? E akoma më tej, a mundeni vallë të mos shihni urtësinë e Mësimeve Hermetike të cilat pohojnë se edhe vetë Ligji i Gravitetit, kjo forcë tërheqëse misterioze falë së cilës të gjitha grimcat e trupat që zotërojnë masë priren drejt njëri-tjetrit, nuk është gjë tjetër veçse një manifestim tjetër i Parimit të Gjinisë, i cili vepron duke tërhequr Mashkulloren të Femërorja e anasjelltas? Për momentin nuk mundemi t’ju ofrojmë prova

shkencore, por shqyrtojeni dukurinë nën dritën e Mësimeve Hermetike, e do të shihni se do të keni një hipotezë që funksionon më mirë se çdo hipotezë tjetër e ofruar nga shkencat e fizikës. Vendosini në provë të gjitha dukuritë fizike e do të dalloni menjëherë se Parimi i Gjinisë është gjithmonë i pranishëm.

Le të hidhemi tani në trajtimin e veprimtarisë së Parimit në Rrafshin Mendor, ku mjaft veçori që paraqesin interes po presin të shqyrtohen.

Kapitulli XIV

GJINIA MENDORE

Studentët e psikologjisë të cilët kanë ndjekur tendencën moderne të mendimit përgjatë trajtave të dukurive mendore, janë befasuar nga këmbëngulja me të cilën ka qëndruar ideja e mendjes së dyzuar, e cila është shfaqur fuqishëm këto dhjetë pesëmbëdhjetë vitet e fundit, e që ka shërbyer si origjinë për një sërë teorish serioze mbi natyrën dhe përbërjen e këtyre “dy mendjeve”. I ndjeri Thomson J. Hudson fitoi popullaritet të madh më 1893 duke parashtruar teorinë e tij të mirënjohur të “mendjeve objektive e subjektive”, për të cilat ai pretendonte se ekzistonin në çdo individ. Shkrimtarë të tjerë tërhoqën pothuajse interes të njëjtë me teoritë e tyre mbi “mendjet e ndërgjegjshme dhe të nënndërgjegjshme”, “mendjet e vullnetshme dhe të pavullnetshme”, “mendjet aktive dhe pasive” etj. Teoritë e shkrimtarëve të ndryshëm dallojnë nga njëra-tjetra, por në themel mbetet parimi i “dyzimit të mendjes”.

Nxënësit të Filozofisë Hermetike i bëhet të buzëqeshë kur lexon e dëgjon për këtë numër “teorish të reja” mbi natyrën e dyfishtë të mendjes, ndërkohë që secila nga shkollat e ndryshme mbron me këmbëngulje teoritë e preferuara duke deklaruar se ka “zbuluar të vërtetën”. Nxënësi kthen pas faqet e historisë okulte, e shumë kohë më parë, në fillimet e vagullta të mësimëve okulte, ai gjen adresime mbi doktrinën e lashtë Hermetike të Parimit të Gjinisë në Rrafshin Mendor dhe manifestimin e Gjinisë Mendore. Duke hulumtuar më në thellësi, ai zbulon se filozofia e lashtë ishte në dijeni të fenomenit të “mendjes së dyzuar”, si edhe sqaronte atë nëpërmjet teorisë së Gjinisë Mendore. Ideja e Gjinisë Mendore, mund t’u shpjegohet me fare pak fjalë studentëve që janë të familjarizuar me teoritë bashkëkohore të cilat i përmendëm tërthorazi më lart. Parimi Mashkullor i Mendjes përkon me të ashtuquajturën Mendje Objektive, Mendje të Ndërgjegjshme, Mendje të Vullnetshme, Mendje Aktive etj.

Ndërkohë, Parimi Femëror i Mendjes përkon me të ashtuquajturën Mendje Subjektive, Mendje të Nënndërgjegjshme, Mendje të Pavullnetshme, Mendje Pasive etj. Sigurisht, Doktrina Hermetike nuk pajtohet me shumë nga teoritë bashkëkohore në lidhje me natyrën e dyfazave të mendjes, e as nuk pranon shumë nga faktet e pretenduara për dy aspektet përkatëse; disa nga këto teori dhe pretendime e kanë hedhur hapin më të gjatë se duhet dhe janë të paafta të përballojnë sprovën eksperimentale dhe demonstrimin. Po i theksojmë këto pika të përbashkëta, me qëllimin e vetëm për të ndihmuar nxënësin të përvetësojë njohurinë e marrë paraprakisht, me mësimet e Filozofisë Hermetike. Studentët e Hudsonit do të dallojnë lehtësisht fjalinë në krye të kapitullit të dytë të librit të tij “Ligji i Fenomeneve Psikike” që thotë: “Zhargoni mistik i filozofëve Hermetikë, zbulon të njëjtën ide të përgjithshme”, çka nënkupton dyzimin e mendjes. Nëse Dr. Hudsoni do të kishte shpenzuar pak më tepër kohë dhe mund për të deshifruar diçka më shumë nga “zhargoni mistik i Filozofisë Hermetike”, mbase do të arrinte të hidhte më shumë dritë mbi çështjen e “dyzimit të mendjes”, por në këtë rast vepra e tij më interesante ndoshta nuk do të shkruhej asnjëherë. Le të shqyrtojmë tani Mësimet Hermetike në lidhje me Gjininë Mendore.

Mësuesit Hermetikë e nisin mësimdhënien e tyre mbi çështjen në fjalë, duke i nxitur nxënësit të shqyrtojnë kumtimin e ndërgjegjes së tyre mbi Vetveten. Nxënësit nxiten që ta drejtojnë vëmendjen përbrenda, drejt Vetes që ndodhet brenda secilit nga ne. Çdo nxënës udhëzohet që të vërejë se ndërgjegjja fillimisht raporton mbi ekzistencën e atij Vetë; kumtimi është “Unë Jam”. Në pamje të parë duket sikur këto janë fjalët e fundit nga ndërgjegjja, por një shqyrtim pak i mëtejshëm zbulon faktin se “Unë Jam” mund të veçohet apo ndahet në dy pjesë apo aspekte të dallueshme, të cilat megjithëse punojnë të ndërthurura dhe në njëzëshmëri, prapëseprapë mund të qëndrojnë të ndara në ndërgjegje.

Ndërkohë që fillimisht duket se ekziston vetëm një “Unë”, një shqyrtim më i kujdesshëm nga afër nxjerr në pah faktin se ekziston një “Unë” dhe një “Mua”. Këta binjakë mendorë dallojnë në karakteristika dhe natyrë, dhe shqyrtimi i natyrës së tyre së bashku me dukuritë që lindin prej saj, hedh dritë mbi shumë probleme që kanë të bëjnë me ndikimin mendor.

Le të fillojmë me shqyrtimin e pjesës “Mua”, e cila zakonisht ngatërohet me “Unin” nga ana e nxënësit, nëse ky i fundit nuk e shtyn kërkimin pak më tej në thellësitë e ndërgjegjes së tij. Njeriu e shikon Vetën (në aspektin “Mua”) si të jetë i përbërë prej një sërë ndjenjash, shijesh, pëlqimesh, mospëlqimesh, zakonesh, lidhjesh të veçanta, karakteristikash etj., të gjitha këto gjëra të cilat formojnë personalitetin apo “Veten” e tij, ashtu siç e njih ai vetë dhe të tjerët. Ai e ndjen se këto emocione dhe ndjenja ndryshojnë, lindin, vdesin dhe u nënshtrohen Parimeve të Ritmit e Polaritetit të cilat e zhvendosin atë vetë nga njëri skaj i ndjenjës drejt tjetrit. Ai gjithashtu e koncepton pjesën “Mua” si një akumulim i caktuar njohurish brenda mendjes, të cilat formojnë një pjesë të vetes së tij. E tillë është pjesa “Mua” në botëkuptimin e njeriut të zakonshëm.

Ndoshta u rrëmbyem paksa. Mund të thuhet se pjesa “Mua” e shumë njerëzve konsiston gjerësisht në ndërgjegjen e tyre trupore dhe në orekset e tyre fizike. Meqenëse ndërgjegjja e tyre është e lidhur fort

me natyrën e tyre trupore, ata praktikisht “jetojnë aty”. Disa madje shkojnë aq larg sa trajtojnë edhe petkat e tyre si pjesë përbërëse të “Mua-s”, duke i konsideruar edhe ato pjesë të vetvetes. Një shkrimtar ka thënë me humor: “njerëzit përbëhen nga tri pjesë... shpirti, trupi dhe rrobat”. Këta njerëz me “ndërgjegje petkore” do të humbitnin personalitetin e tyre nëse do të mbeteshin pa veshmbathjet e tyre, fjala vjen pasi t’u mbytej anija në të cilën udhëtonin. Por edhe shumë prej atyre të cilët nuk janë kaq fort të lidhur pas stolive të tyre, konsiderojnë gjithsesi vetëdijen trupore si “Mua-n” e tyre. Ata nuk arrijnë të konceptojnë një Vetvete të pavarur nga trupi. Praktikisht ata i shikojnë mendjet e tyre si “diçka që i përket” trupit të tyre, gjë që në shumë raste është mëse e vërtetë.

Por teksa njeriu ngjitet në shkallën e ndërgjegjësimit, ai është i aftë ta çlirojë veten dhe pjesën “Mua” nga ideja trupore, si edhe ta mendojë trupin si diçka që i “përket” pjesës së tij mendore. E megjithatë, përsëri ai është i prirur ta identifikojë pjesën “Mua” me gjendjet shpirtërore, ndjenjat etj., pasi ndjen se këto gjëra ekzistojnë bashkë me të. Ai është mjaft i prirur t’i konsiderojë këto gjendje të brendshme si identike me atë vetë, ndërkohë që ato janë thjeshtë “gjëra” të prodhuara nga një pjesë e mendësisë së tij, dhe ekzistojnë brenda tij, jashtë tij, bashkë me të, por gjithsesi nuk janë “vetë ai”. Ai kupton se mund t’i ndryshojë këto gjendje të brendshme ndjesish nëpërmjet një përpjekjeje të vullnetshme, dhe të prodhojë gjendje apo ndjenja me natyrë saktësisht të kundërt, e sidoqoftë, e njëjta “Mua” të vijojë të ekzistojë në të njëjtën mënyrë krejt e pandryshuar. Kështu, pas njëfarë kohe ai bëhet i aftë t’i lërë mënjane këto gjendje të ndryshme mendore, emocione, ndjenja, zakone, cilësi, karakteristika dhe përkatësi të tjera mendore, e t’i vendosë ato në koleksionin “jo-unë” të kurioziteteve dhe gjërave që bëhen barrë së bashku me zotërimet me vlerë. Kjo kërkon shumë përqendrim dhe forcë analitike mendore nga ana e nxënësit. Gjithsesi është detyrë e mundshme për nxënësin e përparuar, ndërkohë që nxënësit jo shumë të përparuar janë të aftë ta shikojnë në imagjinatën e tyre si mund të kryhet ky proces.

Pasi ky proces mënjanimi të ketë përfunduar, nxënësi e gjen veten

në zotërim të ndërgjegjshëm të “Vetes”, çka mund të trajtohet si në aspektin “Unë” ashtu edhe në aspektin “Mua”. Pjesa “Mua” mund të ndjehet se është Diçka mendore në të cilën prodhohen mendimet, idetë, emocionet, ndjenjat dhe gjendjet e tjera mendore. Ajo mund të konsiderohet “pjelloria mendore” siç e përshkruanin edhe të lashtët, e aftë të prodhojë filiza mendorë. Ajo i përgjigjet ndërgjegjes si pjesa “Mua” me fuqi krijuese të fshehta dhe gjeneruesja e gjithfarëlloj pjellave mendore. Forca e energjisë së saj krijuese është vigane. Megjithatë, duke se është e vetëdijshme se i nevojitet njëfarë energjie nga shoqëruesi i saj “Uni” ose nga ndonjë “Unë” tjetër, përpara se të jetë e aftë të sjellë në jetë krijimet e saj mendore. Ky ndërgjegjësim sjell me vete njëmendësimin e një kapaciteti vigan pune mendore dhe aftësie krijuese.

Shpejt nxënësi zbulon se nuk është kjo gjithçka që gjen në ndërgjegjen e tij të brendshme. Ai zbulon se ekziston një Diçka tjetër mendore, e aftë të ushtrojë Vullnetin e saj në mënyrë që pjesa “Mua” të veprojë përgjatë trajtash të caktuara krijimtarie, si edhe e aftë të qëndrojë mënjane e të bëhet dëshmitare e krijimit mendor. Nxënësin e kanë mësuar që këtë pjesë të vetvetes ta quajë “Unë”. Ai është i aftë të prehet në ndërgjegje sipas dëshirës. Në “Unin” e tij ai nuk gjen ndërgjegjësim mbi aftësinë për të gjeneruar dhe krijuar në mënyrë aktive, në kuptimin e procesit gradual të pranishëm përgjatë veprimtarisë mendore, por gjen ndërgjegjësim mbi aftësinë për të lëshuar e përçarur një energji nga “Uni” te “Mua”; një proces ky “dashjeje” që të nisë e të vijojë krijimi mendor. Ai gjithashtu zbulon se “Uni” është i aftë të qëndrojë mënjane dhe të jetë dëshmitar i veprimtarisë krijuese e gjeneruese mendore të pjesës “Mua”. Ky është edhe aspekti i dyfishtë në mendjen e çdo personi. “Unë” përfaqëson Parimin Mashkullor të Gjinisë Mendore ndërsa “Mua” Parimin Femëror. “Unë” përfaqëson Aspektin e të Qenit ndërsa “Mua” aspektin e të Bërit. Do të vini re se Parimi i Përkimit vepron në këtë rrafsh në të njëjtën mënyrë siç vepron edhe në rrafshin e madh në të cilin është kryer krijimi i Universit. Të dy rrafshet janë të ngjashëm në tip megjithëse tepër të ndryshëm në gradë. “Si lart, ashtu edhe poshtë; si poshtë, ashtu edhe lart”.

Këto aspekte të mendjes, Parimi Mashkullor e Femëror, “Unë” dhe “Mua”, kur trajtohen të pandara nga fenomenet e mirënjohura mendore e psikike, dhurojnë edhe Çelësin Universal për lëmet e njohura fare pak të veprimtarisë mendore dhe manifestimit mendor. Parimi i Gjinisë Mendore jep të vërtetën që qëndron në thelb të së gjithë dukurisë së ndikimit mendor etj.

Prirja e Parimit Femëror është gjithmonë drejt perceptimit të mbresave, ndërkohë që prirja e Parimit Mashkullor është gjithmonë drejt lënies së këtyre mbresave ose në drejtim të të shprehurit. Parimi Femëror ka një fushë veprimi shumë më të larmishme se Parimi Mashkullor. Parimi Femëror kryen punën e gjenerimit të mendimeve, koncepteve dhe ideve të reja, përfshirë këtu edhe punën e imagjinatës. Parimi Mashkullor mjaftohet me ushtrimin e “Vullnetit” në fazat e ndryshme të tij. E megjithatë, pa ndihmën aktive të Vullnetit të Parimit Mashkullor, Parimi Femëror priret të prehet i mjaftuar me gjenerimin e imazheve mendore të cilat janë rezultat i mbresave të përfutuara nga jashtë, në vend që të prodhojë krijime mendore origjinale.

Personat të cilët mund t’i kushtojnë një çështjeje vëmendje dhe përqendrim të vazhdueshëm, përdorin në mënyrë aktive të dy Parimet Mendore; Femëroren për gjenerimin aktiv mendor, dhe Vullnetin Mashkullor për të nxitur dhe për t’i dhënë energji pjesës krijuese të mendjes. Në të vërtetë, pjesa dërrmuese njerëzve e shfrytëzon fare pak Parimin Mashkullor dhe mjaftohen duke jetuar në përputhje me mendimet dhe idetë e ngulitura në pjesën e tyre “Mua” nga “Uni” i mendjeve të huaja. Sidoqoftë nuk është qëllimi ynë të ndalemi mbi këtë fazë të çështjes, pasi kjo mund të studiohet në çdo tekst të mirë mbi psikologjinë, shoqëruar me çelësin që ju kemi dhënë mbi Gjininë Mendore.

Studentët e Fenomeneve Psikike janë në dijeni të dukurive të mrekullueshme të klasifikuara nën titujt e Telepatisë, Transferimit të Mendimeve, Ndikimit Mendor, Sugjestionit, Hipnotizmit etj. Shumë prej tyre kanë kërkuar për një shpjegim mbi fazat e ndryshme të këtyre

dukurive në teoritë e profesorëve të “dyzimit të mendjes”. Deri në njëfarë mase ata kanë të drejtë pasi ekziston një manifestim i qartë dy fazash të dallueshme të aktivitetit mendor. Por nëse studentët do ta trajtonin këtë “mendje të dyzuar” nën dritën e Mësimeve Hermetike mbi Lëkundjet dhe Gjininë Mendore, do të vinin re se çelësin e shumëkërkuar e kanë në duar.

Në fenomenin e Telepatisë vihet re se si Energjia Lëkundëse e Parimit Mashkullor dërgohet drejt Parimit Femëror të një personi tjetër, dhe ky i fundit pasi merr mendimin-farë i mundëson të zhvillohet deri në pjekuri. Në të njëjtën mënyrë vepron edhe Sugjestionimi dhe Hipnotizmi. Parimi Mashkullor i personit i cili lë mbresën, dërgon Energji Lëkundëse apo Forcë Vullneti drejt Parimit Femëror të personit tjetër, dhe ky i fundit duke e pranuar, e përvetëson dhe nis të mendojë në përputhje me të. Kështu një ide e strehuar në mendjen e një personi tjetër rritet, zhvillohet dhe me kalimin e kohës trajtohet si një filiz mendor origjinal i individit, ndërkohë që në realitet është njësoj si veza e qyqes e vendosur në follenë e harabelit që shkatërron pasardhësit e ligjshëm dhe prehet aty e qetë si në shtëpinë e saj. Në mendjen e njeriut procesi normal zhvillohet kur Parimi Mashkullor dhe Femëror veprojnë të bashkërenditur, në mënyrë harmonike dhe të ndërthurur me njëri-tjetrin. Por fatkeqësisht, te njeriu mesatar, Parimi Mashkullor është shumë përtac për të vepruar, shfaqja e Forcës së Vullnetit shumë e dobët, e rrjedhimisht njerëz të tillë sundohen thuajse tërësisht prej mendjeve dhe vullneteve të personave të tjerë, të cilëve u lejojnë në këtë mënyrë të mendojnë e të vendosin për ta. Sa i pakët është numri i mendimeve dhe veprimeve origjinale të kryera nga njeriu mesatar? A nuk janë vallë njerëzit në pjesën dërrmuese të tyre thjesht hije dhe jehona të personave me vullnet e mendje më të fortë se e tyra? Problemi qëndron në faktin se njeriu mesatar kridhet thuajse tërësisht në ndërgjegjen e tij “Mua” dhe nuk njëmendëson faktin që zotëron edhe diçka si “Unë”. Ai polarizohet në Parimin e tij Femëror të Mendjes, dhe Parimi Mashkullor në të cilin strehohet edhe Vullneti, lejohet të qëndrojë jo aktiv e i papërdorur.

Meshkujt dhe femrat e forta të botës, pa asnjë përjashtim shfaqin

Parimin Mashkullor të Vullnetit dhe forca e tyre varet materialisht drejtpërsëdrejti nga ky fakt. Në vend që të jetojnë me mbresat e lëna në mendjet e tyre nga të tjerët, ata i sundojnë mendjet e tyre përmes Vullnetit, duke përfutuar kështu imazhet mendore të dëshiruara, e për më tepër përmes së njëjtës mënyrë, sundojnë edhe mendjet e të tjerëve. Shikoni se në ç'mënyrë njerëzit e fortë arrijnë të mbjellin mendimefarë në mendjet e masave popullore, duke bërë që këta të fundit të mendojnë në përputhje me dëshirat e vullnetet e këtyre individëve. Kjo është edhe arsyeja përse njerëzit janë krijesa kaq të ngjashme me delet, që nuk prodhojnë kurrë një ide të tyre origjinale, e që as nuk përdorin fuqitë e tyre të aktivitetit mendor.

Manifestimi i Gjinisë Mendore mund të dallohet lehtësisht përreth nesh në jetën e përditshme. Personat “magnetikë” janë ata persona të cilët janë të aftë të përdorin Parimin Mashkullor në mënyrë të tillë që të ngulitin idetë e tyre tek të tjerët. Aktori që i bën njerëzit të lotojnë apo qajnë sipas dëshirës, përdor këtë parim. Po kështu edhe oratori i suksesshëm, njeriu i shtetit, predikuesi, shkrimtari apo tjetërkush që ndodhet përpara vëmendjes publike. Ndikimi karakteristik i ushtruar nga disa njerëz mbi njerëz të tjerë, i detyrohet pikërisht shfaqjes së Gjinisë Mendore, përgjatë trajtave Lëkundëse të lartpërmendura. Në brendësi të këtij parimi gjenden të fshehtat e magnetizmit personal, ndikimit personal, magjepsjes etj., si edhe fenomene të grupuara në mënyrë të përgjithshme nën emrin Hipnotizëm.

Studenti i cili është familjarizuar me fenomenin e njohur gjerësisht si “forca psikike”, ka zbuluar edhe rolin e rëndësishëm të luajtur në këtë fenomen nga forca të cilën shkenca e ka quajtur “Sugjestion”, emër ky me të cilin nënkuptohet procesi apo metoda nëpërmjet së cilës një ide zhvendoset apo “ngulitet” në mendjen e dikujt tjetër, duke bërë që kjo mendje e dytë të veprojë në përputhje me idenë. Është e nevojshme që të kuptohet drejtë Sugjestionin, në mënyrë që të zbërthehen me zgjuarsia dukuritë e ndryshme fizike në themel të të cilave ai qëndron. Akoma më të nevojshme janë njohuritë mbi Lëkundjen dhe Gjininë Mendore, të domosdoshme për studentin e Sugjestionit. Kjo për arsyen e thjeshtë se i gjithë parimi i Sugjestionit

është i varur plotësisht nga parimi i Gjinisë Mendore dhe Lëkundjes.

Është kthyer në diçka të zakonshme tashmë për studiuesit dhe profesorët e Sugjestionit që të theksojnë se është mendja “objektive apo e vullnetshme”, ajo që lë mbresat apo krijon sugjestionin mbi mendjen “subjektive apo të pavullnetshme”. Por ata nuk përshkruajnë as procesin e as nuk tregojnë ndonjë analogji në natyrë që të na ndihmojë ta përvetësojmë idenë menjëherë. Nëse do ta shqyrtoni çështjen nën dritën e Doktrinës Hermetike, do të vini re se gjallërimi i Parimit Femëror prej Energjisë Lëkundëse të Parimit Mashkullor, është në përputhje me ligjet universale të natyrës, dhe bota natyrore ofron analogji të panumërta nëpërmjet të cilave parimi mund të bëhet i kuptueshëm. Në fakt Mësimet Hermetike tregojnë se edhe vetë krijimi i Universit i nënshtrohet të njëjtit ligj, dhe se në të gjitha shfaqjet krijuese në rrafshet shpirtërore, mendore e fizike, Parimi i Gjinisë është gjithmonë në veprim, duke u shfaqur në formën e Parimit Mashkullor ose Femëror. “Si lart, ashtu edhe poshtë; si poshtë, ashtu edhe lart”. Përtej kësaj, në momentin kur Parimi i Gjinisë Mendore rroket e kuptohet plotësisht, fenomenet e ndryshme të psikologjisë papritmas bëhen të studiueshme e të klasifikueshme në mënyrë inteligjente në vend që të mbeten në mugëtirë. Parimi “funksionon” edhe në praktikë, pasi është i bazuar mbi ligjet e pandryshueshme universale të jetës.

Nuk do të hyjmë këtu në diskutim të zgjeruar apo përshkrim të fenomeneve të ndikimit mendor apo aktivitetit telepatik. Ekzistojnë shumë libra, disa prej tyre mjaft të mirë, të shkruar e të botuar kohët e fundit mbi këtë çështje. Faktet që shpallin këta libra të ndryshëm në vija të përgjithshme konsiderohen të sakta, megjithëse shkrimtarët e ndryshëm janë orvatur ta shpjegojnë fenomenin secili sipas teorisë vetjake të preferuar. Nxënësi mund ta prezantojë veten me këto çështje, e duke përdorur teorinë e Gjinisë Mendore të bëhet i aftë të nxjerrë në pah rregull nga kaosi i teorive e pikëpamjeve kontradiktore, e për më tepër, nëse është i prirur, mund ta kthejë veten lehtësisht në një autoritet të fushës në fjalë. Qëllim i këtij libri nuk është të japë informacion të zgjeruar mbi fenomenet psikike, por t'i dhurojë

nxënësit një çelës universal me të cilin ai të mundë të hapë dyert e shumta që shpien në pjesë të ndryshme të Tempullit të Diturisë, të cilin nxënësi mund të dëshirojë ta eksplorojë. Ne mendojmë se nga ky këndvështrim mbi Mësimet e Kybalionit, dikush mund të nxjerrë shpjegime që do të shërbejnë për të qartësuar shumë probleme të ndërlikuara; një çelës që do të hapë shumë dyer.

Nuk ka vlerë hyrja në detaje në lidhje me veçoritë e shumta të fenomeneve psikike dhe shkencës së mendjes, për sa kohë ne vendosim në duart e nxënësit mjetet nëpërmjet të cilave ai mund ta njohë veten plotësisht me çdo fazë të subjektit që mund t'i interesojë. Me ndihmën e Kybalionit gjithkush mund të kalojë në duar çfarëdo librarie okulte nga fillimi, ndërkohë që Drita e lashtë nga Egjipti ndriçon shumë faqe të errëta e çështje të cilat qëndrojnë në terr. Ky është qëllimi i këtij libri. Ne nuk jemi këtu për të shpjeguar një filozofi të re, por për të risjellë në pah parimet themelore të një doktrine të madhe të vjetër sa bota, e cila do të qartësojë mësimet e të tjerëve, e cila do të shërbejë si Pajtuese e Madhe e teorive të ndryshme dhe e doktrinave të kundërta.

Kapitulli XV

AKSIOMA HERMETIKE

“Zotërimi i Diturisë, nëse nuk shoqërohet me shfaqjen e shprehjen e saj në Veprim, i ngjan manisë së grumbullimit të metaleve të çmuara: kotësi dhe marrëzi. Dituria, njësoj si Pasuria, ekziston me qëllim që të Përdoret. Ligji i Përdorimit është Universal, e ai i cili e thyen këtë ligj do të vuajë, pasi vepron ndesh me forcat e natyrës.”
- Kybalioni

Megjithëse Mësimet Hermetike janë ruajtur gjithmonë të sigurt, të kyçura në mendjet e zotëruesve të tyre fatlumë, për arsye të cilat i kemi thënë edhe më parë, qëllimi i tyre nuk ka qenë kurë ruajtja mënjane dhe sekretimi. Siç mund ta vini re nga adresimi që i bëhet citatit të mësipërm të Kybalionit, i cili e shpall me forcë,

116

Ligji i Përdorimit është pjesë përbërëse e Doktrinës. Dituria që nuk Përdoret apo Shprehet është diçka e kotë, e cila nuk i sjell ndonjë të mirë zotëruesit të saj apo racës. Ruajuni nga Koprancia Mendore dhe shpreheni në Veprim atë çka keni mësuar. Studiojini Aksiomat e Aforizmat, por gjithashtu edhe praktikojini.

Më poshtë do të radhitim disa nga Aksiomat Hermetike më të rëndësishme të marra nga Kybalioni, secila shoqëruar me një komentim të shkurtër. Përvetësojini, praktikojini e zbatojini ato, pasi nuk do të jenë kurrë vërtetë tuajat derisa t'i keni Përdorur.

“Për të ndërruar humorin apo gjendjen tuaj mendore, ndryshoni lëkundjet tuaja.” - Kybalioni

Gjithkush mund t'i ndryshojë lëkundjet e tij mendore përmes një përpjekjeje të Vullnetshme për të përqendruar qëllimisht Vëmendjen te një gjendje më e dëshirueshme. Vullneti drejton Vëmendjen dhe Vëmendja ndryshon Lëkundjet. Kultivojeni Artin e Vëmendjes përmes Vullnetit, dhe do të keni zbuluar të fshehtën e Zotërimit të Gjendjeve Mendore e Shpirtërore.

“Për të shkatërruar një frekuencë të padëshirueshme lëkundjesh mendore, vini në zbatim Parimin e Polaritetit dhe përqendrohuni në polin e kundërt të asaj çka dëshironi të shuani. Eliminoheni të padëshirueshmen duke i ndryshuar asaj polaritetin.” - Kybalioni

Kjo është një nga Formulat Hermetike më të rëndësishme. Është e bazuar mbi parime të vërteta shkencore. Ne ju dëshmuam se një gjendje e caktuar mendore dhe e kundërta e saj nuk janë gjë tjetër veçse pole të së njëjtës gjë, dhe se ky polaritet mund të këmbehet përmes Shndërrimit Mendor. Ky parim është i njohur edhe për psikologët bashkëkohorë, të cilët e zbatojnë për të ndërprerë vese të padëshirueshme duke i nxitur pacientët e tyre të përqendrohen në cilësitë e kundërta. Nëse jeni të pushtuar nga Frika, mos humbisni kohë duke u orvatur të zhdukni Frikën, por në vend të saj kultivoni cilësinë e Trimërisë, e do të shikoni se Frika do të zhduket. Disa

autorë e kanë shprehur këtë ide me forcë duke përdorur shembullin e dhomës së errët. Nuk keni nevojë ta hiqni me lopatë apo ta fshini me fshesë Errësirën. Mjafton të hapni grilat e të lini Dritën të hyjë që Errësira të zhduket. Për të eliminuar një cilësi Negative përqendrohuni në Polin Pozitiv të të njëjtës cilësi, dhe lëkundjet do të shndërrohen gradualisht nga Negative në Pozitive, derisa më në fund ju do të polarizoheni në Polin Pozitiv në vend të atij Negativ. Edhe e anasjellta është njësoj e vërtetë siç kanë zbuluar me hidhërim shumë njerëz, të cilët e kanë lejuar veten të lëkunden pandërprerë në polin Negativ të gjërave. Duke ndryshuar polaritetin tuaj ju mund të zotëroni plotësisht humorin tuaj, gjendjet tuaja mendore, të ndreqni temperamentin e të forconi karakterin. Pjesa dërrmuese e Mjeshtërisë Mendore të Hermetistëve të përparuar buron nga zbatimi i Polaritetit, çka përbën një nga anët më të rëndësishme të Shndërrimit Mendor. Kujtoni Aksiomën Hermetike (të cituar më herët) e cila thotë:

“Mendja (njësoj si metalet dhe elementët) mund të shndërrohet nga një gjendje në një tjetër, nga një gradë në një tjetër, nga një konditë në një tjetër, nga një pol në një tjetër, nga një lëkundje në një tjetër.”
- *Kybalioni*

Të njohësh në thelb Polarizimin, do të thotë të njohësh në thelb parimet themelore të Shndërrimit Mendor apo të Alkimiisë Mendore, pasi nëse dikush nuk zotëron artin e të ndryshuarit të polaritetit vetjak, e ka të pamundur të ndikojë ambientin që e rrethon. Njohja në thelb e këtij parimi do t'i mundësonte dikujt të ndryshonte Polaritetin si vetjak ashtu edhe të të tjerëve, nëse ai person do t'i kushtonte kohën, kujdesin, studimin dhe praktikën e nevojshme për ta zotëruar këtë art. Parimi është real, por rezultatet e përfutuara varen nga këmbëngulja, durimi dhe praktika e nxënësit.

“Ritmi mund të asnjësohet përmes zbatimit të Artit të Polarizimit” - *Kybalioni*

Ashtu siç kemi sqaruar edhe në kapitujt paraardhës, Hermetistët pohojnë se Parimi i Ritmit shfaqet si në Rrafshin Mendor, ashtu edhe në

Rrafshin Fizik, dhe se seria befasuese e humoreve, emocioneve dhe gjendjeve të tjera mendore, vijnë si pasojë e lëkundjes para e prapa që zhvillon lavjerrësi mendor, i cili na zhvendos nga njëri skaj i një ndjenje në skajin tjetër. Hermetistët gjithashtu sqarojnë se Ligji i As-njanësimit mundëson në masë të gjerë kapërcimin e veprimtarisë së Ritmit në vetëdije. Ashtu siç ju kemi treguar, ekziston një Rrafsh i Lartë Ndërgjegjeje dhe një Rrafsh i Ulët i saj, dhe Mjeshtri duke u lartësuar mendërisht në Rrafshin e lartë, bën që luhatja e lavjerrësit mendor të manifestohet në Rrafshin e Ulët. Kështu duke qëndruar në Rrafshin e tij të lartë ai i shpëton ndërgjegjësimit të lëkundjes prapa. Kjo realizohet përmes polarizimit të Vetvetes duke rritur lëkundjet mendore të Egos mbi lëkundjet e rrafshit të zakonshëm të ndërgjegjes. Është njësoj si të ngrihesh mbi diçka e ta lejosh të kalojë poshtë teje. Hermetisti i përparuar e polarizon veten në Polin Pozitiv të Qenies së tij, në polin “Unë Jam” dhe jo në polin e personalitetit, dhe përmes “refuzimit” e “mohimit” të veprimtarisë së Ritmit, e ngre veten mbi rrafshin e tij të ndërgjegjes, ku duke qëndruar i patundur në Deklaratën e Ekzistencës së tij, e lejon lavjerrësin të lëvizë prapa në Rrafshin e Poshtëm pa ndryshuar Polaritetin. Kjo mund të kryhet nga çdo individ që zotëron njëfarë vetëkontrolli, si kur e njih ashtu edhe kur nuk e njih ligjin në fjalë. Persona të tillë thjeshtë “refuzojnë” që t’i lejojnë vetes zhvendosjen pas prej lavjerrësit të humorit dhe emocionit, dhe duke pohuar të palëkundur superioritetin e tyre mbeten të polarizuar në polin Pozitiv. Natyrisht, Mjeshtri zotëron një nivel zotësie shumë më të lartë, pasi ai e kupton ligjin të cilin po mposht përmes një ligji tjetër, e duke përdorur Vullnetin e tij ai arrin një gradë Vetëpërmbajtjeje e Qëndrueshmërie Mendore, pothuajse të pamundur për t’u besuar nga ata të cilët e lejojnë veten të zhvendosen para e pas nga lavjerrësi mendor i humorit dhe ndjenjave.

Sidoqoftë, mbani gjithmonë mend se në realitet, nuk jeni duke prishur Parimin e Ritmit, pasi ky i fundit është i pashkatërrueshëm. Thjesht po mposhtni një ligj duke shfrytëzuar një tjetër si kundërpeshë, e duke ruajtur në këtë mënyrë ekuilibrin. Ligjet e baraspeshës e kundërpeshës mbeten gjithmonë në fuqi si në rrafshet mendore ashtu edhe në ato fizike, e njohja e mirë e këtyre ligjeve në pamje të parë

duket sikur i mundëson dikujt t'i përmbysë ligjet, kur në të vërtetë thjeshtë po ushtron një kundërpeshë.

“Asgjë nuk i shpëton Parimit të Shkakut e Pasojës, por ekzistojnë Rrafshë të shumta Shkakësie, e ligjet e rrafshit më të lartë mund të përdoren për të mposhtur ligjet e rrafshit më të ulët.” - Kybalioni

Përmes njohjes së praktikës së Polarizimit, Hermetistët ngrihen në një rrafsh më të lartë Shkakësie e në këtë mënyrë kundërpeshojnë ligjet e rrafshëve të ulëta të Shkakësisë. Duke u lartësuar mbi rrafshet e Shkaqeve të zakonshme, ata në një farë mase bëhen vetë Shkaqe, në vend që të jenë thjeshtë “të Shkaktuar”. Duke qenë të aftë të zotërojnë plotësisht humorin dhe ndjenjat e tyre, si edhe të asnjësojnë Ritmin në mënyrën që tashmë e kemi sqaruar, ata janë të aftë t'i shpëtojnë një pjese të madhe të veprimtarisë së Shkakut e Pasojës në rrafshin e zakonshëm. Pjesa dërrmuese e njerëzve tërhiqen qorrazi, duke iu bindur ambientit rrethues, dëshirave dhe vullneteve të atyre më të fortë se ta, pasojave të prirjeve të trashëguara, sugjestionin që ushtrohet mbi ta dhe shkaqe të tjera të jashtme, të gjitha këto gjëra të cilat orvaten t'i lëvizin ata si ushtarë të thjeshtë në fushën e shahut të jetës. Përmes lartësimit mbi ndikimin e këtyre shkaqeve, Hermetistët e përparuar synojnë një rrafsh më të lartë veprimi mendor, e duke dominuar humorin, emocionet, impulset dhe ndjenjat e tyre, zhvillojnë për vetveten karakter, cilësi e fuqi të reja, nëpërmjet të cilave mposhtin atmosferën e zakonshme rrethuese dhe praktikisht kthehen në Lojtarë në vend që të jenë Ushtarë të gjorë. Këta njerëz ndihmojnë që loja e jetës të luhet me urtësi, në vend që të shtyhen e tërhiqen këtej apo andej prej ndikimeve, fuqive apo vullneteve më të forta. Ata e shfrytëzojnë Parimin e Shkakut dhe Pasojës në vend që të shfrytëzohen prej tij. Natyrisht, edhe më të lartët e tyre i nënshtrohen Parimit, pasi ai manifestohet edhe në rrafshet e larta, por në rrafshet e ulëta të aktivitetit ata janë Mjeshtra e jo Skllever. Siç thotë edhe Kybalioni:

“Të mençurit shërbejnë në rrafshet e larta, por sundojnë në të ulëtat. Ata u binden ligjeve që u vijjnë nga lart, por në rrafshin e tyre dhe në

rrafshet poshtë tyre, ata sundojnë e japin urdhra. E megjithatë, duke vepruar në këtë mënyrë, ata vetë përbëjnë një pjesë të Parimit dhe jo një pengesë për të. Njeriu i mençur pajtobet me Ligjin, e duke kuptuar dinamikën e këtij të fundit kthehet në manovrues të tij në vend që të kthehet në një skllav të verbër. Ashtu siç ngjan një notar i zoti i cili kthehet sa në një anë në tjetrën duke vajtur apo ardhur sipas dëshirës, krabasuar me një kërcu që pluskon duke u përplasur andej këtej, ashtu duket edhe njeriu i mençur kur krabasobet me njeriun e zakonshëm, por, në çdo rast, notari dhe kërcuri, i mençuri e i marri, të gjithë i nënshtroben Ligjit. Ai i cili e kupton këtë, është në rrugën e duhur drejt Mjeshtërisë.” - Kybalioni.


Në përfundim, na lejoni të tërheqim vëmendjen tuaj mbi këtë Aksiomë Hermetike:

“Transmutacioni (shndërrimi) i vërtetë Hermetik, është Art Mendore.” - Kybalioni

Në aksiomën e mësipërme, Hermetistët sqarojnë se vepra madhore e ndikimit të ambientit që rrethon dikë, kryhet nëpërmjet Fuqisë Mendore. Duke qenë se Universi është tërësisht mendor, vetëm Mendësia mund ta sundojë. Brenda kësaj të vërtete gjendet një shpjegim për të gjitha dukuritë e manifestimet e forcave të larmishme mendore, të cilat po studiohen e po tërheqin kaq shumë vëmendje në këto vite të para të Shekullit të Njëzetë. Prapa apo në themel të doktrinave të shkollave e kulteve të ndryshme, qëndron përherë konstant parimi i Substancës Mendore të Universit. Nëse Universi është Mendor në natyrën e tij substanciale, atëherë rrjedh se Shndërrimi Mendor duhet të ndryshojë kushtet dhe fenomenet e Universit. Nëse Universi është mendor, atëherë Mendja duhet të jetë forca më e madhe e aftë të ndikojë fenomenet e tij. Nëse rroket ky koncept plotësisht, atëherë të gjitha të ashtuquajturat “mrekulli”, mund të shihen qartësisht për atë çka janë në të vërtetë.

“GJITHËSIA është MENDJE; Universi është Mendor.” - Kybalioni

Finis



*Buzët e Diturisë Janë të Kyçura,
Përveçse Për Veshët e Arsyes.*

